

KOHA

PËR
Gratë

Madeleine Albright
**Lufta jonë është
larg fundit**

Arbën Xhaferi
Autoritarizmi i fshehur

Nekibe Kelmendi
**Më shumë gra aty
ku merren vendimet**



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Center for Gender Studies

Inicuar dhe mbështetur nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, u bën thirrje grave të angazhohen më shumë në politikë

Kelmendi: Të ketë më shumë gra aty ku merren vendimet

“Do të doja që disa prej grave eminente dhe të afta të përfshihen në politikë dhe tërë potencialin intelektual e profesional ta vënë në shërbim për implementimin e dokumenteve, të cilat përcaktojnë përfshirjen më të madhe të grave në institucionet vendimmarrëse dhe në respektimin e parimit të barazisë gjinore”, shpreh mendimin e saj Nekibe Kelmendi

PRISHTINË, MARS (KOHA DITORE) – E saktë dhe e prerë në përgjigje si gjithmonë kur flet me mediat Nekibe Kelmendi, ministrja e Drejtësisë, konsideron se kuota prej 30 për qind e përfaqësimit të grave në Kuvendin e Kosovës nuk është për t'u nënçmuar, por thotë se atë kuotë “partitë politike duhet kuptuar si minimum, që do të thotë se nëse kanë zgjidhje më të mira, duhet ta tejkalojnë atë kuotë”. Ajo mendon se kjo kuota gjithashtu do të duhej të aplikohet edhe në institucionet e tjera vendimmarrëse, e jo vetëm në Kuvend. Por më e rëndësishme për ministren Kelmendi është që në Kosovë të zbatohen të gjitha dokumentet ndërkombëtare, me të cilat gruas i mundësohet përfaqësim i barabartë me burrat në të gjitha institucionet e rëndësishme të një vendi. “Me gjithë ekzistimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325, sipas të cilës çdo shoqëri ka për obligim ta promovojë pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e jetës publike, ku bëjnë pjesë edhe institucionet vendimmarrëse, pastaj me gjithë kuotën e caktuar me ligj për përfaqësimin e grave kosovare në të gjitha nivelet e jetës publike dhe me gjithë ekzistimin e Ligjit mbi barazinë gjinore, mund të them me përgjegjësi të plotë se gruaja kosovare nuk është e përfshirë në mënyrën e përcaktuar me dokumentet e sipërpërmendura në institucionet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës, me përjashtim të Kuvendit të Kosovës”, thotë Kelmendi. E pyetur se a është kjo pasojë e hapësirës së pakët që u jepet atyre, në radhë të parë, në partitë politike prej nga

vijnë, apo e mungesës së vullnetit të grave për të marrë përgjegjësitë që shkojnë me postet vendimmarrëse, ajo pohon se “është edhe njëra edhe tjetra”. “Kur e them këtë kam parasysh se akoma është mjaft i shprehur egocentrizmi i meshkujve brenda partive politike, kur duhet të propozohen kandidatët për udhëheqës apo poste të tjera të larta në institucionet e Kosovës. Në ato raste meshkujt propozojnë njëri-tjetrin, sipas marrëveshjeve që i kanë bërë para se të vihet në takim ku vendoset për këto institucione, besa ndonjëherë vijnë edhe me lista të gatshme, të cilat i vënë në votim pa lënë hapësirë për diskutim. Kësaj duhet shtuar edhe manifestimin e mosbesimit në aftësitë e grave që të jenë në krye të institucioneve vendimmarrëse. Merreni si shembull vetëm Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, ku partitë që participojnë në Kuvend kanë kandiduar vetëm meshkuj, kështu që ajo kryesi është puro mashkullore”, thekson ministrja e Drejtësisë. Sipas saj, për “mashallah” nuk është as përfshirja e femrave në Qeverinë e Kosovës, ku kemi vetëm dy femra ministre. Megjithatë ajo konsideron se krahasuar me të kaluarën, sidomos me vitet e 90-ta, gjatë së cilave gratë patën treguar vullnet, interesim, solidaritet dhe përkushtim të pashoq për t'u përfshirë në të gjitha institucionet paralele dhe janë ballafaquar me të gjitha sfidat e kohës për ta ndihmuar këtë popull shumë të përvuajtur që ta mbijetojë gjendjen e okupimit, me të gjitha pasojat dhe të këqijat që ai i bartte me vete, tash vullneti dhe interesimi i tyre ka rënë dhe tash më tepër



“Më tepër do të insistoja që të përfshihet në Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sepse në pikëpamje kuantitative dhe kualitative do të ishte më e favorshme për gratë dhe do ta fuqizonte më shumë pozitën e tyre në institucionet publike”, thotë ministrja Kelmendi

janë të interesuara që të jenë në krye të OJQ-ve, ku gjithashtu kryejnë një punë jashtëzakonisht të rëndësishme për shoqërinë demokratike-kosovare, por kanë edhe interesim të punësohen në organizatat e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. “Në OJQ gratë tregojnë tërë profesionalizmin dhe aftësinë intelektuale e profesionale, të cilën gjë do të mund ta bënin edhe në institucionet vendimmarrëse. I përgëzoj për punën shumë të suksesshme


që e bëjnë në OJQ, ku shumë gjëra i kanë shty të lëvizin dhe i kanë çuar përpara, sikur që është rasti me përcaktimin e kuotës prej 30% të përfshirjes në Kuvend. Mirëpo, unë do të doja që disa prej grave eminente dhe të afta të përfshihen në politikë dhe tërë potencialin intelektual e profesional ta vënë në shërbim për implementimin e dokumenteve, të cilat përcaktojnë përfshirjen më të madhe të grave në institucionet vendimmarrëse dhe në respektimin e parimit të

barazisë gjinore”. Sa i përket mospërfshirjes së kuotës në Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës, Kelmendi shpjegon se “kjo është lënë anash për faktin se kuota nuk është kategori kushtetuese”. “Unë më tepër do të insistoja që të përfshihet në Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sepse në pikëpamje kuantitative dhe kualitative do të ishte më e favorshme për gratë dhe do ta fuqizonte më shumë pozitën e tyre në institucionet publike. Megjithatë, meqë çështja e kuotës është ngritur tash së voni, në fazën e debatit kushtetues, Komisioni për hartimin e Projektkushtetutës do ta shqyrtojë këtë çështje para se Kushtetuta të dërgohet në procedurë parlamentare për miratim”. Si ministre e Ministrisë së Drejtësisë, ndonëse me kompetenca mjaft të kufizuara, ajo thotë se nuk e ndien vetën të nënvlerësuar nga 12 ministrat meshkuj të Qeverisë së Kosovës. “Mund të them se gëzoj respekt shumë të madh nga ta, por respektin nuk e kam dhuratë të tyre, por e kam rezultat të punës, të angazhimit dhe të profesionalizmit tim në këtë fushë”, shprehet Kelmendi. Kur e ka marrë postin e kreut të drejtësisë së vendit, thotë se nuk e ka ndryshuar fare personelin që e ka gjetur, sa i përket përbërjes gjinore të të punësuarve. “Pas ardhjes time bëj përpjekje që në pikëpamje gjinore gjenden e gjetur ta përmirësoj dhe besoj se do t'ia dalë”.



Kushdo që vendos që jetën t'ia dedikojë politikës, e di se pasurimi nuk është prioriteti numër një.

Angela Merkel



Editorial

Meshkujt nuk dorëzojnë lehtë privilegjet e tyre

Besoj se, si për çdo grua tjetër në çdo vend të botës, kur ato arrijnë në pozicione kyçe, ato kanë hapur në këtë rast një portë shumë të rëndësishme për çdo grua tjetër që sheh një mundësi për të matur forcat e veta

JOZEFINA TOPALLI



Koncepti i demokracisë nuk mund të marrë kuptimin e plotë dhe të vërtetë kur reformat politike, apo legjislativë nuk ndërmerren bashkërisht nga gratë dhe burrat në interes të të dyja gjysmave të popullsisë.

Në Shqipëri ka shumë gra që kanë pasur kurajën për t'u marrë me politikë, apo biznes dhe për të qenë të suksesshme. Kryesisht këto janë të përqendruara në Tiranë, por nuk mungojnë, në numër të konsiderueshëm, edhe në Vlorë, në Shkodër, në Korçë, Elbasan, Fier, apo në Durrës.

Po cili është problemi i gruas sot? Cili është problemi i lirisë së saj? Çfarë duhet bërë? Çfarë do të bëjmë? Unë do ta përmbledhja kështu: së bashku le të krijojmë një botë ku gruaja të ndihet një qenie njerëzore, me të gjitha shanset për të ushtruar të gjitha dhuntitë e saj në të gjitha mënyrat, në të gjitha fushat.

Dhe e dyta, nëse ato zgjedhin të ushtrorin detyrën e nënës, le të njihet botërisht se edhe kjo është një punë e nderuar, madje edhe e shpërblyer nga shteti dhe jo të mbetet plotësisht në varësi ekonomike të bashkëshortit.

Megjithatë, të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm se nuk është thjesht çështje ekonomike, por mbi të gjitha shpirtërore. Pra, nuk mund të krijojmë lirinë për gratë vetëm duke u dhënë atyre lirinë ekonomike.

Ajo që ne do të bëjmë është krijimi i kushteve të duhura që një shpirt i lirë gruaje, të lindë e të rritet i lirë.

Liri për të vendosur për jetën e saj, punën të cilën dëshiron të bëjë dhe një pavarësi ekonomike për gratë. Si do ta arrijmë këtë objektiv?

Së pari, duke rrëzuar të gjithë barrierat e mbetura. Ne kemi nisur të ndërtojmë një legjislacion të ri, që do t'i krijojë gruas mundësi të zgjedhë e të konkurrojë, të jetë e suksesshme në të gjitha profesionet.

Së dyti, ne kemi nisur e do të vijojmë një revolucion në edukimin e djemve dhe vajzave, pra të kapim problemin që në rrënjë. Dhe këtu bashkëpunimi i mësuesve është thelbësor.

Para pak ditësh zhvillova në Kuvend një takim mbi edukimin, me rreth 300 mësues të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, nën moton: "E ardhmja që ne besojmë".

Diskutuam gjatë me ta për sfidat e edukimit të fëmijëve tanë. Diskutuam që të gjithë së bashku, politikanë, mësues, prindër, punonjës socialë, psikologë e mjekë me qëllim që të bashkërendojmë angazhimin tonë që të fitojmë sfidën e edukimit të fëmijëve tanë për të ndërtuar një shkollë të qytetërimit, të respektit, të kulturës.

Është një çështje femërore ashtu edhe mashkullore të përballosh jetën, të varesh prej shpatullave të tua. Është si femërore dhe mashkullore të mësosh të gatuar ash apo të kujdesesh për veten dhe fëmijët e tu.

Ky është vërtet një revolucion i vështirë dhe jo vetëm në Shqipëri.

Meshkujt nuk dorëzojnë lehtë privilegjet e tyre. Dhe jo të gjithë e pranojnë se kjo është, në fund të fundit, paaftësi e tyre.

Por, pse ndodh kjo? Mendoj se në një farë mënyre kjo është përgjegjësi edhe e nënave, apo mësuesve, sepse që të vegjël djemtë, të përkëdhelur nga nënat, fillojnë të kuptojnë faktin se të mos bësh dot "punë shtëpie" është një privilegj. Ky koncept ka nisur të ndryshojë sot në botë dhe jam e bindur se do të ndryshojë edhe në Shqipëri.

Duke filluar që nga unë, një nënë që ka një vajzë e një djalë, për t'i rritur ata me konceptin e punës, pa dallim gjinor. Kjo jo për t'i bërë burrat gra dhe gratë burra, por për t'u mësuar atyre se jeta është një kontribut i të dy gjinive pa kufij të ndarë dhe pa formula të gatshme matematike.

Besoj se të gjithëve na u duk fillimisht e çuditshme kur vende të ndryshme të botës aplikuan lejen e lindjes për meshkujt. Ky është një revolucion, dhe si i tillë do kohën e vet për t'u pranuar mbarë botërisht.

Si mund ta ndryshojmë këtë realitet?

Do të doja shumë që zgjidhja të ishte e thjeshtë: të ndryshojmë ligjet. Por nuk besoj se është thjeshtë çështje ligjore, të cilat ne po i bëjmë. Është çështje koncepti. Ajo që ne do të bëjmë është ndryshimi i konceptit, si të gratë ashtu edhe të burrat dhe kjo vjen më së shumti prej edukimit të nënave, baballarëve, mësuesve.

Unë jam e ndërgjegjshme se duhet të humanizojmë politikën dhe ne do ta realizojmë këtë sfidë, sepse jemi të ndërgjegjshëm se shteti duhet të ndihmojë kryefamiljarët, duhet të ndihmojë nënat, që zgjedhin si punë të tyre të nderuar, rritjen e fëmijëve. Përgjigja nuk duhet të jetë thjesht "planifikimi familjar". Pushteti lokal ka filluar të angazhohet për të ndërtuar çerdhe e shkolla dhe do të vazhdojë të krijojë mundësi që një grua në karrierë, një grua kampione të mos e ndërpresë karrierën e saj nëse sjell në jetë një fëmijë.

Megjithatë, pavarësisht nga dukja e një vendi tradicional, në Shqipëri opinioni publik nuk ka vështirësi në pranimin e grave në vendimmarrje, përfshirë këtu edhe në politikë. Në të gjithë botën gratë përballen me pengesa në pjesëmarrjen e tyre në politikë.

Por, po ashtu besoj se, si për çdo grua tjetër në çdo vend të botës, kur ato arrijnë në pozicione kyçe, ato kanë hapur në këtë rast një portë shumë të rëndësishme për çdo grua tjetër që sheh një mundësi për të matur forcat e veta.

Unë jam e bindur se ju nuk e shihni veten në vështirësi të përballeni me gratë e tjera në Evropë.

Sot, në Shqipëri ka pak gra në politikë dhe sistemi i kuotave do të ishte një zgjidhje. Ndoshta jo zgjidhja më e mirë dhe më e preferuar, por mund të shihet si një fillim për gratë që duan të nisin karrierën politike e më pas t'u nënshtrohen rregullave të konkurrimit, për të gjetur veten nëse janë vërtet të lindura dhe të përkushtuara për të ecur më tej ose jo. Unë besoj se një gjë e tillë nuk është e pamundur, por nuk duhet të jemi artificialë, pasi jo gjithçka ka të bëjë me numrat. Edhe pse një grup i rëndësishëm grash është i nevojshëm për të siguruar përfaqësimin e tyre, cilësia e përfaqësimit është po aq e rëndësishme.

Kemi të ardhmen përpara. Ajo nuk do të ndryshojë nëse ne do të presim që këtë ta bëjë brezi tjetër. Ndryshimi është proces që do kohën e vet. Askush më shumë se gratë e suksesshme nuk do të sjellin ndryshimin për më shumë dinjitet, më shumë respekt, më shumë mundësi për femrat. Kështu do të kemi edhe familje më të forta.

Historia e grave nuk do të jetë më një film pa zë. Ne të gjitha së bashku, politikanë, mësuese, nëna, mjeke, avokate, biznesmene, artiste e sportiste, së bashku me meshkujt e emancipuar, duhet të bëjmë që ky zë të dëgjohet.

Gratë e suksesshme janë shembulli më i mirë që do të sjellë ndryshimin.

Çdo grua, në fshat apo qytet, biznesmene, apo nënë, politikanë, apo mësuese, artiste, apo sportiste është një histori suksesi. Të gjitha së bashku ne do të bëjmë historinë e madhe të suksesit të shoqërisë.

KOHA për GRATË

LULJETA VUNIQI



Cili është imazhi i parë që iu bie ndërmend kur përmendet 8 marsi: burrat që u blejnë dhurata nënave, grave, të dashurave ose kolegeve të tyre; lollovitë nëpër dyqane të luleve, parfumeri dhe argjendari; restorante dhe kafeteri përplot me çifte (para)bashkëshortore të veshur dhe të rregulluar në mënyrë solemne?

Apo, 8 marsi i vitit 1857, kur gratë të cilat punonin nëpër fabrikat e tekstilit në New York u rebeluan ndaj kushteve të këqija të punës, ose ndoshta edhe 8 marsi i vitit 1908, kur 15.000 gra marshuan në New York për të kërkuar orar më të shkurtër pune, pagesë më të mirë, të drejtë vote dhe ndalim të punës së të miturve?

Mund të thuhet se ekzistojnë dy qasje kryesore ndaj Ditës Ndërkombëtare të Gruas: në të parën, atë ceremoniale, qëllimi parësor është shfrytëzimi i kësaj dite si alibi për shpëputje nga rutina e përditshmërisë dhe kalim i një dite më ndryshe në një atmosferë të këndshme, kurse në të dytën, atë politike, synohet që vëmendja e shtuar mediale ndaj grave të përdoret për rritjen e vetëdijes mbi gjendjen aktuale të gruas në shoqëri dhe nevojën e përmirësimit të rolit të saj, aty ku ka nevojë.

Si të shënohet kjo ditë në Kosovë? A janë gratë kosovare në pozitë që 8 marsin ta shënojnë vetëm duke festuar dhe duke pranuar lule dhe dhurata tjera, apo ato duhet të bëjnë çmos që, së paku brenda kësaj dite, të përpiqen të sigurojnë përkrahje konkrete nga vendimmarrësit në institucione relevante për angazhime më të fuqishme të tyre në këtë aspekt? A duhet 8 marsi të shërbejë si rasti më i mirë për të reflektuar mbi pozitën dhe arritjet e grave në Kosovë, apo duhet të jetë ditë e festës dhe manifestimit të dashurisë dhe kujdesit për gratë? Që të dyja?

Realisht, gratë në Kosovë nuk kanë shumë arsye për festim, përkundër faktit se deri më tash janë arritur disa suksese në përpjekjet e tyre për arritjen e barazisë gjinore. Ato ende ballafaqohen me probleme shumë serioze në sferën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, sigurisë, pjesëmarrjes adekuate në vendimmarrje, etj.

Një sfidë e madhe e projekteve të grave për avansimin e të drejtave të tyre janë barrierat dhe paragjykimet që hasen gati në çdo hap. Ato ndonjëherë e krijojnë edhe përshtypjen e një vazhdimësie nga e kaluara, të formave të diferencimit dhe stigmatizimit social të angazhimeve në këtë fushë - si nga ana e burrave, ashtu edhe nga vetë gratë. Prezenca e mentalitetit patriarkal, në njërin anë, por edhe mungesa e harmonizimit të ideve dhe koordinimit të veprimeve në mes të grave në anën tjetër, janë duke ndikuar që gjeneratat e reja të vajzave disi të hezitohen të identifikohen me lëvizjen e grave për emancipim dhe fuqizim të të drejtave të tyre - nga frika e etiketimit, por në disa raste edhe për pasojë të të menduarit se këto çështje tashmë janë të zgjidhura dhe nuk ka vend për çfarëdo veprimi të mëtuqjeshëm në këtë drejtim.

Sa i përket mbulimit medial, kjo ditë zakonisht shënohet me artikuj dhe kronika të ndryshme për historikun e festës, me intervistimin e punëtorëve në dyqanet e luleve, të ndonjë burri me buqetë lulesh në dorë, ose të ndonjë çifti të moshuar që tregon për mënyrën e tyre të festimit. Mirëpo, sa i përket ndikimit në shtimin e vazhdueshëm të përqendrimit të mediave në këtë problematikë, e tëra përfundon me kaq. Deri në 8 marsin tjetër.

Gjatë viteve të kaluara, me 8 mars janë organizuar edhe disa tryeza të rrumbullakëta dhe debate lidhur me arritjet dhe problemet e grave në Kosovë. Në këto manifestime shumë shpesh kemi pasur rastin të dëgjojmë edhe zotim të fuqishme nga liderë dhe përfaqësues të institucioneve tona se do të bëhet më shumë për gratë, të cilat janë harruar që të nesërmen.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, me bashkëpunim dhe mbështetje të gazetës KOHA DITORE, ka inicuar botimin e shtojcës speciale "KOHA për GRATË" në këtë 8 mars, me qëllim të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Grave në një mënyrë më të veçantë. Ideja jonë ka qenë që përmes botimit të esëve, komenteve dhe shkrimeve tjera, të kontribuojmë në një formë më substanciale - të nxisim debat dhe të ofrojmë perspektiva më të shumtë për çështjet e grave dhe vajzave në Kosovë dhe rolin e tyre të madh në zhvillimin e shoqërisë kosovare.

Respekti më i madh që mund t'u bëhet grave kosovare në këtë ditë është përpjekja konkrete dhe e sinqertë për ta kuptuar realisht gjendjen e tyre, dhe angazhimi për përmirësimin e saj. Buqetat me lule janë një plus.

Urime 8 marsi!

(Autorja është Drejtoreshë e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore)

Autoritarizmi i fshehur

Nuk shkakton liria e femrës rritjen e përqindjes së divorcit, apo jolojalitetin e saj ndaj mashkullit, por diskrepanca në mes të vlerave tradicionale, patriarkale dhe premisë së re, asaj të lirisë së femrës së vetëdijësuar që me vullnet të lirë të vendosë për fatin e saj, për familjen së saj, për mënyrën e jetesës, për çështjet kryesore që kanë të bëjnë me organizimin e jetës etj.



ARBËN XHAFERI

Pas çlirimit, të huajt, kryesisht nga vendet perëndimore kanë shpeshuar ardhjet në Kosovë në kuadër të përpjekjeve që me përvojat e tyre t'u ndihmojnë kosovarëve që t'i tejkalojnë vështirësitë e trashëguara nga e kaluara. Këto komunikime krijojnë situata shumë interesante që nxjerrin në shesh përvojat e tyre, të panjohura për ne, përkatësisht mungesat tona që deri më tani nuk i kemi vërejtur. Shpesh herë këto përvoja paradoksale shpjegohen më së miri në anekdotë. Në njërin nga këto anekdotë, që tevona qarkullon në popull flitet për një dialog ndërmjet dy drejtorëve të shkollave fillore, njëri anglez tjetri kosovar. I thotë anglezi kosovarit: unë jam drejtor i një shkolle tipike angleze. Shkolla ime ka 1000 nxënës, 800 prej tyre rregullisht kërkojnë ndihmën e psikologut për t'i zgjidhur frustracionet me të cilat ballafaqohen adoleshentët anglezë. Kosovari ia kthen: çudi, unë jam drejtor i një shkolle që ka 2000 nxënës dhe asnjëri prej tyre nuk kërkon ndihmën e psikologut. Drejtori anglez mbetet i stepur nga habia dhe me shikim kërkon shpjegim shtesë nga përkthyesi. Ai, pa humbur kohë thotë: në shkollat tona nuk kemi psikologë, kështu që të gjithë janë shëndoshë e mirë.

Kjo anekdotë në mënyrë shumë plastike e zbulon stadin zhvillimor të një shoqërie ku problemet ekzistojnë në trajta mbase ekstreme, por që nuk regjistrohen, ndaj edhe trajtohen si të paqena. Në këtë pikë zë fill edhe ndarja, ndryshimi, veçoria daluese në mes të qytetërimeve.

Kultura e analizës

Qytetërimi perëndimor guximshëm analizon, regjistron, mat, zbulon, kumton shpesh herë në mënyrë të pamëshirshme të gjitha anomalitë që ekzistojnë brenda shoqërisë. Në këto kontekste qytetëruese nuk tolerohet ngulitja e zakoneve, sidomos në ato vijë ndesh me standardet e shoqërive të hapura, sidomos nëse instalojnë relacione diskriminuese në shoqëri, në institucione, në familje. Nga këto analiza shpesh herë nxirren përfundime të gabuara se shoqëritë perëndimore janë të degjeneruara për shkak se ekzistuan një varg problemesh, abnormalitetesh të pashërueshme.

Në dallim nga kjo kulturë që hulumton, zbulon, dëshmon haptazi për shkarjet individuale apo kolektive, kultura lindore e spektrit autoritar, patriarkal ka prijje që të mos hulumtojë, që të mos zbulojë lajthitjet, të ligën brenda një tradite që ka standarde anakronike, që nuk përkrijnë me vlerat e shoqërive moderne. Mirëpo, mungesa e analizës, e hulumtimit nuk do të thotë që këto probleme nuk ekzistojnë dhe se nuk krijojnë tensionime patologjike në marrëdhëniet ndërnjerëzore, apo ndërgjinore.

Qytetërimi perëndimor, në kuadër të tra-

ditës së analizës, të hulumtimit, të kumtimit të drejtpërdrejtë, shpesh herë të pamëshirshëm të rezultateve të analizës, një kohë të gjatë merret edhe me studimin e çështjes komplekse së barazisë gjinore. Këto analiza mëtojnë të depërtojnë në çdo dimension të këtij fenomeni kompleks, duke marrë gjithnjë parasysh faktorët biologjikë, shoqërorë, kulturorë etj. Nga këto analiza dhe përfundime, shpesh herë shokante, është krijuar bindja për domosdoshmërinë e ndryshimeve, e nisjes së një procesi të emancipimit të femrës, të mashkullit, përkatësisht të shoqërisë në përgjithësi.

Në shoqëritë tradicionale patriarkale, ku mungojnë hulumtimet e kësaj natyre, është krijuar bindja se shoqëritë që flasin haptazi për relacionet e traumatizuara gjinore, qenkan të degjeneruara dhe se emancipimi, liria e femrës qenka shkak i amoralitetit, apo dekadencës së familjeve moderne perëndimore. Në këtë mënyrë bëhen përpjekje, gjithsesi të lajthitura, për ta shpjeguar shkakun e jostabilitetit të familjes moderne perëndimore, ngritjen shqetësuese të përqindjes së divorceve brenda kulturave që kanë dalë nga skemat tradicionale dhe kanë ofruar mundësinë e lirisë së femrës, si brenda familjes ashtu edhe në shoqëri. Me këtë rast bëhet një gabim në këndshikim, në metodën e analizës: faktori për krizën në familje kërkohej te liria, apo te barazia gjinore. Nuk shkakton liria e femrës rritjen e përqindjes së divorcit, apo jolojalitetin e saj ndaj mashkullit, por diskrepanca në mes të vlerave tradicionale, patriarkale dhe premisë së re, asaj të lirisë së femrës së vetëdijësuar që me vullnet të lirë të vendosë për fatin e saj, për familjen së saj, për mënyrën e jetesës, për çështjet kryesore që kanë të bëjnë me organizimin e jetës etj. Këto telashe do të tejkalohen dhe raportet gjinore do të stabilizohen, me këtë edhe stabiliteti i familjes kur të gjitha relacionet ndërmjet bashkëshortëve do të ndërtohen mbi vetëdijen e re, mbi premisën e lirisë së plotë të femrës, të drejtës së saj për vendimmarrje jo vetëm për çështje që kanë të bëjnë me të, por edhe me mënyrën e organizimit të jetës familjare.

Nëse analizohet pozita e femrës shqiptare në shoqëri dhe familje do të konstatohen ndikime nga qytetërimi perëndimor, që vazhdimisht përhap vlerën e së drejtës për barazi të plotë gjinore, për autonomi në vendimmarrje, si dhe ndikime orientale që përputhen me mendësinë tradicionale patriarkale, përkatësisht autoritare. Ekstremet që shfaqen dëshmojnë se modeli shqiptar ende nuk është stabilizuar. Në njërin anë shfaqet liria e pakufishme e femrës, e cila lirinë e kupton si mungesë të çfarëdo ndalesë apo skrupulli dhe në anën tjetër nënshtrimi i femrës modelit tradicional patriarkal, ku funksion autoriteti i mashkullit në të gjitha segmentet e vendimmarrjes.

Në shembullin e parë shfaqet tendenca e thyerjes së të gjitha barrierave, përpjekja e sforcuar për një emancipim të shpejtuar dhe liri të pakushtëzuar që, shpeshherë nuk përkon jo vetëm me limitet biologjike, por edhe me ato morale dhe estetike. Ky model i emancipimit është sipërfaqësor dhe nuk e ndryshon pozitën e femrës në shoqëri, por, përkundrazi, e vë atë në mënyrë edhe më drastike në pozitë të mallit që duhet të jetë sa më atraktiv për mashkullin i cili, fundja, e blen apo nuk e

blen atë mall. Në këtë pikë mund të konstatohet se liria e femrës nuk i shërben asaj, por sërish mashkullit.

Nënshtrimi i pakusht

Në shembullin e dytë, atë të femrës tradicionale, që pranon sistemin të vlerave tipike për familjet patriarkale shfaqet fenomeni i nënshtrimit, shpesh herë të pakusht të femrës ndaj autoritetit të mashkullit. Siç dihet autoritarizmi është një fenomen devijant jo vetëm në nivel shoqëror, por edhe në atë individual. Autoriteti e suspendon personalitetin e vartësve. Femra që edukohet në kuadër të familjeve patriarkale objektivist e ka personalitetin e suspenduar. Për të vendos zakonin, adeti apo kodet kanunore si dhe autoriteti në trajtën e bashkëshortit, të vëllait, të atit. Në sistemet e këtylla femra nuk ka, jo vetëm të drejtën e vendimmarrjes, por edhe të opinionit për interesa të ndryshme familjare apo shoqërore, përfshirë këtu edhe për interesa personale të saja. Presioni i autoritetit është sistematik, i përhershëm dhe vepron në çdo kontekst. Reagimi i femrës ndaj rrethanave të këtylla është i dyfishtë: -ajo pajtohet me këtë pozicion në familje dhe shoqëri ose

-reagon në mënyrë të ndryshme që manifeston pakënaqësinë e saj.

Në rastin e parë kemi të bëjmë me interiorizimin e dëshirës së autoritetit të jashtëm. Kërkesat e tij natyrshëm shndërrohen në dëshirë të femrës, qoftë ajo vajzë, motër, nënë apo bashkëshorte. Imperativin e jashtëm, ajo e paraqet si vullnet të saj dhe në kuadër të taktizimit për pozitë sa më të privilegjuar në kuadër të sistemit patriarkal të vlerave, ajo bën avokatinë e suspendimit të lirisë së saj, varshmërisë së fatit të saj prej autoritetit që imponohet qoftë përmes traditës shoqërore, bindjeve fetare apo frikës nga dhuna konkrete. Në këtë segment ajo nuk i hibon dëshirat, vlerësimet e saja, por vetë bëhet promotore e dëshirave dhe vendimeve të mashkullit. Këtë fenomen të suspendimit të lirisë apo të personalitetit në mënyrë të gjithanshme e shpjegon sociologu Erih From në librin "Ikja prej lirisë". Ç'është e vërteta ai merret me analizën e shoqërisë, ku individ, duke ndier lirinë si barrë që tek ai krijon pasiguri të madhe, i dorëzohet një autoriteti të jashtëm, që zakonisht ka tipare të diktatorit, despotit apo të prijësit të pakontestueshëm dhe karizmatik. Këtë relacion të varshmërisë ndërmjet individit që frikësohet nga liria e tij dhe autoritetit që di se çka do të bëjë me lirinë e të tjerëve, Erih Fromi përpiket ta zbërthejë me kategoritë frejdiane, siç janë nocionet e mazohizmit dhe të sadizmit. Ai ose ajo, që i frikësohet lirisë së vet, vendimmarrjes autonome manifeston shenja devijante të mazohizmit, ndërkaq ai që merr përgjegjësinë të ofrojë siguri dhe kuptimin e jetës i takon kategorisë së sadizmit. Mirëpo, në shoqëritë patriarkale këto relacione nuk shfaqen në trajta të këtylla ekstreme, por janë të kamufluara me normalitetin e jetës tradicionale.

Sëmurja – reagimi tipik

Kategoria e dytë e femrës, asaj që reagon, po ashtu shfaqet në trajta të ndryshme. Ajo që nuk ka guxim, dije dhe gjasa që t'i luftojë haptas ose t'i eliminojë relacionet segreguese, poshtëruese, që ngufatin

dëshirat e saja, gjen mënyra të tjera për ta manifestuar pakënaqësinë e saj, apo dëshirën për të ikur nga ai rreth vicioz. Reagimi tipik i femrave thellësisht të frustruara nga katandisja, humbja e shpresave në kuadër të familjeve autoritare patriarkale, është sëmurja, etiologjia e së cilës nuk arrihet të zbulohet. Për t'i ikur monotonisë ditore ku ajo në vazhdimësi është e detyruar që të ngufatë çfarëdo dëshire personale, që nuk lejohet nga autoriteti maskulin, asaj i duket zgjidhje fatlume shkuarja në spital, madje edhe qëndrimi atje, pa marrë parasysh kushtet apo atmosferën depresive që i karakterizon spitalet.

Në rastin e parë e kemi femrën e cila pa vetëdije e refuzon lirinë e saj, përkatësisht e dorëzon atë vullnetshëm autoritetit duke e suspenduar personalitetin e saj, duke u zhytur në mekanizmin e traditës patriarkale dhe në rastin e dytë e kemi arratisjen e femrës nga mjedisi ngufatës në kontekste të tjera, madje edhe në spital ku ajo e ndien veten më të lirë dhe më të privilegjuar. Teknika e sëmurjes me etiologji të pazbulueshme i ndihmon asaj, që në njërin anë të shpëtojë nga relacionet që e ndrydhin qenien e saj dhe nga ana tjetër të nxitë kujdesin e familjarëve ndaj saj që në rrethana të zakonshme mungojnë.

Pozita e femrës në shoqëritë dhe familjet patriarkale rëndohet edhe më shumë për shkak se mashkulli autoritetin e tij, pozitën dhe dinjitetin e tij në shoqëri e ndërton mbi baza të moralitetit të femrës dhe jo të tij. Prandaj, ai përmes një represioni të vazhdueshëm e detyron femrën prej moshës fëmijërore e deri në pleqëri që të jetë garantuese e moralitetit të familjes përkatësisht të vëllait, të prindit ose të bashkëshortit. Në kuadër të kësaj mendësie femra duhet të jetë shëmbëlltëryrë e dëlirësisë, pafajësisë, amësisë etj, ndërkaq nga mashkulli nuk priten vlera të këtylla absolute.

Megjithatë në shoqëritë shqiptare pozita e femrës nuk manifestohet vetëm në këto ekstreme, por ekziston njëkohësisht, fatmirësisht në përqindje të madhe edhe kategoria e femrës së emancipuar, të shkolluar, e cila arrin t'i harmonizojë ndikimet patriarkale me ato emancipuese. Kjo kategori e femrave të vetëdijësuar shqiptare kanë zgjedhur rrugën më të mirë për ndryshim të mendësisë patriarkale si në familje ashtu edhe shoqëri. Ato, falë edhe ndihmës nga jashtë, kanë themeluar shoqata joqeveritare, që jo vetëm analizojnë pozitën e femrës në shoqëritë shqiptare dhe hartojnë elabore moderne për përmirësim, për korrigjim të botëkuptimeve maskuline, por edhe ofrojnë ndihma konkrete për femrat që nuk dinë si të gjejnë rrugëdalje nga labirinti i dilemave, interesave, nga keq-trajtimet dhe ngufatjet sistematike të lirisë së tyre. Këto veprimtari të guximshme dhe të përkushtuara ofrojnë mundësi objektive për çmontim të një mekanizmi anakronik- autoritarizmin i cili funksionon duke u kamufluuar si vlerë e traditës sonë, si pjesë e identitetit tonë kombëtar. Por, nëse merret parasysh se mendësia patriarkale, koncepti autoritar i familjes dhe i shoqërisë gjysmën e popullatës, femrën, bijën, gruan, nënën, për interesa egoiste i trajton si robër, si instrument të relevancës së tyre të rrëzshme, atëherë del sheshazi karakteri, domethënia antikombëtare e botëkuptimeve të tilla...

Flet ministrja e Energjisë dhe e Minierave, Justina Pula

Ministrja e sektorit më problematik të ekonomisë

“Shpesh më ndodh që të dielave, pikërisht në ditën e vetme të javës kur dua ta kem pushim nga problemet e punës, fëmijët më ngacmojnë me pyetjen: Edhe vikendeve pa rrymë?”, tregon ministrja Pula

KOHA
DITORE

VATRA QEHAJA

PRISHTINË - Ministrja për Energji edhe Miniera, Justina Pula, është e bindur se një grua karrieriste është e vështirë t'i përkushtohet tërësisht familjes, sidomos fëmijëve.

Ajo thotë se megjithatë një femër profesioniste nuk e ka problem të përballet me sfidat dhe me angazhimet në punë.

Për ministren Pula, ndihma e familjes që të arrijë shumë në profesion është qenësore.

Pula është nënë e katër fëmijëve, një vajzë që është në SHBA me studime dhe tre djem që jetojnë në Prishtinë, ndërkohë që prej dy vjetësh është bërë edhe gjyshe.

Ajo ankohet se prej se është bërë ministre në MEM, ka më pak kohë t'u përkushtohet fëmijëve dhe familjes. Ajo thotë se lehtësim për të është se tani fëmijët janë rritur dhe nuk u mungon shumë prezenca e saj në shtëpi.

“Një të diele kemi atmosferë familjare në shtëpi kur përgatitim këndojmë, bisedojmë, por shpesh, pikërisht një ditë të vetme të javës kur dua ta kem pushim, fëmijët më ngacmojnë me pyetjen: edhe vikendeve pa rrymë? Ditëve të tjera të javës duhet t'i falënderohem nënës e cila e merr përsipër përkujdesjen ndaj fëmijëve të mi”, thotë ajo.

Bashkëshortin ajo e quan një këshilltar të fortë në familje. Ajo thotë se bashkëshorti e ka përkrahur shumë profesionalisht dhe moralisht, duke qenë se ka punuar më herët si inxhinier në termocentralin “Kosova B”.

Familjen ose karrierën

Ministrja Pula thotë se femrat u përkushtohen më shumë fëmijëve dhe familjes dhe dëshirojnë të kenë një atmosferë dhe ambient të ngrohtë në familje. “Prandaj nëse në punë ka shumë probleme dhe angazhim, përgjegjësia ndaj familjes dhe fëmijëve është më e vogël”, thotë Pula. Ajo konsideron se nëse një grua dëshiron të arrijë shumë në karrierë, ajo duhet të bëjë lëshime diku.

“Tradicionalisht si gra kultivohe mi me mendimin se duhet t'u përkushtohemi fëmijëve. Por e vërteta është se nëse një femër i përkushtohet me tërë qenien familjes, atëherë ajo nuk do të ketë mundësi të arrijë shumë në karrierë”, thotë ajo.

Ajo tregon se sa vonë i duhet të qëndrojë në vendin e saj të punës. “Por edhe të dielën kur e kemi zyrtarisht pushim, vazhdojnë bisedat rreth KEK-ut dhe problemeve të energjetikës e atyre të ministrisë. Pra, ky nuk është një pushim i plotë, pasi gjithmonë në ndërdije i kemi preokupimet e punës”.

Posti i ministres asaj ia ka kufizuar edhe lirinë e lëvizjes. “Kam probleme edhe në lëvizje. Më mungojnë takimet me studentët dhe me shoqet e punës. Të shtunën e kam ndarë për të mos humbur lidhjen me studentë dhe me kolegë”, tregon Pula.

Sektorin që ajo e drejton e konsideron si sektorin më prob-



lematik të ekonomisë në vend. Sipas saj, drejtimi i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave është i vështirë, pasi që në energjetike problemet janë grumbulluar vit pas viti dhe është e vështirë ta ndryshosh situatën për një periudhë të shkurtër.

“Ministria e Energjetikës ballafaqohet me shumë sfida, ajo bën politika dhe strategji për sektorin e energjisë dhe të minierave, por në momentin e fundit ndeshet edhe me problemin e KEK-ut dhe të furnizimit me energji elektrike”, thotë Pula.

Femrat në pozitë duhet të kontribuojnë për pozitën e femrës

Sipas Pulës, një femër e cila rrjedh nga një familje intelektuale nuk ka probleme për t'u zhvilluar në aspektin akademik dhe në karrierë.

“Meshkujt dhe familjet shqiptare krenohen kur e kanë nusen apo vajzën të avancuar dhe kur ajo kontribuon në shoqëri. Prej shumë femrave të suksesshme dëgjoj që familja i ka ndihmuar për të arritur aty ku janë”, thotë ajo.

Këtë, sipas saj, e dëshmon edhe angazhimi i grave në Kosovë në biznes dhe amvisëri në vitet e nëntëdhjeta për të mbajtur familjen, përderisa burrat e tyre ishin të larguar nga puna.

Sa i përket marrjes së pozitave të larta në institucionet kosovare, Pula vlerëson se kuota prej 30 për qind u ka ndihmuar femrave të dëshmohen në punë. Por edhe këtu ajo has në probleme, pasi që një femër duhet të jetë shumë më e zonja se një mashkull për t'ia vlerësuar punën.

“Në Kosovë një femër nëse bën një gabim të vogël në punë, ky i llogaritet si dështim i madh. Meshkujt në anën tjetër sa herë nuk kanë sukses në punë jo që nuk ndëshkohen, por ngriten në pozita. Dështimi në punë, femrës ia humb të gjitha shanset e reja edhe kur një punë nuk varet direkt prej saj”, thotë Pula.

Po ashtu, prej një femre në vend të punës pritet që të jetë shumë në nivel edhe për nga kultura, më shumë se që pritet prej një mashkulli. Në MEM ajo pohon se ka një qasje shumë bashkëpunuese me kolegët.

“Meshkujt mendojnë që kur je në biznes duhet të jesh e vështirë, por kjo nuk qëndron. Unë nëse mendoj që kolegët kanë të drejtë, i dëgjoj deri në fund dhe kjo është pranuar mirë prej të gjithëve në institucionin ku punoj”.

Ajo konsideron që femrat që mbajnë poste të larta duhet të kontribuojnë edhe për zhvillimin e femrave të tjera dhe të kenë kujdes për koleget e tu japin atyre hapësirë për të vepruar. Pula thotë se si një femër në familjen e së cilës janë tri motra pa vëlla, ato janë përkrahur shumë nga babai i tyre.

“Ne jemi tri motra dhe babai na ka përkrahur duke na ofruar të gjitha mundësitë që ne të shkollohemi. Si fëmijë, ai na ka dërguar në shkollë të muzikës dhe na ka blerë piano. Dy motrat janë mjeke me profesion. Në avancimet e

mëvonshme po ashtu ka ndikuar edhe familja”, thotë Pula.

Justina Pula ka lindur në Prishtinë, ku ka kryer shkollën fillore, të mesme dhe ka diplomuar në fakultetin ekonomik. Ajo ka përfunduar shkollën e tretë të studimeve në Zagreb, ndërsa ka doktoruar në Prishtinë, po ashtu në ekonomi.

Hulumtimi i Pulës për gruan në tregun e punës

Pula ka bërë edhe një hulumtim për “Pjesëmarrjen e gruas në tregun e punës në Kosovë”, qëllimi i të cilit është të ofrojë informacione rreth statusit të grave mbi moshën 25- vjeçare, të punësuar dhe të papunësuar, që kërkojnë apo që nuk kërkojnë punë, me qëllim që të ngrihet njohuria për gjendjen ekonomike të grave të Kosovës, si dhe t'i identifikojë arsyet e pjesëmarrjes së ulët të grave në tregun e punës dhe pjesëmarrjen e lartë të tyre në tregun joformal.

Raporti nënvizon që analfabetizmi

dhe niveli i ulët i aftësive janë ndër barrierat kryesore për gratë kosovare për të fituar ndonjë punë me fitim më të mirë në tregun formal të punës, i cili shikohet si një treg që mund të ofrojë siguri sociale dhe që mund të përmbushë standardet minimale të punës. Të dhënat të cilat paraqiten në këtë hulumtim tregojnë se joaktiviteti ka qenë gjendja e cila është shfaqur më së shpeshti në tregun e punës para dhe pas luftës.

Sipas hulumtimeve që paraqet raporti, gratë në Kosovë tradicionalisht kanë punuar në industri, administratë, arsim dhe shëndetësi. Megjithatë, në periudhën 1989-1999, në Kosovë kanë ndodhur ndryshime dhe transformime rrënjësore të këtyre veprimtarive, gjë që ka shkaktuar edhe zvogëlimin e madh të numrit të grave të punësuar. Pjesa dërmuese e fabrikave kosovare kanë mbetur jofunksionale për shkak të stagnimit dhjetëvjeçar dhe shkatërrimeve gjatë luftës.

Ndër konkluzionet kryesore të hulumtimit është se për gratë e anketuara statusi martesor është prioritet jetësor. Për to martesë është më e rëndësishme sesa punësimi. “Po ashtu, raporti konkludon që pjesëmarrja e grave në tregun joformal është relativisht e lartë, pasi vetëm në këtë lloj të tregut ato gjejnë më shumë mundësi për t'u punësuar.

Shumica e grave të anketuara janë orientuar për trajnime në informatikë, gjuhë angleze, robaqepësi, floktari, artizanat, biznes si menaxhim, financa, e marketing.

Raporti i rekomandon Qeverisë, ndër të tjera, të integrojë perspektivën gjinore në politikat e MPMS-së, të stimulojë sektorin privat me uljen e taksave në çdo grua të punësuar mbi moshën 35 vjeç, të vendosë politika me qëllim të modifikimit të tregut joformal, si dhe të bëjë përcjelljen dhe mbikëqyrjen e punëdhënësve dhe të punësuarve në bizneset e vogla dhe të mesme, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të punëtoveve.



Unë mësova
vlerën e punës
së vështirë
duke punuar shumë

Mary Wollstonecraft

Analiza e teksteve shkollore hedh dritë mbi stereotipat që krijohen që në fëmijëri për ndarje të roleve të meshkujve dhe të femrave

Tekstet shkollore stereotipizojnë rolet gjinore

Duke e paraqitur botën nëpërmjet librave shkollorë, autorët e teksteve kanë stereotipizuar sjelljet për djemtë dhe vajzat, duke kërkuar nga ta sjellje tipike për të dy gjinitë, është njëri nga përfundimet që kanë nxjerrë shumë raporte studimore që janë marrë me analizën gjinore në tekste shkollore. Nisur nga parametrat psiko-socialë të moshës 6-10 vjeç, komunikimi me dhe përmes ilustrimit shpesh është shumë më racional, më i drejtpërdrejtë dhe më i shpejtë, sesa edhe vetë fjala

KOHA Ditore


BESNIK KRASNIQI

PRISHTINË, 7 MARS – Abetarja me të cilën rriten fëmijët derisa ata t'i mësojnë shkronjat, radhitet ndër tekstet e rralla ku femrat në ilustrime janë paraqitur me shumë sesa meshkujt. Mirëpo, pjesa dërrmuese e paraqitjes së femrës, jo vetëm në këtë tekst, është në pozitën e nënës apo mësueses, ndërsa mashkulli është gjinia ku paraqitet në një laramani më të gjerë të profesioneve. Ky rol i saj paraqitet që në faqen e parë të Abetares, ku ka një ilustrim në të cilin në ditën e parë të shkollës nëna ia dorëzon vajzën mësueses. Në të mësuesja paraqitet si një vazhdimësi e rolit të nënës, tani më jo në agjencën e parë të socializmit - familjes, por në atë të dytën - shkollës.

Nisur nga parametrat psiko-socialë të moshës 6-10 vjeç, komunikimi me dhe përmes ilustrimit shpesh është shumë më racional, më i drejtpërdrejtë dhe më i shpejtë, sesa edhe vetë fjala.

Duke e paraqitur botën nëpërmjet librave shkollorë, autorët e teksteve kanë stereotipizuar sjelljet për djemtë dhe vajzat, duke kërkuar nga ta sjellje tipike për të dy gjinitë, është njëri nga përfundimet që kanë nxjerrë shumë raporte studimore që janë marrë me analizën gjinore në tekste shkollore. Stereotipat e tilla në profesione dhe role, duket se shërbejnë për justifikimin e ndarjes së roleve të meshkujve dhe femrave gjatë karrierës së tyre.

Analiza e teksteve shkollore nga perspektiva gjinore ka qenë dhe mbetet një ndër preokupimet e shumë studiuesve dhe instituteve që merren me studime gjinore edhe në Kosovë. Interesimi i tyre është rritur prej kohës kur shumë organizata joqeveritare lokale dhe ndërkombëtare nëpër shumë vende, i kanë shtuar përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore në mbarë botën e sidomos



në vendet paskonfliktuozë, në disa prej të cilave forma të patriarkalizmit ende vazhdojnë të mbijetojnë.

“Portretizimi stereotip i gjinive është më së shumti i pranishëm në tekstet shkollore në përshkrimin e roleve sociale brenda familjes. Paraqitja e familjes, qoftë në përmbajtje dhe në ilustrime të teksteve shkollore, vazhdon t'i stereotipizojë rolet gjinore. Krahas paraqitjes së rolit të nënës dhe babait, nëpërmjet përshkrimit të aktiviteteve të kohës së lirë të fëmijëve, stereotipizohen edhe sjelljet e fëmijëve. Vajza e vogël luan rolin e ndihmës së nënës së saj, përdërisa djali paraqitet gjithmonë afër babait, e që zë një pozitë më superiore, krahasuar me atë të vajzës. Rolet në të cilat paraqiten djemtë në tekstet shkollore janë shumë më aktive krahasuar me ato të vajzave”, është ky përfundim që është nxjerrë në raportin studimor “Auditimi i çështjeve gjinore në sistemin arsimor”, të realizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore.

Raporti analizon tekstet shkollore dhe konstaton se natyra e rregullimit të roleve gjinore ka bërë që meshkujt të pozicionohen në

pozita më privilegjuese, sesa femrat. Jo në pak raste të ilustruara shihen meshkujt ata që zgjidhin problemet.

Paraqitja e lëndës së matematikës si profesion me të cilin identifikohen vetëm meshkujt, shihet edhe në rastin e dhënies së një detyre në të cilën, në mësimin “Cili nga nxënësit zgjodhi mënyrën më të lehtë për njësimin e shumës”, Lisi është ai që ka zgjedhur mënyrën më të lehtë të detyrës, përdërisa shoqet e tij, Bardha dhe Thana, nuk kanë arritur ta bëjnë këtë gjë.

Shumë studime gjinore në tekstet shkollore janë fokusuar në librat e historisë dhe të leximit letrar, të cilat njihen si tekste ku femrës i është dhënë fare pak ose aspak hapësirë. Prandaj, “ridimensionimi i roleve gjinore pranohet të jetë instrument i fuqishëm i zhvillimit të identitetit gjinor. Edhe në të shkuarën gratë kanë pasur një rol krahas burrave në histori. Është e pamundur të besohet se burrat e bënë historinë vetëm ashtu si paraqiten në histori”, theksohet në raport.

Hulumtimet feministe dhe hulumtime të tjera kanë argumentuar se stereotipat gjinore e zvogëlojnë vetëbesimin te vajzat dhe i kufizojnë djemtë dhe vajzat në disa sjellje të caktuara, lëndë të studimit dhe përzgjedhje të profesionit, ndaj në këtë mënyrë kufizojnë vajzat dhe djemtë në realizimin e plotë të potencialit të tyre. Djemtë i tejkalojnë vajzat në përpjesëtim 4:1, në tregimet që përfshijnë temat për mjeshtëri dhe të qenit aktiv, ndërsa vajzat paraqiten me sjellje pasive dhe të varura më shpesh sesa djemtë në përpjesëtim 6:1. Autorët kanë gjetur se meshkujt janë të paraqitur në profesione të ndryshme, përdërisa femrat në të shumtën e rasteve janë të paraqitura si shtëpiake, pasive dhe të varura, ndërsa meshkujt si të vendosur, të sigurt dhe aktivë. Meshkujt nuk i shprehin ndjenjat, ndërsa përkujdesja për shtëpi është përshkruar si detyrë e femrës dhe në të njëjtën kohë vajzat nuk çmohen për inteligjencë në krahasim me djemtë.

Edhe në Shqipëri, përgjatë studimit të tek-

steve të ciklit fillor, është vënë re se ilustrimet kishin në fokusin e tyre meshkujt. Dallim kishte vetëm në tekstet e edukatës shoqërore (1 - 4), në të cilat kjo gjë ishte më pak e theksuar. Aty është bërë përpjekje konstante për të ruajtur ekuilibrin, jo vetëm në ilustrime, por edhe në personazhe përfaqësuese, role sociale etj. Edhe atje, edhe në rastet kur vajzat kanë rolin kryesor, ato fshihen pas një dukurie apo fenomeni, të cilat bëjnë që ajo të marginalizohet. Përgjithësisht, ato janë në funksion të djemve, vëllezërve, shokëve etj., gjithmonë më të pastra, të bukura, të mira në mësim, por jo nismëtare. Femra përgjithësisht gjendet në mjediset e shtëpisë ose shkollës dhe rrallëherë në oborr, duke luajtur me shokët apo shoqet.

Planprogrami që miratohet në Ministrinë e Arsimit është dokument i rëndësishëm, më anë të të cilit arsimtarëve, edukatorëve, autorëve të teksteve shkollore u ofrohen udhëzime për zbatimin e programeve mësimore. Autorët e teksteve, të intervistuar nga Qendra kosovare për studime gjinore, kanë pohuar se marrin shumë në konsideratë planprogramin e hartuar nga Ministria e Arsimit. Me gjithë këtë fakt, gjatë analizës së teksteve shkollore dhe planprogrameve është hasur në mospërputhje ndërmjet planprogramit dhe tekstit shkollor.

Gati të gjitha qëllimet e planprogrameve të ciklit fillor kanë objektiva të njëjta, por u mungojnë objektivat që lidhen me perspektivën gjinore. Prandaj, do të ishte e nevojshme që përveç objektivave për lëndën, të formulonin edhe objektiva të tjera, në mesin e të cilave edhe objektiva të perspektivës gjinore, vlerësohet në raportin studimor “Auditimi i çështjeve gjinore në sistemin arsimor”. Sipas këtij raporti, vetëm një rangim në kuadër të objektivave për lëndët do t'i detyronte hartuesit e teksteve që t'i kushtojnë rëndësi aspektit gjinor. Pa një detyrim të tillë pak besohet se autorët do të marrin parasysh edhe këtë aspekt gjatë hartimit të tekstit.

Rolet tradicionale të femrës dhe të mashkullit

Në shumicën e teksteve të analizuar vërehet se rolet janë plotësisht të ndara mbi bazën e tradicionales. Secili rol i ka përgjegjësitë e veta. Nëna hekuos, vajza qëndron afër saj, babai financon shkollimin e djalit, nëna qëndron afër makinës së larjes, babai furnizon shtëpinë, vajza e vogël shtron tryezën, djali mban një kovë të rëndë në duar, etj.

Ndërkaq marrë në përgjithësi, në të gjitha tekstet shkollore të analizuar të ciklit fillor, profesionet dhe pozitat më të identifikuar për burrat dhe djemtë janë: mjek, historian, filozof, matematikan, shkrimtar, punëtor krahu, polic komunikacioni, shofer, zjarrfikës, ushtar. Profesionet në të cilat paraqiten gratë dhe vajzat janë: mësuese, balerinë, laborante, pastruese, mbretëreshë, këngëtare, etj.




Për ilustrim, shembull mund të shërbejë mësimi: “Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve”, që gjendet në librin “Edukata Qytetare III”.

Babai: Punon në oficinë për të siguruar paranë. Rregullon mjetet elektroshtëpiake. Çon fëmijët në shëtitje. Gatuan.

Mamaja: Kujdeset për pastërtinë e shtëpisë. Qep dhe bën triko. Ndihmon fëmijët të bëjnë detyrat. Gatuan.

Vëllai: Kujdeset për qenin. Vendos lodrat në vend. Ujit kopshtin.

Motra: Shkon në shkollë. Bën detyrat. Shtron dhe ngre tryezën.



Intervistë e veteranës së arsimit, Naxhije Buçinca

Një jetë - luftë analfabetizmit

“(Në oda) gjithmonë e citoja Sartre-n, i cili e ka pasur një ese që i referohej lëvizjes së rezistencës në Francë: ‘Shtypësit duhet t’i shpjegosh se je i pashtypur. Kur i tregon se je i pashtypur, fiton lirinë personale. Duke fituar lirinë personale, hap rrugën për lirinë e të tjerëve’. Këtë unë e vija edhe në kontekstin politik, por edhe në kontekstin e avancimit të pozitës së gruas në familje dhe në shoqëri”

PRISHTINË, 6 MARS – Kur para gjysmë shekulli ajo ndodhej në prag të diplomimit, edhe publikisht kishte dhënë një premtim: “Do të bëhem mësuese e popullit”. Dhe kështu ngjau. Naxhije Buçinca (73), tani veterane e arsimit, prejse është diplomuar, kurrë nuk ka reshtur së luftuari analfabetizmin ndër femra. Ka nisur në Krajë të Malit të Zi, e tani nuk lë shtëpi të fshatrave të Shalës pa trokitur, në përpjekje që ta riaktivizojë në procesin e mësimxënies edhe vajzën e fundit që ka ndërprerë shkollimin.

Është lindur në Ulqin, ka mbaruar filloren në ushtrimoren “Murat Toptani” të Tiranës, ndërsa ka marrë diplomë të Normales në Prishtinë, ku ka qenë pjesëtare e gjeneratës së parë të nxënësve që kishin mbaruar këtë shkollë shkollimi.

Ajo kujton peripecitë që kishte familja e saj në Ulqin, kur i ati akuzohej si nacionalist nga pushteti jugosllav. Kjo kishte bërë që edhe zonjën Naxhije autoritetet e kohës ta angazhonin në një pjesë fare rurale për të dhënë mësim, si formë dënimi që i bëhej një familjeje të anatemuar.

“Kur e kryeva në 54-shin u desh me u sistemu diku. Si familje ishim të etiketuar si nacionalistë, për çka babën ma pushkatuan në 48-shin. Pushteti mendoi se ma gjeti një vend pune jo të përshtatshëm, por për mua ishte kënaqësi që më sistemuan në Krajë, buzë liqenit të Shkodrës. Aty kishte tetë fshatra të pastra etnikisht shqiptare. Jo që më dënuan, por më shpërblyen, sepse mu aty kisha qejf të jap kontributin tim. Në Krajë edhe fillova me arsimimin joformal. Mbaja kurse kundër analfabetizmit, sepse kishte shumë analfabete”, kujton veterania e arsimit kohët kur ka nisur aktivitetin e saj për t’ua mësuar shkronjat vajzave shqiptare të Malësisë.



Naxhije Buçinca

Për pesë vjet me radhë kishte bërë këtë veprimtari, derisa iu kishin krijuar rrethanat që të mos mundej të vazhdonte më. U detyrua të largohej nga aty, pavarësisht se për këtë kohë, siç thotë, puna funksiononte për mrekulli, sepse kishte etje për dije tek vajzat.

Fokus i saj vazhdojnë të jenë vajzat e viseve rurale, por tani ato të Kosovës, më saktësisht, të fshatrave të Vushtrrisë. Prapë për aktivitetet do të ketë luftimin e analfabetizmit. Zonja Buçinca thekson se mentaliteti, të cilin e kishte krijuar pushteti, ishte që vajzat nuk kanë nevojë të shkolloheshin.

Odë më odë ka trokitur për ta ndërruar këtë mentalitet. Ka qenë një fjali me të cilat i ka sfiduar të vjetrit që ngurronin t’i dërgonin

në shkollë vajzat e tyre.

“U thosha: ‘A doni me i ndihmu sistemit të Milosheviqit për mos me na i lanë fëmijët me u shkollu’. Ata njëzëri e kundërshtonin. Prandaj, i inkurajoja që t’i shkollojnë vajzat. Filluan njerëzit, edhe në vise rurale, të mendojnë se shkollimi i vajzave është i domosdoshëm”.

“(Në oda) gjithmonë e citoja Sartre-n, i cili e ka pasur një ese që i referohej lëvizjes së rezistencës në Francë: ‘Shtypësit duhet t’i shpjegosh se je i pashtypur. Kur i tregon se je i pashtypur, fiton lirinë personale. Duke fituar lirinë personale, hap rrugën për lirinë e të tjerëve’. Këtë unë e vija edhe në kontekstin politik, por edhe në kontekstin e avancimit të pozitës së gruas në familje dhe në shoqëri”, thekson Naxhije Buçinca, e cila krahas luftimit të analfabetizmit, thotë të ketë përcjellë porosinë edhe mënyrën se si duhej fuqizuar populli përballë regjimit të kohës.

Që punën të mos e bënte vetëm dhe që lufta kundër analfabetizmit të zgjerohej, në vitin 1993 ajo kishte themeluar shoqatën “Grupi i krijueseve dhe i veteranëve të arsimit”, që tani njihet me emrin “Grupi i veteranëve të arsimit”. Misioni është po i njëjti.

Nëse dikur për shkak të stereotipave nuk liheshin vajzat të vijonin shkollimin, ky grup tash ka evidencuar faktorin ekonomik që ndikon në këtë fenomen. Grupi së fundmi ka iniciuar çështjen e themelimit të një fondi për t’i mbështetur ato vajza me gjendje të rëndë ekonomike, që të vazhdojnë shkollimin e mesëm.

“Prapë në fokus është arsimimi i femrës shqiptare. Mirëpo, kemi avancim në mentalitetin e prindërve. Ka vetëdijesim të tyre. Por, prapë ka diskriminim. Nëse prindi ka një euro për t’ia dhënë njërit prej fëmijëve për shkollim, ai zgjedh mashkullin. E tash,

ne këtu fokusohemi. Projektin e fundit që kam është krijimi i një fondi për shkollimin e vajzave, i cili duhet të mbështetet në donatorët vendorë”.

Zonja Buçinca konsideron se arsimimi i jep fuqi femrës dhe se është bazë për një jetë më të ngritur dhe më kualitative. Edhe në ditët e sotme konsideron se Kosova ka nevojë për një “mësuese të popullit”, siç kishte premtuar të bëhej 53 vjet më parë.


“Është një situatë krejt tjetër, megjithatë tërë kohën thuaja e kaloj nëpër fshatra. Sot kemi përparësinë se femra është e vetëdijshme që duhet të shkollohet. 85 për qind e femrave që braktisin shkollimin e mesëm, e bëjnë për shkak të gjendjes ekonomike. Tash ne fokusohemi të sigurojmë transportin, besa edhe veshmbathjen, por sigurojmë edhe bursa. Ne i kemi lëvizur edhe donatorët tanë”, thotë me mburrje ajo.

Rezultati i punës që ka bërë thotë se është më shumë se evident. Vetëm pesë vjet më parë thotë të ketë trajnuar 1800 vajza, tek të cilat është ndikuar të mos e ndërprejnë shkollimin pas klasës së tetë, kur për herë të parë në sistemin kosovar të arsimit kishte filluar të aplikohet edhe klasa e nëntë. Thotë se përqindjen e vajzave për pjesëmarrje në arsimin e mesëm, bashkë me kolegët e grupit të veteranëve të arsimit, e kanë ngritur në katër vjetët e fundit.

Aktualisht, lëviz me shifra prej 20 deri në 24 për qind të shkallës së analfabetizmit. Veterania e arsimit, Naxhije Buçinca, thotë se s’ka ndërmend të ndalet, derisa ajo frymon.

“Këtë që bëj e kam kënaqësi të madhe, sepse kur mendoj se diçka bëj për rrethin tim, kur diçka bëj për gruan, atëherë mendoj se jam gjallë dhe jetoj”.

Besnik Krasniqi



MARY WOLLSTONECRAFT

Gratë dhe burrat duhet të arsimohen, në kuadër të rrethanave dhe përvojave të vendit dhe shoqërisë në të cilën jetojnë.

Mary Wollstonecraft

Gratë vazhdojnë të mbeten më të prekurat nga dhuna në familje

Dhuna raportohet, por viktimës nuk po i gjendet zgjidhja

Nga viti në vit është rritur vetëdija që rastet e dhunës të raportohen. Përfaqësues të organizatave vlerësojnë se është shtuar besimi i njerëzve në Shërbimin Policor të Kosovës, ndërkohë fajësojnë institucionet vendëse për mospërbushje të premtimit për t'i gjetur zgjidhje personit të viktimizuar

KOHA Ditore

SELVIJE BAJRAMI

PRISHTINË, MARS – Dhuna në familje vazhdon të jetë fenomen prekës në shoqërinë kosovare. Sipas të dhënave statistikore të organizatave të ndryshme që merren me shtjellimin e këtij fenomeni, si dhe të Shërbimit Policor të Kosovës, viktimat të dhunës në familje në shumicën e rasteve janë gratë.

Flora Macula nga Fondi zhvillimor për gratë i Kombeve të Bashkuara (UNIFEM) bën të ditur se nga rastet e raportuara që nga paslufta në Kosovë lidhur me dhunën në familje, në 86 për qind të tyre, viktimat të dhunës janë gratë.

“Nga rastet e raportuara kemi këto statistika mirëpo jo gjithmonë raportimi i rasteve të dhunës tregon shifra të sakta. Shumë gra në shumë raste nuk raportojnë për dhunën që e përjetojnë dhe një gjë e tillë ndodhë akoma për shkak të mentalitetit në shoqërinë kosovare e posaçërisht në vendet rurale”, shprehet Macula. Mirëpo, sipas saj, është shpresëdhënësi fakti se nga viti në vit rastet e raportimit janë rritur.

“Është mjaft pozitive të theksohet se gratë tashmë Shërbimin Policor të Kosovës e konsiderojnë si institucion të besueshëm”, shton më tej ajo.

Sipas saj, çdo njeri ka nevojë për mbrojtje dhe siguri por edhe secili ka specifikat e veta.

Duke u bazuar statistikave, ajo thotë se institucionet vendëse përkatësisht, çdo udhëheqje nuk kanë bërë mjaft në këtë drejtim. “Është rritur besimi i viktimave në SHPK, mirëpo nga institucionet tona nuk është përmbushur premtimi se çka të bëhet më tej me gratë e viktimizuara.



Flora Macula

Konsideroj se Qeveria duhet të merret më seriozisht me këtë punë”, pohon ajo. Macula konsideron se gruaja në Kosovë nuk duhet shikuar si viktimë, por si forcë e zhvillimit të sigurisë. “Gruaja ka potencial të kontribuojë në rritjen e sigurisë të çdo personi por edhe të vetë grave”.

Edhe statistikave që posedon SHPK-ja flasin për një rritje të raportimit të dhunës.


Në vitin 2002 sipas këtyre statistikave ka pasur 1273 raste të raportimit të dhunës në familje, derisa në vitin 2006 sipas statistikave janë raportuar 1371 persona. Ndërkohë vetëm në katër-mujorin e parë të vitit 2007 në këtë polici janë raportuar 349 raste të dhunës.

Bazuar në të dhënat e SHPK-së, kjo dukuri më shumë prek gratë sesa burrat.


Nga 1370 rastet e raportuara në vitin 2005, në 81 për qind të tyre viktimat të dhunës janë gratë.

Ndërkohë kryesisht e dhunës familjare sipas strukturës gjinore janë 92 për qind meshkuj, ndërsa 8 për qind femra.

Të dhënat e përgatitura nga SHPK-ja bëjnë të ditur se ekzistojnë forma të ndryshme të manifestimit të dhunës në familje. Format më të shpeshta të raportuara janë: lëndimet trupore, sulm fizik, kanosje, keqtrajtim fizik, shqetësim, mosmarrëveshje, keqtrajtim psikik dhe largim me dhunë nga shtëpia etj.



Rastet e dhunës në familje në Kosovë në periudhën Janar 2002 – Prill 2007:



Fuqia dhe dhuna

janë kundërshti:

kur njëra ka pushtet të plotë, tjetra mungon.

Dhuna shfaqet kur fuqia

është në rrezik

dhe nëse ajo vazhdon të zhvillohet,

fuqia venitet.

Hannah Arendt

Atifete Jahjaga, ndër femrat e pakta të udhëheqjes së SHPK-së

Aspekti gjinor në SHPK nuk paraqet problem

Duke u fokusuar në sigurinë e gruas në Kosovë, Atifete Jahjaga konsideron se janë bërë shumë përmirësime pasi që, sipas saj, gratë tashmë janë vetëdijesuar që problemet që i kanë t'i raportojnë tek organet kompetente me qëllimin e vetëm që të jenë më të sigurta



PRISHTINË – Edhe pse është thuar se vetmja femër në udhëheqjen e lartë të Shërbimit Policor të Kosovës, Atifete Jahjaga ndihet mjaft e privilegjuar në punën që e bën.

Ajo aktualisht është asistente e zv.komisarit të SHPK-së për personel, trajnim, edukim dhe zhvillim, ndërsa shprehet se deri këtu ka arritur falë bashkëpunimit dhe ndihmës që i kanë dhënë kolegët që nga fillimi i punës së saj në SHPK.

“Mund lirisht të them se ndihem shkëlqyeshëm dhe për këtë kisha dashur që t'u jap një kompliment kolegëve të mi, pa përkrahjen e të cilëve çdo gjë do të ishte shumë më e vështirë, pasi që ne kemi raporte shumë korrekte dhe profesionale”, shprehet Jahjaga.

Ajo më tej shton se aspekti gjinor në SHPK nuk paraqet ndonjë problem sa u përket punëve të përditshme policore. “Mendoj se një sjellje e tillë në nivele të larta komanduese është reflektuar edhe në hierarkinë tonë profesionale. Çdo herë ne e shohim njëri-tjetrin si kolegë të barabartë dhe për ne nuk ka ndonjë dallim gjinor. Mendoj se në këtë aspekt duke mos qenë i vetëm, mundemi me qenë një shembull jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë”.

Jahjaga punën e saj në SHPK e kishte filluar në vitin 2000. Në fillim të punës së saj ajo kishte punuar si police në patrullë. Më pas kishte filluar rrugëtimin brenda vetë SHPK-së për të punuar në njësinë e hetimeve, e më pas edhe në njësi të tjera të specializuara. Ndërkohë teksa kishte punuar kishte mbajtur edhe shumë trajnime brenda dhe

jashtë Kosovës, si në qendrën e FBI-së në SHBA, qendrën Bramshill në Britani të Madhe, qendra Marshall në Gjermani, etj.

Duke pasur parasysh periudhën e vështirë në të cilën ka kaluar Kosova, Jahjaga gjendjen e sigurisë në vend e cilëson si mjaft të mirë. Duke u fokusuar në sigurinë e gruas në Kosovë, konsideron se janë bërë shumë përmirësime pasi që, sipas saj, gratë tashmë janë vetëdijesuar që problemet që i kanë t'i raportojnë tek organet kompetente me qëllimin e vetëm që të jenë më të sigurta.

“Mendoj se shoqëria në Kosovë ka kaluar mjaft hapa të zhvillimit, prej një roli pasiv që kishte femra shumë vite më parë... mendoj se ka ndërruar mjaft roli i femrës në shoqëri dhe në zhvillimin e pritur ekonomik. Kemi kaluar nëpër disa faza të ndryshme, duke u nisur nga ato kur femrat as që është menduar të raportojnë për ndonjë rast të dhunës. Jemi në fazën kur dhuna nuk pranohet, por raportohet dhe trajtohet si krim”, pohon Jahjaga.

Ajo shpreson mjaft që Kosova të mbërrijë në atë fazë, ku nuk do të ketë apo edhe të mos flitet fare për dhunë ndërgjinore, duke aluduar në ndihmën dhe përkrahjen e SHPK-së.

Në ditën kur nënën në tërë botën festojnë kremten e tyre, ajo porositi femrat në Kosovë që me brishtësinë, urtësinë dhe maturinë femërore të ndikojë secila në sferën e vet të jetës private dhe profesionale në ngritjen e rolit të femrës në shoqërinë kosovare.

Selviqe Bajrami

Gratë në media

Gazetaria, profesioni ku gjinia nuk është barrierë

Gazetaria është profesioni ku shkeljet gjinore janë në shkallë shumë më të ulët, krahasuar me profesionet e tjera në Kosovë, thonë gazetaret e medimeve të ndryshme kosovare

KOHA Ditore

BURBUQE THAÇI

PRISHTINË, MARS - Të jesh gazetare, njëkohësisht edhe grua dhe nënë, është sfidë jo fort e vogël. Megjithatë gazetaria është profesioni ku shkeljet gjinore janë në shkallë shumë më të ulët, krahasuar me profesionet e tjera në Kosovë. Kështu mendojnë disa nga gratë që punojnë në media, të cilat me një angazhim dhe përkushtim të madh thonë se kanë arritur të dyja anët e arta të medaljes, të jenë të zonja në profesion, por edhe në familje.

Ato thonë se me angazhim dhe shfrytëzimin maksimal të mundësive që ofron profesioni i gazetarisë dhe mënyrën racionale të ndarjes së kohës, arrihen të gjitha.

“Derisa shoqëria kosovare akoma nuk e ka hequr nga botëkuptimi i saj bindjen se femra duhet të jetë e dëgjueshme në raport me mashkullin, në gazetën ‘Koha Ditore’ në të cilën unë punoj për më shumë se gjashtë vjet, kjo gjë as që ka ekzistuar ndonjëherë”, thotë gazetaria Salie Gajtani - Osmankaq.

“Nga e gjithë përvoja ime gjashtëvjeçare, për asnjë moment të vetëm nuk kam vërejtur që këtu të ketë pasur dallime gjinore as në punë e as në ndërtimin e hierarkisë së drejtuesve të gazetës”, shprehet

gajtani- Osmankaq. Mirëpo as jashtë redaksisë asaj nuk i ka ndodhur të hasë në vështirësi të marrjes së informatave. “Më ka ndodhur të kem probleme me zyrtarë të ndryshëm, gjatë hulumtimit të temave, por kjo ka qenë çështje absolutisht profesionale e jo gjinore”, shprehet ajo duke shtuar se sa i përket diskriminimit gjinor, kryesisht dallimet lidhen me rrethin ku jeton. “Derisa në viset rurale akoma është evidente fakti se femrave u ndalohet lëvizja e lirë, e madje edhe e drejta e shkollimit, për rrethanat tjera ku fazat e shkeljes së këtyre të drejtave janë tejkualuar dhe përsëri ka ankesa të kësaj natyre, unë mendoj se kjo më tepër është një retorikë e kotë që përdoret për t’u fshehur prapa hezitimit që secili të kryejë detyrën e vet”.

Rëndom për gruan, punën, kontributin dhe sakrificat që ajo i bënë, flitet më 8 mars, thotë Sebiha Ramaxhiku, redaktore përgjegjëse në Radio- Dukagjini. Duke e cilësuar si jo të drejtë, ajo thotë se gruaja është prezente dhe kontribuon çdo ditë, 24 orë. “Dhe nëse e veçojmë vetëm një ditë për ta vlerësuar dhe për të treguar kujdes ndaj saj, nuk është e drejtë e aq më pak kur ajo sot është e pranishme në çdo lëmi të jetës”, thotë Ramaxhiku. Kur flet për pro-



Salije Gajtani - Osmankaq, “Koha Ditore”

fesionin e saj ajo krenohet me të arriturat e femrës në këtë lëmi. “Një plejadë e tërë e gazetareve të dëshmuara. Ani se kjo punë është atraktive, është profesioni i vështirë. Kërkon shumë sakrificë e në veçanti kur ke fëmijë dhe obligime në familje” thotë ajo. Karriera e saj prej gazetareje kishte filluar në vitet e 70- ta. Atëbotë, gazetaret ishin të pakta në numër. “Puna aktive, aktualiteti të dërgonte në çdo mjedis, moment historik, por ne gazetaret e asaj kohe ia dolëm”. Ramaxhiku mohon të ketë diskriminim në këtë profesion. “Unë personalisht nuk kam pasur probleme

të mëdha. Nuk guxon asnjë çast të ndihesh inferiore në krahasim me kolegët meshkuj. Sot është shumë më lehtë, shumë gjëra merren si më normale dhe shumë profesione dhe punë konsiderohen edhe të gruas”, thotë Ramaxhiku.

Për Antigona Ukën, redaktore në gazetën “Info Press”, padyshim se nuk kanë munguar vështirësitë në punë. Megjithatë ajo thekson se kur e ke për zemër një profesion, nuk ka vështirësi që nuk tejkalo-

het. “Në fakt ky profesion më shumë më ka krijuar lehtësi sesa vështirësi. Kjo për faktin se në gazetari nuk ke një orar strikt, të cilit medoemos duhet t’i përmbahesh. Unë arrij të ndjek ligjëratat në Departamentin e Psikologjisë në UP, ku studioj, dhe njëkohësisht të kryej punën time në “Infopress”, shprehet Uka. Ajo thotë se asnjëherë nuk është ndier e diskriminuar gjatë karrierës së saj prej gazetareje. “Mendoj se pikërisht gazetaria është profesioni ku shkeljet gjinore janë në shkallë shumë më të ulët, krahasuar me profesionet e tjera në Kosovë. Favorizime nuk më kujtohet të ketë pasur. Në “Infopress” çmohet puna dhe profesionalizimi i secilit, aq sa e meriton. Kjo për mendimin tim është shumë pozitive dhe shtytje për të perfek-



Antigona Uka, “Infopress”

sionuar secili vetveten”, konsideron ajo. Kurse sa u përket favorizimeve në baza gjinore, ato mendojnë se përderisa gratë profesionin e lënë në plan të dytë, ato nuk mund ta dëshmojnë veten sa duhet.

“Megjithëse gratë janë më të lidhura me familjen, fëmijët, dhe kjo mendoj se është arsyeja kryesore pse ato punën, profesionin e kalonin në plan dytësor, për dallim prej shumicës së meshkujve, që profesionin e kanë prioritet. Në këtë mënyrë ato nuk arrijnë të dëshmojnë sa duhet”, thotë Uka.

Flet gjyqtarja për të mitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, Fllanza Kadriu

Tridhjetë vjet në shërbim të drejtësisë

Fllanza Kadriu është nga Mitrovica. Në këtë qytet ajo kishte qenë femra e parë shqiptare që kishte marrë detyrën e gjyqtare. Tashmë punon në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe dënon të miturit që kryejnë vepra penale apo të rriturit që kryejnë vepra penale, ku viktimat janë fëmijët

KOHA Ditore

SELVIJE BAJRAMI

PRISHTINË - Sikurse rrallëherë, gjyqtarja për të mitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, Fllanza Kadriu, të hënën nuk kishte shumë punë. Në këtë ditë ajo nuk po mbante ndonjë seancë, siç i bën me dhjetëra gjatë një muaji të punës së saj, punë që e ushtron tani e gati tridhjetë vjet më parë. Gjyqtarja Kadriu është nga qyteti i Mitrovicës. Në këtë qytet, tashmë thuhet të ndarë në dysh, ajo kishte filluar punën e saj si gjyqtare, madje kishte qenë gjyqtarja e parë shqiptare në atë rajon. Ndërsa me mbarimin e luftës, ajo ka marrë pozitën e gjyqtare për të mitur në Prishtinë, ku tashmë edhe jeton.

Edhe pse kishte ushtruar punën e avokates gjatë tetë vjetëve të karrierës së saj, punën e gjyqtare thotë se nuk e ndërton tani me asnjë profesion tjetër.

“Është mjaft vështirë të ushtrosh ndonjë punë tjetër pas asaj të gjyqtare”, shprehet ajo. Megjithëse ushtrimin e profesionit të gjyqtare ajo kishte filluar ta ushtronte në një moshë shumë të re, ajo thotë se ka punuar me përkushtim dhe se ka pasur një përkrahje të madhe të kolegëve për të arritur deri këtu.

“Kam pasur përkrahje të madhe nga kolegët. Më kanë respektuar shumë dhe kanë respektuar punën time që e kam bërë.

Mirëpo, edhe tash përkrahja nuk më mungon”, bën të ditur Kadriu. Ajo shton se punën që e bën nuk e ka të vështirë për shkak se është e pavarur në vendimet që i merr në bashkëpunim me kolegët e tjerë. Megjithëse është femër, ajo thotë se një gjë e tillë nuk e ka penguar në ushtrimin e profesionit të saj. “Me kolegë nuk shikohemi si mashkull – femër, por si gjyqtar dhe gjyqtare”, shton ajo. Edhe pse ka dënuar shumë persona për kryerjen e shumë veprave penale, dhe ata kryesisht të mitur apo persona që kanë keq-trajtuar të miturit, Kadriu bën të ditur se asnjëherë në karrierën e saj nuk ka qenë e kërcënuar në mënyrë direkte.

“Kam dënuar shumë persona madje edhe me vite të tëra burgim, disa prej tyre ka pasur raste kur kanë ardhur në zyrën time dhe, edhe pse i kam dënuar, më kanë falënderuar për masat e ndryshme që ua kam shqiptuar atyre”, pohon ajo.

Me aplikimin e Ligjit Penal për të Mitur në Kosovë, gjyqtarja për të mitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë thotë se është shtuar puna e saj si gjyqtare. Me këtë ligj, sipas saj, janë shtuar edhe veprat penale p.sh; keqpërdorimi seksual me persona nën 16 vjet. Me këtë ajo bën të ditur se nuk gjykon vetëm për persona të mitur, por edhe persona të moshës madhore,

kur gjatë kryerjes së veprës penale viktimat kanë qenë fëmijët. “Unë punën time e kryej si gjyqtare. Në bazë të provave shqiptojmë edhe dënime, dëgjoj shumë dëshmitarë, shumë viktimat të përjetimeve të ndryshme... unë punën time e bëj mirëpo në momentin që unë e shqiptoj dënimin, nuk kam qasje më tek ato viktimat dhe më vjen keq për femrat kur janë viktimat të veprave të ndryshme”, thekson më tej ajo. Sipas saj, në Kosovë nevojitet

punë më e madhe me viktimat e veprave të ndryshme penale.

“Nga aspekti im shoh mungesa në sjelljen e popullatës me fëmijët. Dikur fëmijët kryenin thuhet vetëm vepra penale të vjedhjeve, ndërsa tani është shumë e pranishme dukuria kur ata kryejnë vepra penale të detyrimit”, pohon ajo.

Përveç punës së rregullt që Kadriu e bën në gjykatë, ajo me përkushtim të madh mban edhe trajnime të ndryshme në

Institutin Gjyqësor të Kosovës, është eksperte e certifikuar e Këshillit të Evropës për Konventën evropiane të të drejtave të njeriut, si dhe eksperte në mësimin klinik që organizohet me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës.

“Unë jam në trajnime shpeshherë edhe me kolegë. Nuk do të thotë që unë jam më e dijshe dhe i mësoj ata, mirëpo mësojmë nga përvoja e njëri-tjetrit”, përfundon Kadriu.



Burgu i vërtetë është frika dhe liria e vërtetë është çlirimi nga frika.

Aung San Suu Kyi

Në vend të urimit!

Këtu ku po jetojmë dhe po veprojmë, ende na duhet një ditë kur do të mund të ndihemi të veçanta dhe kur do të mund të ndihemi se kemi rastin të kërkojmë më shumë, më mirë dhe më drejt për femrën

MIMOZA KUSARI – LILA



Për çdo vit në të njëjtën datë - 8 Mars, me apo pa dashje deklarohet se nuk e pranoj këtë datë si ditën e femrës, pasi që unë mendoj se 365 ditët e vitit janë të miat dhe unë jam e lirë të vendos dhe të bëj çfarë dua gjatë gjithë vitit. Megjithatë, thellë në vete jam e bindur se deklaratat e mia kanë të bëjnë më tepër me realitetin që dua ta kem sesa me realitetin të cilin e jetoj. Heshtazi, edhe unë pres urimin dhe dhuratën e burrit, të vëllait apo kolegëve, për mundin dhe kohën që unë si femër ia përkushtoj mbajtjes e rregullit të familjes, punës dhe obligimeve të tjera shoqërore.

E pranoj se më shumë dëshirë dhe kënaqësi dhuratën ia dhuroj personit, një ndër më të dashurit të jetës sime. Nënës, që na rriti në katër fëmijët dhe sakrifikoi shumë për të gjithë që jemi ngritur mbi të. Kur e them këtë, nuk e mendoj vetëm nënën time, i mendoj të gjitha femrat, nënat dhe motrat e Kosovës, të gjitha ato që sakrifikuan dhe sakrifikojnë aq shumë për fëmijët, vëllezërit dhe familjarët e tyre.

Këtu ku po jetojmë dhe po veprojmë, ende na duhet një ditë kur do të ndihemi të veçanta dhe kur do të ndihemi se kemi rastin të kërkojmë më shumë, më mirë dhe më drejt për femrën.

Vitin e kaluar në të njëjtin muaj, në një konferencë për shtyp të organizuar nga Shtylla e Katërt e UNMIK-ut për gratë në biznes, një gazetar me pyeti: "A nuk të duket se mjaft keni arritur dhe mjaft keni kërkuar? Deri kur ju me deklarata se gratë në Kosovë duhet të kenë më shumë të drejta? Mendoj se keni mjaft të drejta..." Përgjigjja ime në këtë pyetje ishte: "Do të kërkojmë të drejta, përderisa ka njerëz dhe mendime sikur ky yti, deklarata kemi pasur mjaft, por realiteti është larg prej së qenit si duhet". Për të vazhduar pak më gjatë, atë çfarë nuk e thashë vitin e kaluar, e them tani:

Duhet ta festojmë 8 Marsin derisa na duhen kuota të garantuara në Parlament, derisa në konkurse të organizatave vendore dhe ndërkombëtare shkruan: Gratë dhe minoritetet inkurajohen të konkurrojnë (gratë 50% + i popullsisë barazohet me 5-6% tjetër të popullsisë në Kosovë), përderisa institucionet tona vendore publikojnë konkurse publike me këtë tekst: Kërkohej dy drejtorë dhe 1 asistentE, 1 udhëheqës dhe 1 përkthyesE, përderisa një nga zyrtarë diplomatike në Prishtinë (shtet anëtar i BE-së) publikon konkursin ku kërkon asistente të moshës 20 – 35 vjeçare (të pamartuar), përderisa një kryefamiljar në mes të dilemës së shkollimit të djalit dhe vajzës vendos të shkollojë djalë, dhe përderisa në maternitetin e Prishtinës (kryeqytetit të Republikës së Kosovës) infermieret, nëse lind djalë ta urojnë me buzëqeshje të madhe: "URIME, e ke lind një DJALË" ndërsa nëse ke lind vajzë shfrenjë dufin njëherë dhe të psherëritjës: "Nuse, e ke vajzë...nejsa...me fat". Mbese iu vije keq për beben e vogël se kur të rritet do të bëhet femër në shoqërinë kosovare dhe do të kalojë nëpër gjithë çfarë kanë kaluar ato në shtegun e jetës.

Ekziston thënia: "Prapa një burri të suksesshëm, gjendet një femër e suksesshme", ndërsa unë pyetem: kush duhet të qëndrojë prapa një femre të suksesshme. Përgjigjja në fakt do të varet shumë nga niveli i përgjithshëm shoqëror dhe zhvillimi ekonomik. Në Kosovë ka mendime që janë prindërit apo bashkëshorti, shumë rrallë mund të thuhet tek ne se një femër është ngritur dhe ia ka arritur, se ia ka mundur shoqëria apo institucionet vendore. Suksesi i femrave ende varet nga rrethi dhe familja. Të paktën disa në rastin tim ma thonë haptas: "E ke bashkëshortin e mirë, prandaj mundesh...", rrallëkush m'i përmend prindërit apo punën time që duhet të ma shpërblejë mundin... Sipas konceptit të shumicës në shoqërinë kosovare, suksesi i një femre varet nga leja që ajo merr nga gjinia mashkullore në shtëpi, qoftë ai bashkëshorti, babai apo vëllai.

Në rastin konkret, është e vërtetë se kemi gjuhë dhe parime të përbashkëta me bashkëshortin, por vitet e shkollimit, të ngritjes dhe të edukatës i kam marrë pikërisht nga një grua tjetër, Nëna ime. Ndërsa ajo i ka marrë nga një grua tjetër, po qe e pashkollë, por me parime dhe integritet shumë të fortë, Nëna e saj. Të dy prindërit kanë shumë ndikim në rritjen e fëmijës, por Nëna është e pazëvendësueshme dhe asgjë nuk mund të ndikojë më shumë tek fëmija se edukata dhe fryma e nënës.

Atëherë nga fjalët të kaluara në vepra dhe në vend të ankesës për vlerat e përmbytura të shoqërisë, të fokusohemi në edukim, me theks në edukimin e femrave. Të gjithë në shoqërinë tonë duhet edukuar me parime të mundësive të barabarta.

Nënkuptohet se zhvillimi ekonomik, në shumicën e rasteve, ndikon në të gjitha zhvillimet e tjera shoqërore. Kosova nuk është përjashtim nga rasti. Në Kosovë ekonomia është në nivel shumë të ulët të zhvillimit, ndërsa femra është shumë pak e pranishme në këto zhvillime, nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve private vetëm 2% janë të regjistruara apo menaxhohen nga gratë. Në politikë mezi e fituam gruan e tretë të udhëheqë një subjekt politik dhe madje jashtë Parlamentit të Kosovës, ndërsa si udhëheqëse të korporatave nuk e kemi asnjë grua. Numri shumë i vogël i grave është edhe në nivelin e mësimdhënësve në arsimin e lartë në Kosovë. Gratë në shoqërinë kosovare nuk e kanë ende vendin e duhur. Të drejtat e tyre me ligj mbrohen, por flasin për një shoqëri ku sundimi i ligjit është hallka më e dobët e shoqërisë.

Do të ndalem këtu, të marr frymën dhe të vë buzëqeshjen në fytyrë, për secilën grua, nënë, motër që e kam pranë dhe ti them: "Gëzuar e dashur dita jote, qofshin të gjitha të tjerat ditë tuaja, pa lot, pa dhimbje, pa varfëri, se ke përjetuar dhe je përbuzur mjaft, ardhhtë shumë shpejt dita kur fati yt është në duart tua".

(Autorja është drejtoreshë ekzekutive e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë)



Dita e Gruas – 8 Marsi

Ka lindur para një shekulli në kohën e përparimeve të mëdha industriale, por edhe të turbulencave, krizave dhe ideologjive radikale. Më 1910 është shënuar një segregacion i theksuar gjinor dhe një përfshirje minimale e grave në punë në vendet e zhvilluara industrialisht. Ato që ishin të punësuar zakonisht kanë punuar në industrinë e tekstit, manufakturë apo si ndihmëse në punët e shtëpisë. Kësisoj ato kanë punuar në kushte shumë të vështira dhe me paga tejet të ulëta.

Në të njëjtën kohë, industrinë e kishte goditur një krizë e theksuar. Shoqatat e punëtorëve, të cilat nuk ishin pjesë e sindikatave u gjetën në një pozitë shumë të vështirë, ndërkohë që fuqia e sindikatave gjithnjë e më tepër rritej.

Në Evropë, Britani të Madhe, Amerikë dhe diç më pak në Australi, gratë kishin nisur të ngrinin zërin për të drejtat e tyre.

ShBA (1903) – Sindikata dhe shoqatat e pavarura të grave, të cilat mbështetnin të drejtën e grave për votim themeluan Lidhjen e grave sindikaliste (Women's Trade Union League), në mënyrë që t'u ndihmonin punëtorëve në forcimin e tyre politik dhe ekonomik.

1908 – Në javën e fundit të vitit, respektivisht në shkurt të 1908, socialistet amerikanë kanë kremtuar për herë të parë Ditën e Grave, duke mbajtur protesta të mëdha. Ato kërkuan jo vetëm të drejtën e votës, por edhe të drejta ekonomike dhe politike. Një vit më vonë në demonstratat në Mannhatn morën pjesë më se 2000 njerëz.

1909 – Gratë e punësuar në industrinë e tekstit kanë mbajtur një grevë të përgjithshme. Më se 30.000 punëtorë, për 13 javë kanë bërë grevë në kërkim të pagave dhe kushteve më të mira të punës.

1910 – Ditën e Gruas e kanë pranuar feministet socialiste në gjithë ShBA-në.

Kopenhagë (1910) – Përfaqësueset e

Sindikatës kanë marrë pjesë në Konferencën e dytë ndërkombëtare të socialistëve në Kopenhagë me qëllimin që Ditën e Gruas të propozojnë ta shndërrojnë në kremte ndërkombëtare. Në këtë kohë Partia Socialiste e Gjermanisë kishte ndikim të madh në skenën ndërkombëtare socialiste dhe angazhohej për të drejtën e votës për gra. Në konferencë kanë marrë pjesë qindra gra nga 17 vende, përfaqësues të sindikatave, partive socialiste, klubeve të punëtorëve dhe tri femra të zgjedhura në Parlamentin e Filipineve. Propozimi i gjermanes Clare Zetkin është miratuar njëzëri, ndaj me të parashihet shënimi i Ditës së Grave. Në këtë konferencë është kërkuar e drejta e votës për gratë. Njëra nga kërkesat e Konferencës ishte që ndërrimi i natës të shpallet i dëmshëm për shëndetin e grave. Ky propozim është kundërshtuar nga gratë nga Suedia dhe Danimarka, të cilat kanë thënë se puna në këtë ndërrim është burim i domosdoshëm për ekzistencën e tyre.

1911 – Si rezultat i Konferencës së Kopenagës, Dita e Grave është shënuar për herë të parë më 1911 në Austri, Danimarkë, Gjermani dhe Zvicër. Ajo është kremtuar nga 1 milion gra dhe burra. Përveç kërkesës që gratë të kenë të drejtë vote, u kërkua edhe e drejta për punë, ngritje profesionale dhe ndërprerje të diskriminimit gjinor. Një javë më pas në një zjarr në Nju-Jork humbën jetën 140 punëtorë, kryesisht italiane dhe emigrante izraelite.

Rusi (1913-1914) – Si pjesë e lëvizjes paqësore, e cila u fill në prag të Luftës së Parë Botërore, gratë ruse për herë të parë shënuan Ditën e Grave në javën e fundit të shkurtit të vitit 1913. Në vendet e tjera të Evropës, kjo ditë u shënuar më 8 Mars dhe ishte një protestë dhe përkrahje për gratë ruse.

1917 – Rusia mbeti pa 2 milionë ushtarë të saj. Gratë sërisht protestuan, kremtuan ditën e tyre në javën e fundit të shkurtit dhe kërkuar "bukë dhe paqe". Kërkesat politike u përpoqën të shpërndareshin marshin e grave ruse. Katër ditë më vonë, cari rus lejoi të drejtën e grave për votim.

Shumica në kërkim të së kaluarës

Vendosja e grave në histori

Për gratë, problemi në të vërtetë qëndron në faktin se na mungon vetëbesimi që duhet për t'i përdorur veglat, sidomos vetëbesimi për të krijuar vegla të reja, sipas nevojës. Këtë duhet ta bëjmë duke u bazuar në aftësitë tona të mësura dhe në skepticizmin tonë racional të doktrinës së trashëguar

GERDA LERNER

Historianët amerikanë në këto pesë vjetët e fundit janë munduar ta zhvillojnë historinë e grave si një fushë të pavarur dhe ta gjejnë një kornizë konceptuale me një metodologji përkatëse.

Niveli i parë me të cilin këta historianë të aftësuar në histori tradicionale i janë qasur historisë së grave ka qenë të shkrimi i historisë së grave, të cilat kanë qenë "gra të vlefshme", ose në vend të kësaj kanë shkruar "histori kompensuese". Cilat janë gratë që mungojnë nga historia? Cilat janë ato gra që kanë arritur diçka dhe çka kanë arritur ato? Si rezultat kemi histori të "grave të mbërritura", që nuk na tregojnë shumë për aktivitetet e shumicës së grave dhe as nuk na tregojnë shumë për rëndësinë e aktiviteteve të grave në shoqëri në përgjithësi. Historia e grave të mbërritura është histori e grave të jashtëzakonshme, ndonjëherë edhe e grave devijues, e në asnjë mënyrë nuk i përshkruan përvojat dhe historinë e shumicës së grave. Kjo analizë është rezultat i një vetëdije të dallimeve klasore në histori: Gratë e klasave të ndryshme kanë përvoja të ndryshme historike. Për ta kuptuar ndërlikueshmërinë e shoqërive të ndryshme në faza të ndryshme të zhvillimit, është thelbësore që t'i kemi parasysh dallimet e tilla.

Gratë po ashtu kanë përvoja të ndryshme në raport me vetëdijen, varësisht a ka qenë puna e tyre, shprehja dhe aktiviteti i tyre i definuar nga mashkulli apo i orientuar nga gratë. Gratë janë të indoktrinuara në sistemin mashkullor të vlerave dhe e çojnë jetën e tyre në varshmëri të këtij sistemi të vlerave, kështu që sistemi kolonial i shekullit IX dhe femrat reformiste e kanë drejtuar aktivitetin e tyre në kanale që kanë qenë vetëm zgjerim i roleve të tyre tradicionale dhe telasheve të tyre shtëpiake. Ato kanë dhënë mësim në shkollë, janë kujdesur për të varfrit, të sëmurët dhe pleqtë. Me ngritjen e vetëdijes, ato kanë orientuar vëmendjen nga nevojat e grave; duke qenë kështu më të orientuara nga gratë për t'i dhënë fund shtypjes së gruas, ta zhvillojnë edukimin e femrave dhe "t'i ngrënë" prostitutat, por të gjitha këto në kuadër të ngritjes së gruas për ta kryer më mirë rolin e saj tradicional. Vetëm në fazat e mëvonshme, duke dalë nga të kuptuarit e gruas si një grup me interesa speciale, me rol të nënshtruar në shoqëri, ato ngritën vetëdijen e tyre dhe aktiviteti i tyre u përqendrua në gratë. Mendimet feministe fillojnë në këtë kohë, të përcjella me kërkesë aktive të përmbushjes së të drejtave dhe nevojave të gruas. Këto faza të ndryshme të vetëdijes së femrës duhet t'i marrim parasysh gjatë analizës historike.

Niveli tjetër i konceptualizimit të historisë së grave ka qenë "historia kontribuese": duke e përshkruar kështu kontributin e grave,

gjendjen dhe shtypjen nga shoqëria mashkullore. Në këtë kategori gjejmë variacione të ndryshme të pyetjeve, si: çka kanë kontribuar gratë për ta përfunduar shtypjen, për reforma, për lëvizjen progresive, për lëvizjen e punëtorëve? Këto lëvizje janë ende nën hetime; gratë kanë dhënë "kontributin" e tyre; kontributi së pari është gjykuar në raport me efektet që kishte për lëvizjen dhe pastaj me standarde të përshtatshme për meshkuj.

Mënyrat me të cilat gratë janë ndihmuar dhe prekur nga puna e këtyre "grave të mëdha", mënyrat në të cilën ato vetë erdhën deri te një vetëdije feministe janë injoruar. Kontributi i madh i Jane Addamsit në krijimin e rrjetit të grave dhe strukturave të reja të jetesës i është nënshtruar rolit të saj të një gruaje progresive ose të një interpretimi që e sheh atë vetëm si përfaqësuese të një grupi të frustruar të grave me fakultet që nuk kanë nga t'ia mbajnë. Me fjalë të tjera, një devijuese nga normat mashkullore. Margaret Sangeri është parë vetëm si themeluese e lëvizjes për kontracëpcion, e jo si grua që ka sfiduar në mënyrë revolucionare praktikatat shekullore në të cilat trupat dhe jetët e grave janë dominuar dhe kontrolluar nga ligjet e bëra nga meshkujt. Në lëvizjen e punëtorëve, gratë janë përshkruar si një lloj "pjesëmarrësi" ose si problem. Roli i tyre esencial për vete dhe për gratë e tjera rrallë herë konsiderohet temë qendrore kur shkruhet historia e tyre. Gratë janë një nëngrup, me fjalë të Simone de Beauvoirit: "Tjetra". Një mori tjetër pyetjesh kanë të bëjnë me shtypjen dhe luftën për të drejtat e grave. Kush i ka shtypur gratë dhe si? Dhe cila ka qenë përgjigjja e tyre?

Këto pyetje kanë korrur të dhëna të detajuara për shtypjen ekonomike dhe sociale dhe për format e ndryshme të organizuara politike në të cilat gratë si grup kanë luftuar shtypjen e tillë. Duke gjykuar nga rezultatet, është e qartë se ia vlen të pyesim pse dhe si janë viktimizuar gratë. Në mësojmë se çka iu kanë bërë grave shoqëritë dhe individët ose klasat e ndryshme të njerëzve dhe mësojmë se çka kanë bërë gratë dhe si kanë reaguar ato në kushtet e imponuara. Derisa statusi inferior dhe kufizimet e ndryshme shtypëse kanë qenë pa dyshim aspekt i përvojës historike të grave dhe si i tillë ky status duhet shënuar, kufizimet e kësaj qasjeje na bëjnë t'i shohim gratë si kryesisht pasive, ose në rastin më të mirë, si të tilla që kanë reaguar në shtypjet e meshkujve dhe ndalesat e shoqërisë patriarkale. Ky hulumtim nuk mund të nxjerrë në pah në mënyrë pozitive dhe esenciale se si kanë funksionuar gratë në shoqëri. Merry Beard ka qenë e para që e ka cekur kontributin e vazhdueshëm të grave në zhvillimin e kulturës njerëzore që nuk mund të shihet nëse i shohim

gratë vetëm si viktimat të shtypjes. Është shumë më e dobishme që t'i qasemi kësaj çështjeje si një aspekti të historisë së grave, por mos ta konsiderojmë kurrë si aspekt qendror të historisë së tyre. Në fakt, me trajtimin e grave si viktimat të shtypjes ne edhe një herë i vejmë ato në kornizën konceptuale mashkullore: të shtypura, të viktimizuara me standarde dhe vlera të vëna nga meshkujt. Historia e vërtetë e grave është histori e një funksionimi të vazhdueshëm në botën mashkullore në mënyrën e tyre. Çështja e shtypjes nuk e thekson këtë tregim dhe për këtë arsye është vegël me vlerë të kufizuar për historianët.

Fokusi kryesor i historisë së grave ka qenë në lëvizjen për të drejtat e grave dhe në organizimin dhe institucionalizimin e historisë së lëvizjes së grave dhe udhëheqëseve të lëvizjes. Ky është një aspekt i rëndësishëm i historisë së grave, por nuk duhet ta këtë rolin qendror.

Historia e grave paraqet një sfidë për ndarjen e historisë tradicionale në periudha. Periudhat në të cilat kanë ndodhur ndryshimet bazike në shoqëri dhe të cilat historianët i kanë parë si pika referimi për të gjitha zhvillimet historike nuk janë domosdoshmërisht njëjtë për meshkuj dhe për femra. Kjo nuk na befason kur kemi parasysh se korniza tradicionale në histori është nxjerrë prej historive politike. Gratë kanë qenë grupi i cili ka qenë i përjashtuar nga pushteti politik për një kohë të gjatë në histori, sidomos kanë qenë të përjashtuara nga vendim-marrja ushtarake. Kështu që ndarja në periudha e bazuar në zhvillimin ushtarak dhe politik është jo fort e rëndësishme për përvojat e tyre historike.

Gratë janë dhe kanë qenë gjithmonë gjysma e njerëzimit, e ndonjëherë kanë qenë edhe shumica. Margjinaliteti i tyre kulturor dhe psikologjik i determinuar i bën përvojat historike të grave thelbë-

sisht tjera prej atyre të meshkujve. Por meshkujt i kanë definuar përvojat e tyre si historike dhe i kanë lënë gratë jashtë tyre. Gjatë kësaj kohe, sikurse edhe gjatë periudhave më të hershme të aktivitetit feminist, gratë kanë hyrë në vende të zbrazëta, duke supozuar edhe më tej statusin e tyre marginal të "nëngrupit". Por e vërteta është se historia, ashtu si është shkruar dhe perceptuar deri më tash, është histori e pakicës, e cila mund të jetë edhe "nëngrup". Për t'u shkruar një histori e re që do ta meritonte të quhej tamam histori, duhet ta kemi parasysh se nuk ka vetëm një metodologji apo vetëm një kornizë konceptuale, në të cilën do të mund të merrnin pjesë të gjitha kompleksitetet dhe përvojat historike të krejt grave. Faza e parë e kësaj "historie në transicion" është që t'u shtojmë kategori të reja atyre ekzistuese: seksualiteti, riprodhimi dhe lidhja në mes të rritjes së fëmijëve dhe edukimit të tyre; indoktrinimi i roleve; vlerat dhe mitet seksuale; vetëdija femërore. Më tutje, të gjitha këto duhet të analizohen duke e pasur parasysh racën, klasën, etninë dhe ndoshta edhe religjionin. Ajo që do ta kishim në këtë rast nuk është vetëm një kornizë e re për gratë në histori, por një pikëpyetje për tërë historinë. Faza e ardhshme është që të hulumtojmë mundësinë që ajo që e njohim si histori të grave të mund në fakt të jetë studim i veçantë i kulturës së grave. Një kulturë e tillë do të përfshinte profesionet, statusin, përvojat dhe ritualet e veçanta të grave, e në të njëjtën kohë edhe vetëdijen e tyre që i përmbrendëson. Në disa raste, kjo do të thotë që tensionet e krijuara në kulturë në mes të supozimeve patriarkale dhe përpjekjes së grave për autonomi dhe emancipim duhet të përfshihen gjithashtu.

Pyetjet e bëra për të kaluarën e grave kërkojnë qasje interdisiplinare. Ato po ashtu kërkojnë edhe

projekte të mëdha hulumtimesh grupore, që do të na jepnin përgjigje që nuk i përkasin vetëm një kohe të caktuar ose një shoqërie ose një periudhe të caktuar, por përgjigje të cilat i përkasin një organizmi funksional, një tërësie, një shoqërie në të cilën jetojnë meshkujt dhe femrat. Faza e ardhshme do të ishte zhvillimi i një sinteze: historia e dialektikës, tensioni në mes të dy kulturave, mashkullore dhe femërore. Një këso sinteze mund të bazohet në një studim krahasues të periudhave të caktuara, me të cilin studim përvojat historike të burrave krahasohen me ato të grave dhe tensionet e ndërveprimet mes tyre bëhen temë studimi po aq sa dallimet. Vetëm pas një varg studimesh të tilla të detajizuara mund të shprejsojmë t'i gjejmë parametrat me të cilat e definojmë historinë e re universale. Mund të vë bast se asnjë nga kornizat konceptuale nuk do t'i përshtatej një subjekti aq kompleks.


Metodat janë mjete për analizë – disa nga ne veprojmë me vetëm një mjet e disa të tjerë do të kërkojnë mjete të tjera, sipas nevojës. Për gratë, problemi në të vërtetë qëndron në faktin se na mungon vetëbesimi që duhet për t'i përdorur veglat, sidomos vetëbesimi për të krijuar vegla të reja, sipas nevojës. Këtë duhet ta bëjmë duke u bazuar në aftësitë tona të mësura dhe skepticizmin tonë racional të doktrinës së trashëguar. Shumë prej nesh e kemi përjetuar mohimin e historisë sonë si një goditje të rrufesë që na e ka zgjuar vetëdijen në mënyrë të pakthyeshme. Kemi ecur shumë përpara. Hapi tjetër do të ishte që të ballafaqohemi njëherë e përgjithmonë me të gjitha pasojat komplekse, sepse gratë janë shumica e njerëzimit dhe kanë qenë esenciale për krijimin e historisë. Pra, e tërë historia e deritashme për gratë është thjesht parahistori.



Historia e grave është mjeti më i fuqishëm për emancipimin e grave

Gerda Lerner

Nuk do të ketë
rend të ri botëror
nëse gratë nuk janë
pjesë e tij.





Si mbijetuan gratë e Çallapekëve në Tërstenik të Drenasit

Bamirësia nxori katër gra nga mizoria

“Për mua është shumë e rëndësishme t’i shoh ato të motivuara për ta ndihmuar vetveten. Këto familje kanë jetë më të mirë, vullnet për të jetuar dhe e gjithë kjo më bën shumë të lumtur”, thotë Dorothea Frankhauser, gruaja që ua ktheu vullnetin për jetë dhe ua dha të mbarën grave të veja të Çallapekëve

KOHA
Ditore

FATMIRE TËRDEVCI

TËRSTENIK, DRENAS, MARS – Nga dy koshere bletësh dhe serra të mbuluara me qese të mëdha plastike janë të vendosura në oborret e katër shtëpive të vogla njëkatëshe, që radhiten njëra pas tjetrës skaj rrugës së pluhurosur të fshatit Tërstenik të Drenasit. Kakarima e pulave dhe gazi i lojës së fëmijëve u japin jetë oborreve të pjerrëta dhe me gropa. Të katër shtëpitë u takojnë katër grave kryefamiljare, Hanë, Hasë, Selvie dhe Zarife Çallapekut, burrat, dy nga të cilët vëllezër dhe të tjerët kushërinj janë dëshmorë lufte. Të mbetura të veja dhe me fëmijë në një moshë të re, gjatë viteve të para të pasluftës ato ishin përballur me varfëri të skajshme. Shtëpitë u ishin ndër-tuar nga një organizatë humanitare, por gjithçka tjetër mungonte, bile edhe ushqimi. Kështu kishin kaluar pesë vitet e para të pasluftës. “Valla kena rru keq. Kurgjo nuk kemi pasë, bile as ujë”, rrëfen Zarife Çallapeku, 46-vjeçare, nënë e tetë fëmijëve.

Bashkë me tri gratë e tjera, ajo duhej të bënte disa minuta në këmbë për t’u furnizuar me ujë, duke pritur në radhën e gjatë të grave të tjera të fshatit.

Por, jeta e katër grave mori një drejtim tjetër, kur fare rastësisht fshatin e kishte vizituar Beatrice Rutishauser, përfaqësuese e Caritasit zviceran, me qëllim që të fillonte një projekt shkollor. Nga banorët e fshatit, ajo ishte drejtuar tek katër familjet Çallapeku, dhe kishte mbetur e prekur nga jeta e rëndë që bënin ato. Përshtypjet e saj, ajo i kishte përcjellë tek miku i saj Nigel Robinson nga Anglia dhe Burim Zherka nga Gjakova, të cilët menjëherë u kishin sjellë atyre ushqim dhe veshmbathje, ndërsa më pas projektit për ndihmë familjeve Çallapeku iu kishte



Mijëra kilometra larg, artistja Frankhauser është e lidhur ngushtë me katër familjet e Tërstenikut, duke u interesuar për gjithçka që i rrethon. “Ata janë familja ime dhe unë i dua shumë”, shkruan ajo nga Zvicra

bashkuar edhe Dorothea Frankhauser nga Zvicra, e cila nuk kishte vonuar për të ardhur në Kosovë, me qëllim që të filloje projektet e saj humanitare, një ndër të cilët edhe ndihma për Çallapekët. Në partneritet me organizatën joqeveritare “Acacia” nga Zvicra, ajo kishte filluar identifikimin e nevojave më të domosdoshme për familjet. Uji dhe ushqimi ishin ato që u duheshin më së shumti katër familjeve. Frankhauser dhe partnerët e saj humanitarë nuk kishin për qëllim vetëm sigurimin e ndihmave, por angazhimin e vetë kryefamiljareve për t’u vetëmbajtur.

“Na i çeli bunaret, na i bleu pumpat për ujë për mos me shku larg me mush ujë, e masanej na e

bleu edhe nga një lopë”, rrëfen Zarifa. Gratë ishin shumë të angazhuara rreth punëve të shtëpisë, ndërsa fëmijët shumë të vegjël. Toka e tyre në mungesë të burrave mbetej gjithmonë e papunuar. Frankhauser kishte menduar dhe gjetur zgjidhje edhe për këtë. Ajo kishte paguar një burrë nga fshati për të punuar me traktor tokën e katër grave Çallapeku. Kështu, jeta e tyre po bëhet gjithnjë e më e lehtë. Ato më nuk mendojnë se çfarë do t’u shtrojnë në sofër fëmijëve të tyre. “Tamël, djathë, kos, vo e tana të mirat, krejt çka i duhen njerit për me rru”, thotë Zarifa. Frankhauser ua kishte ndërtuar atyre edhe stallet, ndërsa veshmbathje, mbulesa e jorganë siguroheshin nga Nigel

Robinson nga Anglia. E gjithë ndihma u kishte dhënë vullnet grave për të dalë nga mizoria, në të cilën jetonin për pesë vjet. “Boll mirë po rruojna, thmija po shkojnë në shkollë, me hangër e me pi po kena. Po marrim ndihma, por po punojmë edhe vetë. Tana t’mirat i kena”, thotë Zarifa.

Mijëra kilometra larg, artistja Frankhauser është e lidhur ngushtë me katër familjet e Tërstenikut, duke u interesuar për gjithçka që i rrethon. “Ata janë familja ime dhe unë i dua shumë”, shkruan ajo nga Zvicra. Me gjithë obligimet e punës dhe ato familjare, ajo gjen kohë për ta vizituar “familjen” e saj të madhe në Kosovë. Dhe gjithnjë pritet me shumë ngrohtësi dhe dashuri

nga të gjithë. “Herën e parë që i kam parë, ato ishin pothuajse të paralizuar dhe të pamotivuar për të bërë ndonjë gjë për të dalë nga mizoria, por tani është një atmosferë e gëzuar në shtëpitë e tyre. Ato kanë mbjellë edhe lule para shtëpive dhe kjo e tregon gjendjen e tyre shpirtërore”, shkruan ajo.

Gjatë vizitës së fundit, të katër gratë me krenari ia kishin treguar asaj progresin nga vjelja e perimeve. “Për mua është shumë e rëndësishme t’i shoh ato të motivuara për ta ndihmuar vetveten. Këto familje kanë jetë më të mirë, vullnet për të jetuar dhe e gjithë kjo më bën shumë të lumtur”, thotë ajo.

Në projektin për t’i ndihmuar familjet Çallapeku, Frankhauser kishte angazhuar edhe familjen e saj, madje edhe mbesën e saj Lia, 12-vjeçare dhe nipin Amos, nëntëvjeçar. Lia madje ka krijuar shoqëri me moshataren e saj Kaltrinën, bijen e Zarifes. Ato madje shkëmbejnë vizatime dhe letra të shkurtra me fjalë nga gjuha e njëra-tjetrës. Bashkë me vëllanë e saj, Lia kishte organizuar shfaqje për shoqërinë dhe prindërit e tyre, duke mbledhur 250 euro, me të cilat kishin blerë dhurata për ditëlindje për fëmijët e familjeve Çallapeku. Frankhauser dhe partnerët e saj kujdesen edhe për shëndetin e tyre, duke ua mundësuar atyre vizitat mjekësore dhe dentare, ndërsa vitin e kaluar kanë ndihmuar njërën nga gratë e prekur me tumor. “Për të janë siguruar të gjitha mjekimet, vizitat e mjekëve, analizat”, tregon Burim Zherka, aktivist humanitar. Edhe ai Çallapekët i ndien shumë të afërt. “Ato kanë vullnet për të punuar dhe jetuar. Nuk presin vetëm ndihma, por më e rëndësishmja është që ato gra duan ta ndihmojnë vetveten”, thotë Zherka.



Është mahnitës fakti
se për ta bërë
botën më të mirë,
askush nuk ka nevojë
të presë as edhe një moment.

Anne Frank

Ish-sekretarja amerikane, Madeleine Albright, diskuton për vështirësitë e grave në postet me fuqi politike

Albright: Ta mbështesim njëra-tjetrën, lufta jonë është larg fundit

“Më shumë kam pasur probleme me burrat në Qeverinë tonë (amerikane), jo për shkak se të gjithë janë derra mashkullorë shovinistë, por sepse më kanë parë duke u ngjitur nëpër hierarkinë shoqërore. Unë kam qenë mikeshë e grave të tyre, kam qenë staf, apo kam qenë ajo nëna që e shtyn veturën e saj, ose kam qenë shumë e mirë në përgatitjen e kafesë dhe e di që e kanë menduar dhe e kanë thënë “Si u bë që ajo të jetë sekretare e Shtetit, kur unë do të duhej të bëhesha””

“Kur doli emri im në listë për sekretare të Shtetit, njerëzit thoshin se do të më shfaqen probleme në përballjen me shtetet e huaja, posaçërisht me shtetet islame. Mirëpo doli ashtu që unë nuk e pata asnjë problem, kur arrija në shtetet tjera, me një aeroplan të madh me mbishkrim Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Unë e përfaqësoja SHBA-në dhe ata e dinin se duhej të bënin marrëveshje me mua. Mirëpo më shumë kam pasur probleme me burrat në Qeverinë tonë, jo për shkak faktit se të gjithë janë derra mashkullorë shovinistë, por sepse më kanë parë duke u ngjitur nëpër hierarkinë shoqërore, unë kam qenë mikeshë e grave të tyre, kam qenë staf, apo unë kam qenë ajo nëna që e shtyn veturën e saj, ose kam qenë shumë e mirë në përgatitjen e kafesë dhe gjëra të ndryshme, dhe e di që e kanë menduar dhe e kanë thënë “Si u bë që ajo të jetë sekretare e Shtetit, kur unë do të duhej të bëhesha”. E vërteta është, që ti gjithnjë mendon se gjithçka do të marrë fund, në momentin që e merr këtë vend pune, por jo, mendoj se kjo është pjesa më e vështirë me të cilën përballesh, edhe pse ti i bën gjërat ashtu siç duhet. Unë ndoshta kam qenë më e fortë se burrat e administratës sonë, dhe unë kam qenë ajo... është e qartë që presidenti Clinton ka marrë vendime, dhe ne kemi vendosur që do të përdorim forcën ushtarake në Kosovë në mënyrë që t'i shpëtojmë njerëzit nga spastrimi etnik dhe ishin burrat që nuk ishin aq të bindur që duhej bërë këtë, ndërsa gjëja më e vështirë për mua ishte gjatë kohës kur kam qenë ambasadore e UN-it, Gjeneral Powell i cili ishte kryetari i “Joint Chiefs of Staff”, dhe unë e ndieja fuqishëm që neve po na mungon esenca e çështjes së Bosnjës dhe sa isha në New York e dëgjoja këtë tërë kohën dhe unë argumentoja se duhet përdorur forca ushtarake në Bosnjë dhe meshkujt në atë tavolinë më thanë: “Madeleine, mundohu të mos jesh aq e ndjeshme” dhe Gjeneral Power më tha: “Madeleine, ti nuk e kupton se çfarë bën ushtria”. Po ju tregoj këtë, pasi që ai tanimë e ka publikuar këtë gjë, dhe ndihem mjaft rehat që edhe unë ta them. Ai më tha që unë po insistoja shumë me propozimin tim që t'i futnim trupat ushtarake në Bosnjë. Ai po ashtu shkroi në librin e tij, që i është dashur t'ia shpjegonte me “mjaft durim” ambasadores Albright se për cilat shkaqe shërbejnë trupat ushtarake dhe unë në këtë rast për të isha një vdekatare femër e nge-

cur civile, që përballej me heroin e botës perëndimore.

Singerisht e çmoj Colin Powell-in dhe jemi miq të mirë, por ai vinte në takime i veshur me uniformë ushtarake i ngarkuar me “tona metale” medalje, ndërsa unë kisha një gilpërë të vogël, madje njëherë më pati ndodhur të ngatërrohem me njëren prej tyre, përderisa përshëndeteshja me të, dhe numri i gradimeve të tija rritej prej takimit në takim.

Ai e përfundoi librin dhe siç e dini ai tanimë nuk e mban atë post. Ne përdorim forcën”, ka thënë vitin e kaluar ish-sekretarja amerikane Albright gjatë një debati me temë “Gratë dhe politika amerikane”. E lutur të komentojë momentin kur në një debat për luftën në Bosnje ajo i kishte thënë Colin Powellit, atëherë shef i ushtrisë amerikane, “Ç’na duhet kjo forcë e fuqishme ushtarake, nëse nuk do ta përdorim?”, Albright ka thënë: “Në një aspekt, është e vërtetë se femrat, meshkujt të cilët nuk kanë kaluar nëpër shërbimin ushtarak, janë në pozitë më të disfavorshme për të shprehur qëndrimet e tyre në lidhje me çështjet ushtarake. Kjo është situata me presidentin e tanishëm, ish-presidentin dhe kjo do të shfaqet si problem edhe për presidentin e ardhshëm, për shkak se ka shumë pak prej tyre të cilët e kanë kryer shërbimin ushtarak. Por unë mendoj se ekziston mënyra për të shprehur prezencën autoritative/komanduese. Askush prej nesh nuk mund ta mohojë se është vështirë, ne ia dolëm, por nuk ishte e lehtë. Pjesa më e çuditshme për mua ishte të bëhesha sekretare e Shtetit, nëse më lejohet të them me mbështetje të jashtëzakonshme nga Hillary Clinton edhe me besimin e dhënë nga presidenti i Shtetit.

Prapëseprapë çdo ditë më është dashur t'ia dëshmoja kryetarit të “Joining Chiefs Staff”, sekretarit të Mbrojtjes, këshilltarit Kombëtarë për Siguri dhe njerëzve të tjerë meshkuj përreth se unë mund ta kryeja këtë punë, dhe jam e sigurt që edhe Condoleezza përballet me po të njëjtat vështirësi, nuk është një problem që zgjidhet në momentin kur përzgjedhesh për senatore ose anëtar i Kongresit apo sekretar për çështje mbi arsimin, nuk është diçka që ndodh vetëm me korrespondencë, raportim, por është punë që ndodh në kontinuitet dhe mendoj se duhet të ballafaqohemi me këtë, duke qenë të vetëdijshëm se kjo luftë nuk përfundon kurrë. Nëse më lejohet të them kështu, ajo që më çmend sot te

gratë e reja është se mendojnë që është fare e lehtë, faktikisht nuk është. Është proces në të cilin shumë lehtë mund të bësh regres, dhe këtë mendoj se duhet ta kemi parasysh, duhet të vazhdojmë ta mbështesim njëra-tjetrën, për shkak se lufta jonë është larg fundit të saj”.

(Ky fragment është nxjerrë nga një tryezë e rrumbullakët me temë “Gratë dhe politika amerikane” e mbajtur në vitin 2007, në kuadër të Aspen Ideas Festival)



Njëqind gratë më

Nr.	Emri	Profesioni	Vendi
1	Angela Merkel	Kancelare	Gjermani
2	Wu-Yi	Zëvendëskryeministre	Kinë
3	Ho Ching	Shefe ekzekutive, Temasek Holdings	Singapor
4	Condoleezza Rice	Sekretare e Shtetit	SHBA
5	Indra K. Nooyi	Presidente, shefe ekzekutive, PepsiCo	SHBA
6	Sonia Gandhi	Presidente,	Indi
7	Cynthia Carroll	Shefe ekzekutive, Anglo American	Britani e Madhe
8	Patricia A. Woertz	Presidente, Archer Daniels Midland	SHBA
9	Irene Rosenfeld	Presidente, shefe ekzekutive, Kraft Foods	SHBA
10	Patricia Russo	Shefe ekzekutive, Alcatel-Lucent	SHBA
11	Michèle Alliot-Marie	Ministre për Punë të Brendshme dhe Territore të Jashtme	Francë
12	Christine Lagarde	Ministre për Ekonomi, Financa dhe Punësim	Francë
13	Anne M. Mulcahy	Presidente, shefe ekzekutive, Xerox	SHBA
14	Anne Lauvergeon	Shefe ekzekutive, Areva	Francë
15	Mary Sammons	Presidente, shefe ekzekutive, Rite Aid Corp.	SHBA
16	Angela Braly	Shefe ekzekutive, presidente, WellPoint	SHBA
17	Marjorie Scardino	Shefe ekzekutive, Pearson PLC	Britani e Madhe
18	Wu-Xiaoling	Zëvendësguvernatore	Kinë
19	Brenda Barnes	Presidente, shefe ekzekutive, Sara Lee Corp.	SHBA
20	Ruth Bader Ginsburg	Kryetare e Gjykatës Supreme	SHBA
21	Oprah Winfrey	Presidente, Harpo	SHBA
22	Margaret Whitman	Shefe ekzekutive, presidente, Ebay	SHBA
23	Queen Elizabeth II	Mbretëreshë	Britani e Madhe
24	Melinda Gates	Bashkëthemeluese, bashkëkryesuese, Bill and Melinda Gates Foundation	SHBA
25	Hillary Rodham Clinton	Senatore, New York	SHBA
26	Nancy Pelosi	Zëdhënëse, Dhoma e përfaqësuesve	SHBA
27	Michelle Bachelet	Presidente	Kil
28	Safra A. Catz	Presidente, shefe financiare, Oracle	SHBA
29	Susan E. Arnold	Presidente e njëjësive globale të biznesit, Procter & Gamble	SHBA
30	Andrea Jung	Presidente, shefe ekzekutive, Avon Products	SHBA
31	Judy McGrath	Presidente, shefe ekzekutive, MTV Networks	SHBA
32	Dr. Julie Louise Gerberding	Drejtoreshë, Qendra për kontrollimin dhe parandalimin e sëmundjeve	SHBA
33	Marina Berlusconi	Presidente, Fininvest Group	Itali
34	Zoe Cruz	Bashkëkryesuese, Morgan Stanley	SHBA
35	Amy Pascal	Bashkëkryesuese, Sony Pictures Entertainment, Sony Pictures	SHBA
36	Ann Livermore	Nënkryetare, Hewlett-Packard	SHBA
37	Margaret Chan	Drejtoresh gjenerale, Organizata Botërore e Shëndetësisë	Kinë
38	Helen Clark	Kryeministre	Zelandë e Re
39	Tzipora Livni	Ministre e Punëve të Jashtme	Izrael
40	Ana Patricia Botin	Presidente, Banesto	Spanjë
41	Renetta McCann	Shefe ekzekutive, Starcom MediaVest Group	SHBA
42	Susan M. Ivey	Presidente, shefe ekzekutive, Reynolds American	SHBA
43	Yang Mianmian	Presidente, Haier	Kinë
44	Linda Z. Cook	Drejtoreshë ekzekutive për gaz dhe energji, Royal Dutch Shell	Holandë
45	Janet L. Robinson	Shefe ekzekutive, presidente, The New York Times Company	SHBA
46	Christine Poon	Nënkryetare, Johnson & Johnson	SHBA
47	Dreë Gilpin Faust	Presidente, Harvard	SHBA
48	Paula Rosput Reynolds	Shefe ekzekutive, presidente, Safeco	SHBA
49	Nancy Tellem	Presidente, CBS Paramount Television Entertainment, CBS Corp.	SHBA
50	Tarja Halonen	Presidente	Finlandë

Zonja e çeliktë që pretendon të bëhet kryetarja e parë e SHBA-së

Rikthimi i Hillaryt

Clinton, aktiviste për të drejtat e njeriut, shëndetësinë dhe krijimin e vendeve të punës, ka një renome si në politikën amerikane, ashtu edhe ndërkombëtarisht. Si senatore (e shtetit të New Yorkut), ajo është munduar të pozicionohet në qendër të Partisë Demokratike

KOHA

ARBANA MJEKIQI

“Ajo ishte turpëruar para syve të tërë kombit, mirëpo u ngrit nga hiri dhe shikojeni tani”. Në këtë mënyrë amerikania Shirley Dinninger nga Texasi e ka argumentuar përse është duke e mbështetur Hillary Clintonin në përpjekjet e ish-zonjës së parë për t’u bërë kryetarja e parë e SHBA-së. Deininger po aludonte në ngjarjet e viteve të nëntëdhjeta, kur Bill Clinton ishte kryetar dhe kur Hillary u vu në qendër të vëmendjes së amerikanëve pas aferës Lewinsky. Mirëpo, zonja Clinton e ka bërë zakon që të kthehet në luftë, madje edhe më e fortë se më parë. Të martën, më 4 mars, pas shumë javësh me paqartësi dhe mundësi që ajo të humbë nga rivali i saj afro-amerikan, Barack Obama, Hillary Clinton i fitoi garat të cilat doemos duhej t’i fitonte në Ohio dhe Texas. Ajo po ashtu fitoi edhe në shtetin amerikan të Rhode Island. Zonjës Clinton i duheshin këto fitore për

të mbetur në garë, pas 11 fitoreve të njëpasnjëshme të rivalit të saj në zgjedhjet nëpër shtetet amerikane. Obama kishte siguruar një përparësi të konsiderueshme për nga numri i delegatëve. Superdelegatët, ata të cilët do të vendosin, filluan të viheshin në anën e tij. Madje pati propozime që zonja Clinton të tërhiqet nga gara dhe të mundësojë fillimin e përgatitjeve për zgjedhjet e përgjithshme.

Mirëpo Hillary nuk hoqi dorë. Ajo ktheu gjithçka në anën e saj të martën. Prandaj mbetet e paqartë se nëse do të jetë Obama apo ajo kandidati që do të vihet përballë republikanit John McCain në nëntor.

Kryetarja e parë e SHBA-së?

Nëse arrin të fitojë nominimin dhe më pas ta mposhtë edhe McCainin, Clinton do të bëhet kryetarja e parë e SHBA-së. Po

ashtu, si ish-zonjë e parë, ajo do ta kthente në Shtëpinë e Bardhë ish-presidentin Bill Clinton. Clinton, aktiviste për të drejtat e njeriut, shëndetësinë dhe krijimin e vendeve të punës, ka një renome si në politikën amerikane, ashtu edhe ndërkombëtarisht. Si senatore (e shtetit të New Yorkut), ajo është munduar të pozicionohet në qendër të Partisë Demokratike. Gjatë fushatës për nominim presidencial, ajo e ka quajtur veten si një kandidate me përvojë, që do të ishte në gjendje të udhëheqë që nga fillimi. Kritikët e saj pohojnë se ajo ka shërbyer vetëm si senatore dhe nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë rol ekzekutiv. Ata po ashtu vënë në pikëpyetje gjasat e saj për fitore dhe aftësinë për t’u lidhur me votuesit.

Njëra prej gjërave që theksohet kur përmendet Hillary Clinton është se ajo gjithnjë përdor edhe mbiemrin e saj të vajzërisë, Rodham, krahas atë të bashkëshortit. Clinton mbase



është e lidhur me mbiemrin Rodham sepse thuhet se ajo është “vajzë e babait”. Hugh Rodham nga familja e tij njihet si njeri i ashpër. Vëllai i Hillaryt, Tony, e ka përshkruar atë si “njeri të prirur për konfrontime”. Ai kishte qenë ushtarak dhe oficer i stërvitjes në luftë. Flitet se kur Hillary u kthye një ditë nga shkolla dhe ia tregoi librezën me të gjitha pesëshe, ai i tha se mbase shkolla i ka ulur kriteret. Hillary Rodham Clintoni kështu krijoi një paravan të çeliktë, të cili i ka shërbyer aq shumë gjatë stuhive politike dhe personale, nëpër të cilat kanë kaluar ajo dhe bashkëshorti i saj. mst: “Unë e dua”

Edhe nëse e pavarur, ajo është po ashtu e lidhur me Bill Clintonin. Ajo e ka dëshmuar dy herë se nuk do ta braktisë të shoqin, pa marrë parasysh se çka ka bërë ai. Më 1992, kur amerikania Gennifer Flowers kishte zbuluar aferën e saj me Bill Clintonin, Hillary gjatë një interviste i kishte thënë fjalët që do të mbeteshin përherë në kujtesën e amerikanëve: “Kam ardhur këtu të flas me ju, sepse unë e dua”. Hera e dytë ndodhi në janar të vitit 1998, kur u zbulua afëra me Monica Lewinskyn. Hillary Clinton kaloi nëpër momente të vështira gjatë atij viti, kur bashkëshorti i saj e pranoi se kishte pasur kontakte të caktuara me Lewinskyn dhe askush nuk do të harrojë pamjet e tyre duke ecur nëpër oborrin e Shtëpisë së Bardhë, derisa helikopteri i priste për t’i dërguar në pushime. Vajza e tyre, Chelsea, ecte midis. Hillary ishte e zemëruar, mirëpo nuk e kishte braktisur Bilyn. Ajo qëndroi pranë Billit, sepse donte ta bënte një gjë të tillë për shkaqe personale dhe për shkak se ndiente që një gjë e tillë e forconte

politikisht, ashtu siç u dëshmuua kur hyri vetë në politikë dhe u bë zonja e parë që hyri në Senat. Ai mbase tani është duke e kthyer atë borxh, me mbështetjen e tij të dukshme gjatë tërë kohës që kur Hillary paralajmëroi kandidaturën.

Fuqitë dhe dobësitë

Madje edhe para se Hillary ta shpallte kandidaturën për president të SHBA-së – më 9 janar të vitit 2007, dy vjet nga dita kur kryetari fillon punën – ajo po e përgatiste terrenin. Për shembull, demokratët liberalë në New York vërejtën se ajo po distancohej nga disa çështje liberale, si të drejtat e homoseksualëve. Disa muaj para shpalljes së kandidaturës, ajo kishte mbledhur shuma të mëdha për fushatë dhe kishte arritur pika në shumë debate televizive. E pyetur nëse po luante në letrën e gjinisë gjatë një debati të mbajtur në Las Vegas, ajo u përgjigj: “Njerëzit nuk po më sulmojnë sepse jam grua. Po më sulmojnë, sepse jam e para”.

Megjithatë kritikët – disa prej të cilëve edhe në vetë Partinë Demokratike – vazhdojnë të parashtrajnë argumente kundër saj. Ata thonë se asaj i mungon karizma e bashkëshortit të saj, edhe pse e ka zbutur imazhin e saj gjatë fushatës. Po ashtu janë ngritur shumë pyetje se çfarë roli do të ketë Bill Clinton nëse ajo bëhet kryetare. Megjithatë, i mbetet votuesve amerikanë të vendosin se si do të definohet Hillary Rodham Clinton: si ish-zonjë e parë, si senatore dhe një nga kandidatet që humbi garën për president, apo si gruaja e parë që do ta udhëheqë SHBA-në.

të fuqishme të botës

Nr.	Emri	Profesioni	Vendi
51	Gloria Arroyo	Presidente	Filipine
52	Daën Hudson	Shefe ekzekutive, presidente, Pepsi-Cola	SHBA
53	Nancy McKinstry	Presidente, shefe ekzekutive, Wolters Kluwer	Holandë
54	Clara Furse	Shefe ekzekutive, London Stock Exchange	Britani e Madhe
55	Meredith Vieira	Moderatore, The Today Show	SHBA
56	Christina Gold	Shefe ekzekutive, presidente, Western Union	SHBA
57	Ann Moore	Presidente, shefe ekzekutive, Time Inc.	SHBA
58	Mary McAleese	Presidente	Irlandë
59	Neelie Kroes	Komisare për konkurrencë, Bashkimi Evropian	Holandë
60	Laura Bush	Zonjë e parë	SHBA
61	Susan Desmond-Hellmann	Presidente, Departamenti për zhvillimin e produkteve, Genentech	SHBA
62	Diane Saëyer	Bashkëprezantuese, Good Morning America	SHBA
63	Katie Couric	Prezantuese, drejtoreshë menaxhuese, CBS Evening News	SHBA
64	Sharon Allen	Presidente, Deloitte & Touche	SHBA
65	Guler Sabanci	Presidente, Sabanci Holding	Turqi
66	Angela Ahrendts	Shefe ekzekutive, Burberry	Britani e Madhe
67	Dora Bakoyannis	Ministre për Punë të Jashtme	Greqi
68	Zaha Hadid	Themeluese, kryearkitekte, Zaha Hadid Architects	Britani e Madhe
69	Antonia Ax:son Johnson	Presidente, pronare, Axel Johnson AB Group	Suedi
70	Beth Brooke	Zëvendëskryetare, Ernst & Young	SHBA
71	Aung San Suu Kyi	Laureate për çmimin Nobel, fitimtare e zgjedhjeve demok. në Myanmar, 1990	Myanmar
72	Maha Al-Ghunaim	Presidente, drejtoreshë menaxhuese, Global Investment House	Kuvajti
73	Colleen Barrett	Presidente, Southwest Airlines	SHBA
74	Christiane Amanpour	Shefe e korrespondentëve, CNN	Britani e Madhe
75	Yan Cheung	Presidente, Nine Dragons Paper	Kinë
76	Rosalia Mera	Bashkëthemeluese, Inditex	Spanjë
77	Anne Sweeney	Presidente, Disney-ABC Television Group; bashkëkryesuese, Disney	SHBA
78	Marilyn Carlson Nelson	Presidente, shefe ekzekutive, Carlson Companies	SHBA
79	Sheikha Mozah Bint Nasser Al-Missned	Zonjë e parë	Katar
80	Maureen Chiquet	Shefe ekzekutive, Chanel	Francë
81	Portia Simpson Miller	Kryeministre	Xhamajkë
82	Queen Rania	Mbretëreshë	Jordani
83	Galia Maar	Shefe ekzekutive, presidente, Bank Leumi Group	Izrael
84	Georgina Rinehart	Presidente, Hancock Prospecting	Australi
85	Christie Hefner	Presidente, shefe ekzekutive, Playboy Enterprises	SHBA
86	Stephanie A. Burns	Presidente, shefe ekzekutive, Dow Corning	SHBA
87	Stacey Snider	Zëvendëspresidente, shefe ekzekutive, DreamWorks SKG	SHBA
88	Imre Barmanbek	Zëvendëspresidente, Dogan Holding	Turqi
89	Luisa Diogo	Kryeministre	Mozambik
90	Chu Lam Yiu	Presidente, Huabao International Holdings	Kinë
91	Giuliana Benetton	Drejtoreshë, Edizione Holding, The Benetton Group	Itali
92	Dr. Sima Samar	Presidente, Afganistan Komisioni i Pavarur për të Drejta të Njeriut	Afganistan
93	Dong Mingzhu	Zëvendëskryetare, Gree Electric Appliances	Kinë
94	Cathleen Black	Presidente, Hearst Magazine	SHBA
95	Mary West	Bashkëthemeluese, West Corp.	SHBA
96	Rochelle Lazarus	Presidente, shefe ekzekutive, Ogilvy & Mather Worldwide	SHBA
97	Vidya Chhabria	Presidente, Jumbo Group	Emiratet e Bashkuara Arabe
98	Orit Gadiesh	Presidente, Bain & Co.	SHBA
99	Sheikha Lubna Al Qasimi	Ministre e Ekonomisë	Emiratet e Bashkuara Arabe
100	Ellen Johnson-Sirleaf	Presidente	Liberi

Kush është Hillary Clinton?

Hillary Rodham Clinton lindi më 26 tetor 1947 në Chicago, Illinois. Ajo është një politikane amerikane e demokratëve dhe juriste. Në vitin 1975 ajo u martua me Bill Clinton dhe në vitin 1980 solli në jetë fëmijën e vetëm, vajzën Chelsea.

Ka qenë zonja e parë e Shteteve të Bashkuara nga viti 1993 deri më 2001. Përpara kësaj ushtronte profesionin e avokates, ndërsa ishte “First Lady” e Arkansasit për dymbëdhjetë vjet me radhë, duke qenë njëherësh mjaft aktive në radhët e demokratëve. Idetë e saj politike gjatë kohës kur ishte studente po bëheshin gjithnjë e më liberale, gjë që e bëri të afrohej me Partinë Demokratike. Në vitin 1969 u diplomua dhe iu dha zyrtarisht grada e nderit në shkencat politike. Ajo u bë studentja e parë në historinë e universitetit “Wellesley”, që iu dha e drejta të mbante fjalimin përsëritës përpara të gjithë studentëve. Fjala e Hillary Rodham u prit aq mirë, sa u përsëritet nga duartrokitje që zgjatën plot shtatë minuta. Duket qartë se Hillary që në hapat e para ka qenë e predispozuar për t’u bërë një figurë e rëndësishme në politikë. Në zgjedhjet e 7 nëntorit 2006 u zgjodh pa asnjë problem për një mandat të dytë në Senat. Senatorja e New Yorkut arriti të fitonte me 67 për qind të votave duke mundur rivalin republikan John Spenser, ish-administrator lokal, shumë pak i njohur nga publiku dhe mbështetës i madh i luftës në Irak. Vitet e mandatit të parë në politikë e ndihmuan të bëhej një profesioniste e vërtetë në politikë. Aktualisht është një nga kandidatet më të forta për garën presidenciale të vitit 2008, megjithatë për të arritur këtë i duhet të kalojë shumë sfida.

Vështrim

Në kuzhinë

“Dasmat dhe Pelenat” është shëtitje në katër shtëpi të ndryshme kosovare. Tri prej këtyre familjeve jetojnë brenda një rendi rigoroz tradicional. Udhëtimi vizual në këto shtëpi më bëri të mendoj për gjyshen time, për nënën time dhe të gjitha gratë që i njoh



KALTRINA KRASNIQI

Para disa vjetëve provova të punoja një film për gjyshen time. “Gjyshja i me i qëndisi të gjitha këto peizazhe...” ishte zëri që fliste mbi kadrin e parë... Pata provuar të rrëfeja përrallat nga dhoma e mbyllur e gjyshes sime, nga dhoma e vogël ku ajo qëndisi gjithçka, që nga fëmijëria, për t’u përgatitur për jetën e saj bashkëshortore, me burrin që nuk e njihte. Ajo vazhdoi të qëndiste ëndrra në atë dhomë por vizitorët e vetëm të kësaj ekspozite i shin fëmijët, më vonë fëmijët e fëmijëve... Gjyshen dhe dhomën e saj të nusërisë e mori lufta e fundit. Dje në kuzhinën e Antonetës takova dy gjyshe tjera, vitale, amerikane, nga ana tjetër e botës. Prapë në një dhomë, tash në kuzhinë, perdet e errëta lëshojmë në dritare, Neta pastron ekranin e televizorit nga të prekurat e gishtërinjve të dy vajzave të saj dhe “Dasmat e Pelenat” fillojnë.

Në shikim të parë duket si video e ndonjë dasme familjare, asi ku kameramani është i paguar për atë punë dhe në mënyrë protokollare xhiron gjithçka që ndodh aty. Nusja në derë të shtëpisë me mjaltë në gishta, nusja e mbuluar me bonbone, nusja që rri në këmbë para dasmorëve me flamur në prapavi dhe përfundimisht nusja nuk qesh. Në të gjitha këto pamje shihet edhe dhëndri, ai qesh.

Ne vërtet ishim duke shikuar pamje autentike nga një dasmë pejana, ku dy të rinj 22-vjeçarë martoheshin me vetëdëshirë, pa pretekst të ndonjë shtatzënie e të paplanifikuar. Pas pak minutash ishim në dhomën e tyre të pastër të pritjes, dhomë moderne kjo, e organizuar me kujdes. Komenti i parë i nuses së re është se nuk i pëlqen vetja në atë video, por shpejt dësh-ton të elaborojë pse.

“Dasmat dhe Pelenat” është shëtitje në katër shtëpi të ndryshme kosovare. Tri prej këtyre familjeve jetojnë brenda një rendi rigoroz tradicional. Udhëtimi vizual në këto shtëpi më bëri të mendoja për gjyshen time, për nënën time dhe të gjitha gratë që i njoh.

Ishte edhe një çift i pleqve nga Rugova. Natyrisht përgjatë shumicës së bisedave në film plaku fliste për jetën e tyre bashkëshortore, për ditën e martesës, për faktin që këtë grua të ulur pranë tij e kishte zgjedhur i ati për te. Gruan e tij e lavdëronte për gjashtëdhjetë vite shërbim të palodhshëm në institucionin e tyre familjar. Ai gjithashtu tha se gruan e tij kurrë nuk e kishte parë në gjumë, ajo gjithnjë ishte në këmbë dhe e zgjuar. Gjithçka dukej idilike aty

deri në momentin e bisedës me plakën që me mburrje rrinte në petkun e saj bukur të qëndisur tradicional, të veshur për rastin. Ajo tha se po të kishte edhe një jetë nuk do të martohej, eksperiencia tokësore e gruas kishte qenë shumë e lodhshme për të. Pastaj pauzoi pak, duket se u mendua për dashurinë e pakusht ndaj fëmijëve të saj dhe shtoi se ndoshta një kesi lloj jete e vlen vetëm kur mendon për fëmijët. Më pëlqeu fytyra e asaj gruaje, më pëlqente të shikoja shtëpinë që e ndërtoi vetë, përderisa burri i saj lahutar udhëtonte me ansamblin e Rugovës për t’i kënduar popullit. Rrudhat e saj tregonin shumë vjet e pastaj edhe krenari, gjithçka rreth saj ishte thurur nga ajo vetë. Bukur i rrinte qetësia, por e bukur dukej edhe kur fliste ajo gjyshe.

Në këtë film takova edhe një çift tjetër të ashtuquajtur poligamik. Burri drenicak me dy gra, dhe shumë fëmijë. Qysh në kadrin e parë numërimi i fëmijëve nuk i dilte i saktë. Pastaj edhe vetë kadri ishte shumë i çuditshëm. Ai në plan të parë, në këmbë i zënë ngushtë, përderisa grua e tij e parë në thellësi milte lopën. Në pyetjen nëse ishte e vështirë të jetoje në një raport poligamik, burri tha se kërkohen disa aftësi specifike, mençuri, për të mbajtur balancën familjare. Pastaj shtoi se ishte shumë e rëndësishme që njeriu të dashurojë në jetë.

Skenë tjetër, i njëjti burrë me gruan e dytë. Ajo gatuan bukë në tokë. Ai sërish qëndron në këmbë por këtë herë duket i qeshur, përgatitet për drekën që i a shërbejnë dy gra. Kjo shtëpi drenicake e ndarë më tresh më tronditi. E prisja me padurim një moment intim të gruas së parë. Ajo ishte vetëm 42 vjeçe, por kur burri i referohej asaj e quante të vjetër. Ajo vërtetë dukej e plakur, e hidhëruar me jetën pak. Natyrisht ajo këtë nuk e thoshte, përkundrazi, tregoi se burri e kishte informuar me kohë se po martohej sërish, ndërsa kjo e kishte pasur vetëm një lutje, ta lejonin të qëndronte pranë fëmijëve



të saj. Dëshira iu plotësua, asaj i ndryshoi statusi në shtëpi, tani ajo ishte vjehërra e dytë në familje. Ky qartë nuk ishte raport poligamik, ishte vetëm një ripozicionim në institucion. Për qëndresën e saj të qetë dhe dinjitoze ajo u gradua me titullin “burrnore”, kjo medalje ishte dhurata e vetme nga martesja dhe ajo mburrej me të. Dhe, u kthyem në Prishtinë, gjithçka më dukej e njohshme në këtë shtëpi, dy vajza të bukura vallëzonin dhe përçafeshin me babin e tyre. Mami ishte shtatzënë prapë dhe të gjithë me padurim prisnin motrën e tretë. Babi e bëri një demonstrim simpatik të ndërrimit të pelenave, leksion për burrat e ardhshëm. Bukur dukeshin shëtitjet e tyre në park... Ishte një moment që nuk e kisha parë më parë, por e kisha dëgjuar nga shumë burra që njoha në këtë jetë. Pritja e mundimshme e ardhjes së jetës. Skena është kështu, babi është në kafe me shokët e tij dhe vajzën e madhe, pi pak raki për t’i dehur fluturat në bark. Pret lajmin...dhe gjatë pret...dhe shumë frikohet. Përfundimisht mami e sollti motrën e tretë në këtë

botë. Babi flet me mamin në telefon dhe qan. Motra e re është shumë e bukur por mami duket e lodhur sot, por qesh. Imazhet e fëmijërisë të paluara mirë në kujtesën e motrës së madhe më bëjnë të besoj në një Prishtinë të re, tjetër.

Ishte mbyllje e bukur e filmit kjo, në këtë shëtitje njëorësh në familje dhe relacione, shpesh mendoja për vetë Netën. Ajo erdhi prej Zahaqit në Prishtinë, duke besuar se ka qytet. Deshi të bëhej mjeke, por kishte parë shumë gjak në jetë dhe dëshira shpejt iu zbeh. Vendosi të rrëfente tregime në imazhet në lëvizje.

“Dasmat dhe Pelenat” janë dokument i dhimbshëm mbi gratë e vendit tim. Përderisa gjyshja e Rugovës kurrë nuk e kishte luftuar jetën e saj, sepse kështu jetuan të gjitha gratë para saj, ajo prapëseprapë ndërtoi gjithçka që kishte. Gruaja e re pejana për dalim nga gjyshja e Rugovës pronarin e saj e zgjodhi vetë dhe çdo ditë rregullat e robërisë së re i aprovon prapë vetë. Ajo është tani diku në qytetin e saj të vogël Pejë, e mbyllur në shtëpinë moderne e

rrethuar me plot detergent, mbase shtatzënë në pritje të ardhjes së burrit të saj nga qyteti, i cili po të ketë qejf të mirë ndoshta edhe do t’i rrëfejë se çfarë po ndodh jashtë.

Filmin që e punova para disa vjetëve e pata mbyllur me “A t’kujtoret gjyshja?” duke menduar se ajo jetë kishte marrë fund. Sot një ditë pas asaj premiere në kuzhinën e Antonetës me gjyshen dhe stërgjyshen amerikane të vajzave të saj, ndiej pak pikëllim sepse imazhet e atyre grave nga ai film më ndjekin krejt kohën. E pashë në sytë e gjysheve amerikane se njohën mirë atë jetë në shtëpitë e Kosovës...njëra prej tyre më tha se nuk e kuptonte se si shpesh harrojmë se gratë i rrisin ata djem dhe vajza dhe po qe se sytë e atyre grave kanë pikëllim çdo ditë, këto janë kujtimet që do të mbesin në kokat e fëmijëve që i rrisin. Këto dy gjyshe që dukeshin shumë të freskëta ato do të mbesin kujtim i bukur nga fëmijëria e vajzave të Antonetës, kam dëshirë të besoj se këto kujtime do t’i inspirojnë ato për të ndërtuar një qytet të ri.



Marshimi drejt globalizimit, në shumë nivele ka shkaktuar margjinalizimin e grave dhe vajzave dhe kjo duhet të ndryshojë.

Hillary Clinton

Koment

Gratë dhe kultura kosovare

Vetë ideja e adresimit të fondeve të caktuara në aktivitetet kulturore të grave do të ishte motivim shtesë për rritjen e numrit dhe kualitetit të tyre



LULJETA DEMOLLI

Trajtimi institucional i rolit së grave në kulturën kosovare është pothuajse i njëjtë me trajtimin e raportit të shtresave tjera shoqërore me kulturën – skajshmërisht i marginalizuar dhe i improvizuar.

Institucionet relevante në Kosovë – vendore dhe ndërkombëtare – edhe pas tetë viteve nga përfundimi i luftës, ende nuk kanë ofruar

plane konkrete të avancimit substancial të kulturës, dhe në veçanti, të pjesëmarrjes së grave në kulturë. Përveç strategjive tejet të përgjithësuara, të cilat dëshirojnë që përmijherë t'i zgjidhin të gjitha problemet e akumuluar me vite, institucionet kosovare nuk kanë inicuar analiza të situatës të fushave të veçanta të kulturës në Kosovë dhe rekomandime për tejkalimin e krizave në to.

Arritjet e deritashme të grave kosovare në kulturë (njëjtë si arritjet e burrave), janë rezultat i angazhimit individual dhe i përkushtimit profesional të tyre, i cili në shumicën e rasteve, mbetet i injoruar nga përkrahja institucionale.

Ndërkombëtarizimi i kulturës kosovare, që do të duhej të ishte njëri ndër prioritetet në punën e Ministrisë së Kulturës, asnjëherë nuk i ka kaluar suazat e statusquo'së stagnuese.

Shumica absolute e sukseseve të artistëve kosovarë në arenën ndërkombëtare janë realizuar jashtë pa ndihmën e Ministrisë së Kulturës. Edhe në rastet kur Ministria ka siguruar ndihmë financiare, shpesh ka pasur edhe konflikte publike me artistët për shkak të komplikimeve burokratike dhe vonimit të pagesave.

Në shtetet e zhvilluara, përveç mundësive të mëdha të financiare, institucionet private dhe publike kulturore kanë mundësi të hapësirave autonome të funksionimit. Në vendet si Kosova, funksionimi i fushave të teatrit, librit, muzikës klasike, kinematografisë, arteve pamore, etj., varet shumë (ose tërësisht) prej fondeve të Ministrisë së Kulturës. Çdo pretendim tjetër është hipokrizi apo injorancë. Në një treg të vogël dhe të pazhvilluar kulturor, siç është ky i Kosovës, Ministria është boshti kryesor i ofrimit të mundësive zhvillimore për shkak të fuqisë politike dhe financiare që ka. Për këtë arsye, edhe harxhimi i buxhetit, sado i vogël që është, duhet të bëhet në mënyrë shumë të balansuar dhe efektive, dhe përveç në financim, Ministria duhet të fokusohet në ndihmesën për krijimin e urave të bashkëpunimit ndërkombëtar. Askush nuk pret që Ministria t'i japë fund të gjitha problemeve në kulturën kosovare, mirëpo as Ministria nuk e ka luksin e punës së ngadalshme dhe gjetjes së arsytimit për mospasë.

Ministria e Kulturës mund ta krijojë një fond të veçantë për aktivitetet kulturore të grave për të cilat nevojiten mjete minimale financiare, si për shembull, revistat mujore, punëtoritë e kohëpaskohshme, mbulimi i shpenzimeve për ndonjë ligjërues/e ndërkombëtar/e, etj.. Mundësimi i realizimit të këtyre aktiviteteve nuk do ta rëndonte buxhetin institucional, kurse ato do të kishin efekte pozitive për rritjen e përfshirjes së grave në jetën kulturore, që do të rezultonte me dinamizimin e kulturës kosovare në përgjithësi.

Do të ishte jashtëzakonisht e dobishme që Ministria e Kulturës të ndihmonte në iniciimin dhe financimin e vazhdueshëm të botimeve, ekspozitave, shfaqjeve, koncerteve ose performancave të grave kosovare, ose të ndihmës në gjetjen e donacioneve. Seleksionimi i veprave që do të realizoheshin gjithësesi do të duhej të bëhej me kritere profesionale, mirëpo vetë ideja e adresimit të fondeve të caktuara në aktivitetet kulturore të grave do të ishte motivim shtesë për rritjen e numrit dhe kualitetit të tyre.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Intervistë e këngëtares dhe tekstshkrueses së këngëve, Aida Baraku

“Mundohem që mbarë jeta ime të jetë porosi për femrat”

“Nuk mendoj se në Kosovë ekziston feminizmi si rrymë. Ka vetëm feminizëm individual, si pjesë përbërëse e jetës dhe veprës së disa femrave kosovare. Më duket se këto nuk janë shumë me numër. Jeta konvencionale e përqindjes së madhe të femrave kosovare nuk më lejon të besoj se ato kanë çfarëdo lidhjeje me feminizmin”, thotë Aida

Kur përmendet feminizmi, çka ju bie ndër mend?

Aida: Një për kokë më dyluftojnë mendime kontradiktore. Njëri shpreh adhurim ndaj atyre që na e kanë mundësuar të drejtën për punë dhe jetën sado-kudo dinjitoze, si dhe ndaj atyre që ende kanë forcë e entuziazëm që edhe në këto kohë, aq të shpejta e aq të pashpirta, të luftojnë për ideale e mirëqenie të tjerëve. Mendimi tjetër zgjon antipati ndaj çdo rryme që urren meshkujt, si dhe ndaj çdokujt që mendon se ata janë fajtorë për çdo pozitë të palakmueshme të femrës në shoqëri.

A mendoni se ekziston feminizmi në Kosovë, nëse po, kur mendoni se ka filluar kjo lëvizje?

Aida: Nuk mendoj se në Kosovë ekziston feminizmi si rrymë. Ka vetëm feminizëm individual, si pjesë përbërëse e jetës dhe veprës së disa femrave kosovare. Më duket se këto nuk janë shumë me numër. Jeta konvencionale e përqindjes së madhe të femrave kosovare nuk më lejon të besoj se ato kanë çfarëdo lidhjeje me feminizmin.

Deri në çfarë mase mendoni se po i jepet rëndësi formimit të një prototipi të “femrës së fuqishme”, në tekstet e këngëve në Kosovë?

Aida: Nuk mund të kërkonim fuqi dhe rëndësi të idesë në një vend ku manipulohet vetëm me fuqi dhe rëndësi të seksualitetit, së paku kur janë mediat dhe profesioni im në pyetje. Femrat që ekspozohen e ekspozohen sot marrin seksualitetin dhe paranë si fuqinë më të madhe që kanë. Mediat e përkrahin këtë qëndrim dhe askush nuk llogarit që pika e fuqisë mund të qëndrojë edhe diku tjetër. Fatkeqësisht, “intelektualet” tona nuk janë aq agresive që të tregojnë se ka shembuj të tjerë dhe se ka edhe forma të tjera të fuqisë femërore.

Sa mendoni se kanë frymë të feminizmit tekstet e këngëve në përgjithësi në Kosovë?

Aida: Nuk mund të shkojmë aq larg! Nuk mund të flasim për feminizëm në tekstet, të cilat ende kanë gabime gramatikore, ende kanë gabime theksi, luftë mes gegës e toskes, luftë mes rrugës dhe letrares! Ka aq shumë budallallëqe në tekstet tona, sa unë shoh, shpesh, vetëm analfabetizëm dhe guxim të budallenjve! Në anën tjetër, si mund të besoni në feminizmin e dikujt që këndon tekst feminist, e ka sjelljen, pamjen dhe jetën aq larg urbanes dhe modernes! E, kjo ndodh te ne.

Sa mendoni se mund të ndikojë një tekst i një kënge, në ndryshimin e imazhit të femrës në përgjithësi në Kosovë?

Aida: Teksti i këngës jep vetëm imazh fals. Vjen një çupëlinë me ide që të tregohet si femër “e fortë”, dhe ju, si profesionist, ia realizoni idenë duke shkruar për të. Ajo bën klipin ku e “gdhendin” regjisorë, ndriçues e stilistë, populli e konsumon atë, dhe fillon të duket se ideja funksionon. Pastaj e takoni atë çupëlinë dhe e shihni “femrën e fortë”: fle me sponsorë,



gazdallarët e kafeneve e nëpërkëmbin, menaxherët e vjedhin e mashtrojnë, i dashuri ia shkul flokët... Zhgënjyese!

Nëse mund të ketë ndikim, te cila grupmoshë mendon se mund të ndikojë më shumë?

Aida: Te tinejxherët. Ajo është grupmosha që duhet t'i ndërrojë ca rregulla që e ka vendosur një gjeneratë të pafat të femrave që ka kryer shkollën nëpër bodrume gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur prindërit s'kanë pasur punë apo kanë pasur rroga dymarkëshe, gjeneratë që ka përjetuar luftën dhe bombardimet si adoleshentë, e së cilës pastaj i ka rënë mbi kokë çdo prapështi e një shteti të paformuar e të korrupuar. Pakkush nga kjo gjeneratë mendon për mirëqenien shoqërore. Nuk ka kohë – duke menduar për mirëqenien e vet, të cilën s'e ka pasur kurrë.

Ju personalisht, sa i kushtoni rëndësi paraqitjes së feminizmit në tekstet e këngëve që ju i shkruani?

Aida: Vargjet për këngë nuk janë të pavarura. Ato varen nga melodia dhe atmosfera e këngës, si dhe nga personaliteti dhe fiziku i këngëtarit që i këndon. Këto janë pikat nisëse të shkrimit tim. Vazhdimin e bie imagjinata, dituria, përvoja. Mendoj se inteligjenca dhe pasuria emocionale janë diçka shumë e nevojshme për shkrim. Ato nuk më lejojnë të kufizohem, madje as me feminizëm. Porosia ime nuk dërgohet vetëm me tekste. Ju thashë edhe më parë se ato mund

të jenë fals-porosi. Unë mundohem që mbarë jeta ime të jetë porosi për femrat.

Në çfarë mënyre mundoheni ta paraqitni femrën kosovare, në tekstet tuaja?

Aida: Kryesisht mundohem ta paraqes jetën reale të femrës, më shumë shkruaj për emocionet reale të saj. Tash realiteti im mund të mos jetë realiteti i shumicës, por ata që janë shumicë – as që kërkojnë tekste nga unë.

Zakonisht, a porositet teksti me përmbajtje feministe nga këngëtarët?

Aida: Shumë rrallë. Mund t'ju them haptas që kurrë, asnjë këngëtare kosovare nuk ka kërkuar tekst feminist nga unë.

Cilin tekst që ju e keni shkruar mendoni se e paraqet më së miri femrën kosovare dhe që ka më së shumti përmbajtje feministe?

Aida: Më duket se “Flakaresha” është teksti më i afërt me përjetimin e feminizmit te ne, ku feminizmi kuptohet si luftë mes gjinive. Unë për vete preferoj metodat më “elegante” ku nuk ka luftë, por kërkohet me autoritet respekti i ndjenjave dhe natyrës femërore. Ndaj, e dua shumë tekstin tim “Shushurisin”. Ai shpreh më së miri ndjenjën e vetmisë që mund ta ketë një femër e fortë në Kosovën tonë.

(Intervista me Aida Barakun është bërë nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore në kuadër të një hulumtimi për relevanten e feminizmit në Kosovë)

Pengu i kujtimeve

MAJLINDË SINANI-LULAJ

Shi!
Ftohtë!
Gjethet kanë rënë nga drunjtë. Në vend të tyre, varur rrinë kujtimet e ditëve të kaluara.

Ato i ngacmon era, po njëlloj, siç do të ngacmonte kaçurrelat e një vajze plot epsh. Natyrisht do të duhej era t'i ngacmonte, përndryshe ato, si edhe flokët e kaçurreles, do të ishin të qeta...

E, era- mirë bën, apo keq?

Edhe mirë, edhe keq!

Mirë, se i lëviz, si lërë të vënë pluhur e të harrohen.

Keq, sepse janë me më shume vlerë kur nuk i ngacmon.

Tani i do kujtimet dhe kaçurrelen të tregojnë se je i gjallë, apo do t'i ruash vetëm për vete – kaçurrelen në kujtimet, e kujtimet në zemrën tënde?

Do të duash të gjendet një mik a një mike që do t'i hapësh zemrën, se zemra do të hapet, e kujtimet e kaçurrelja nuk do të jenë më veç pjesa jote, veç jeta jote.

Ato do të jenë edhe rrëfimi që do e bësh bashkë me ëndrrën e dikujt, edhe e kaluara që do e bësh pjesë të së tashmes.

Pikat e shiut që bien në dritare të bëjnë të kthesh kokën edhe të kujtohesh, se dita po mbaron, ashtu siç do të mbarojë edhe jeta një ditë.

Edhe do të kujtohesh në fund të kësaj dite, ashtu siç do të bjerë ndërmend në fund të kësaj jete, se shumëçka ka mbetur pa u thënë e pa u bërë, ashtu siç do të kujtohet, se diçka ka mbetur peng!

Pengu mbeti te fjala e pathënë, sepse, po ta thoshe, do të bëheshe ti pengu i fjalës. Do të vazhdoje të ecje rrugëve të jetës, drejt fundit të saj, me pengun në zemër, pa qenë pengu i asgjëje dhe i askujt, pa çka zjarrmia do të djegë trupin...

Flokëzeza kaçurrele do të shfaqet kthinave

të kujtimeve, tërheqëse deri në pambarim, e do ta kujtoje me ndonjë buzëqeshje, kur ke kokën e mbështetur tek xhami, në një ditë si kjo, kur shiu do të trokiste mbi dritaret e dhomës, e zjarri i ndezur brenda do të krijonte ambientin ideal që ajo të ishte me ty. Të shfaqet përpara, me flokët e lagur nga shiu, çapkëne e lozonjare, siç dinte veç ajo! Do të heq rrobat e lagura ngadalë dhe nuk do t'i bëhet vonë nëse sytë e një mashkulli, lakmueshëm, i ngjiten trupit, që nën dritën e flakës së zjarrit është edhe më i zjarrtë, edhe më ndjellës, edhe më tundues...

Dhe tundimit s'do mund t'i bësh ballë. Do t'i afrohesh dhe nuk do të mund të durosh më pa e prekur ... ashtu siç prek njeriu diçka që nuk e ka pasur për shumë kohë... Dhe tek e prek, e kupton sa ke vuajtur, sa e ke dashur, sa e ke kërkuar... E ke kërkuar dhe atje ku pak ka pasur shenja të saj ... ku nuk ka pasur flokë me krela, ku nuk ka pasur djallëzi shumë, atje ku bukuria nuk i është afruar as gjysmës së bukurisë që kishte ajo!
Dhe ke kuptuar se dikush tjetër nuk mund të zërë vendin e saj. As netët që ke kaluar me të nuk do t'i ofrojë askush tjetër në këtë botë, sepse, në fund të fundit, secili njeri i veçantë është ...

Ti do të mund të kesh gjetur diçka të sajën diku, ndoshta edhe diçka më mirë se ajo, po kurrë si ajo... Me të ishte diçka që nuk arrin ta përmbledhësh me fjalë. Ishte njësoj sikur kur thua ... shshshshshstttttttttttttttt... Fjalët nuk thonë më shumë... nuk flet asgjë... Ndoshta diçka jep shfaqje, e ti edhe ajo ndiheni pjesë e shfaqjes, jeni shfaqja vetë!

Nuk ka skenografi, nuk ka zëra, nuk ka duartrokitje... ka ndoshta efekte dritash, edhe shpirt, edhe frymë... dhe ... kaq!
Do të prishej gjithçka veç edhe një detaj po të shtohet! Shpirtat i lë të dalin nga trupat! Domosdo, sepse kjo botë është e ashpër, sidomos kur je i veshur hollë për të. Dhe gjithë kjo ndodh aty, me të... dhe jo diku tjetër, as me dikë tjetër! As ndryshe!

Zhurma e pikave të shiut do të bëjë të zgjohesh nga pesha e kujtimeve. Do të shohësh se shiu vazhdon të bjerë, zjarri ka filluar të fiket, ti ndjehesh i lodhur e pranë teje nuk është askush!

Do ndjehesh i vetëm, udhëtar në botën e ndjenjave, e do të duash për të satën herë të kesh një mik a një mike afër, të rrëfesh mallin e dëshirën...

Ku ta gjeshe mikun?!? Kujt t'ia hapësh zemrën në këtë orë të vonë?!? Do lëvizësh si mumie nëpër dhomë, e kujtimeve, tani, do kërkuash miqtë. Do takosh ata të fëmijërisë, më të cilët ke ndarë lodrat edhe lojën. Do ecësh nëpër jetë e do arrish te miqtë e rinisë, me të cilët ke ndarë sekretet e moshës. Kaherë mund të mos i kesh takuar, por nuk i ke harruar. Ata mbeten të vetmit që miqësinë ta kanë ofruar pa kushte. Atyre u ke treguar hallet e zemrës, ata të kanë fshirë lotin e dhimbjes...

Mes miqsh, buza edhe mund të qeshet një grimë... Ndjen se të ka marrë malli për ta ... Janë njerëzit me të cilët do të zbrazesh zemrën, ashtu siç nuk e ke zbrazur kaherë!

Gjithë këto vite, ti ke ndjerë mungesën e tyre, ke dashur t'i takosh për të pirë kafënë e mëngjesit, për të dalë për një drekë bashkë... Do të doje të ishe me ta për xhirot e zakonshme të mbrëmjes edhe për mbrëmjet e çmendura në ndonjë lokal nate...
Kujtesa të dërgon rrugicave të qytetit tënd, e ty të duket sikur dëgjon zërat e të qeshurën e tyre...
Ehhhhh...

Një ofshamë e thellë të del nga brenda, teksa vazhdon të hedhësh hapa të vegjël nëpër dhomën që bëhet edhe më e madhe, kur ndjehesh i vetmuar. Nuk e merr vesh nëse të ha vetmia apo hapësira, por e vëren se po fillon të mos i ndjesh pjesët e trupit, fryma të merret dhe do të ikësh, të dalësh nga këtu, ku, sonte, trishtimi paska bërë follenë.

Era të rrëmben me vete, ashtu siç të rrëm-

ben dhe jeta! Shiu rrëmbyeshëm bie mbi ty, e ti rrëmbyeshëm përplas këmbët tek ecën. Ftohtë qenka, mendon me vete, po zemra më e akullt ndjehet! Ajo zemër që ishte gjithë zjarr, para pak çastesh, tek ecën rrugës nëpër shiun e ftohtë, duket se po ngryn.

Ecën, ecën ... derisa fillon të dridhesh nga të ftohtit! Këmbët të kanë çuar në lokal in ku tingujt e muzikës i përshtaten shpirtit tënd sonte. Heq mantelin e lagur dhe zë vend afër banakut. Afrohesh aty ku mund të marrësh diçka për të pirë, pa pritur kamerierin derisa të mbarojë ecejaket e tij nëpër lokal. Ti s'do që ai të dëgjojë zërin tënd të ngjirur, sonte. Një zë i ngjirur a mund të jetë zë miqësor, në një natë si kjo!? Pi një gotë, dy... sikur do që gotat të ftojë harresën në kujtimet tua!

Melodia e këngës që dëgjohet, të rikthen zigzageve të jetës ... Përballë kthinave të labirintit, provon edhe njëherë dilemat për zgjedhjet që ke bërë! Po të kishe dhe një mundësi, cilën rrugë do zgjedhje? Në cilën anë të labirintit do të vazhdoje?

E mundimshme kjo! Djersë të ftohta mbulojnë ballin tënd! Vë veten në sprovë për të satën herë, nëse atëherë, atje, për atë apo për këtë ... ke marrë vendimin e duhur?!

Mes pyetjesh pa përgjigje, pi përsëri, po harresa te gota nuk është. Ndez një cigare, tymi i së cilës mbështillet rreth mendimeve, e i bën ato edhe më të mistershme! Si nuk ishte kujtuar!? Diçka e tillë si tymi duhej që të ngatërronte gjithçka. Të humbte fillin e mendimeve e kujtimeve, e ti të filloje nga e para, që këtu, nga kjo natë, nga këta tinguj...

Shiu nuk ndihet më... edhe era, puhi është bërë!
Cigarja është fikur, e tymi është zhdukur! Mendimet e kujtimet aty janë, me ty...!
Në këtë natë me shi, edhe kur do të ketë diell!
Ato janë fati yt dhe hija jote!
Sonte dhe gjithë jetën!



Çdo shtypje,
dominim,
krijon
gjendje lufte.

Simone de Beauvoir

Shkenca, teknologjia dhe feminizmi socialist i viteve të tetëdhjeta të shekullit njëzet

Ky vështrim paraqet një tentim për të ndërtuar një mit ironik politik që është besnik ndaj feminizmit, socializmit dhe materializmit. Kur them 'besnik' mendoj më shumë në besnikërinë ndaj mosadhurimit e jo në adhurimin përulës ndaj Zotit dhe mishërimin. Mosadhurimi i Zotit duket se gjithmonë nga ne ka kërkuar që gjërat t'i marrim shumë seriozisht. Nuk shoh se do të mund të merrej ndonjë qëndrim më i mirë në kudër të traditave fetare, evangjeliste dhe politike të botës në ShBA, duke përfshirë politikën e feminizmit socialist. Mosadhurimi i Zotit na mbron nga shumica morale nga brendësia jonë, dhe njëkohësisht prapë ngulmon në nevojën për bashkësi; kjo nuk është shmangie nga feja. Ironia vjen nga kundërthëniet që nuk zgjidhen në tërësi më të mëdha, madje as në mënyrën dialektike, nga tensioni që krijohet kur gjërat që nuk përputhen mes vete dëshirojmë t'i mbajmë së bashku për shkak se të dyja, apo të gjithat, janë të domosdoshme dhe të vërteta; ironia ka të bëjë me humorin dhe lojën serioze. Ajo gjithashtu paraqet strategjinë retorike dhe metodën politike; metodë kjo që do të kisha dëshirë që të vlerësohet më shumë në feminizmin socialist. Ajo që është në qendrën e besimit tim ironik, mosadhurimit tim ndaj Zotit, është paraqitja e kiborgut.

Kiborgu dhe organizimi kibernetikë – hibrid i makinës dhe organizimit, krijesë sa e realitetit shoqëror aq edhe e fiksionit. Realiteti shoqëror përbëhet prej marrëdhënieve të përjetuara shoqërore, ai është konstruksioni ynë kryesor politik – një fiksion që ndryshon botën. Lëvizjet ndërkombe të femrave e konstruktivë 'përvijën femërore', atë objekt kolektiv vendimtar, aq sa edhe e zbardhin apo e zbulojnë atë. Kjo përvijë është njëkohësisht fiksion dhe fakt; madje fakt i llojit kryesor politik. Liria fillon me konstruktivitetin e vetëdijes – konceptit imagjinar – të shfrytëzimit – e rrjedhimisht edhe me mundësitë. Kiborgu është pjesë e fiksionit të përvijës së përjetuar dhe e ndryshon atë që nënkuptohet me përvijën femërore të fundshekullit të njëzetë. Është fjala për luftën në kufi të jetës dhe vdekjes, edhe pse kufiri mes fantastikës shkencore dhe realitetit shoqëror është vetëm një mashtrim optik.

Fantastika shkencore moderne është përplot me kiborgë – krijesë që njëkohësisht janë shtazë dhe makina dhe të cilat jetojnë në botëra të pakuptueshme që janë të natyrshme dhe të krijuara nga dora e njeriut. Mjekësia moderne është po ashtu përplot me kiborgë – me çiftëzime mes organizmit dhe makinës, ku secili ka intimitetin e llojit të vet dhe epshin e paparë ndonjëherë në historinë e seksualitetit, e cila konceptohet si një

aparati i koduar. 'Gjinia' kiborgiane e ripërtërin atë pjesëz të vogël të bimëve afërsisht riprodhuese të barokut dhe të pakurri-zorëve (që janë një profilaksi e përkryer organik kundër heteroseksualizmit). Replikimi i kiborgëve nuk ka lidhje me riprodhimin organik. Prodhimi modern duket si një ëndërr ku kiborgët kolonizojnë botën e punës, ndaj të cilës edhe ankthi më i madh i tejlizimit duket si një idil, derisa lufta moderne paraqet origjinën e kiborgëve, nën shifrën C3 – komanda-kontrolli-komunikimi-punët informative- në vijën buxhetore për mbrojtje të Amerikës për vitin 1984 në shumë prej 84 miliardë dollarë. Me këtë rast do ta ofroja një argumentim në dobi të kiborgëve, si një fiksion që cakton realitetin tonë shoqëror dhe trupor si një mjet imagjativ që sugjeron disa çiftëzime mjaft pjellore. Në këtë aspekt, politika e Fukos paraqet një parashikim të paraqitur me turpërim të politikës kiborgiane të asaj fushe mjaft të hapur.

Të gjithë ne në fund të shekullit njëzet, në botën tonë mitike jemi bërë si hije: hibrid të teoretizuar dhe të fabrikuar të makinës dhe organizmit; thënë shkurt, jemi bërë kiborgë. Kiborgu është ontologjia jonë, ai e cakton politikën tonë. Kiborgu është paraqitje e kondensuar qoftë e imagjinatës ashtu edhe e realitetit material, dy boshteve të bashkuara që e strukturojnë çdo mundësi të shndërrimit historik. Në traditën e shkencës dhe politikës 'perëndimore' – të traditës së kapitalizmit racist nën mbizotërimin e mashkullit; të traditës së përparimit; të traditës së përvetësimit të natyrës së burimit të prodhimit të kulturës; të traditës së riprodhimit të vetvetes përmes pasqyrit të tjetrit – marrëdhënia mes organizimit dhe makinës paraqitet si luftë për kufirin. Basti në atë luftë janë territoret e prodhimit, riprodhimit dhe të imagjinatës. Ky vështrim është pledoaje për kënaqësinë që mund të nxirret nga përzjerja e vijave kufitare, si dhe për përgjegjësinë në krijimin e tyre. Ai gjithashtu paraqet një tentim që t'i kontribuohet kulturës dhe teorisë socialiste-feministe përmes një çelësi postmodernist, neonatyalist dhe përmes traditës utopike të të imagjinuarit të botës pa gjini, e cila ndoshta do të ishte botë pa krijim, por edhe botë pafund. Personifikimi i kiborgëve qëndron nga ana tjetër e historisë së shpëtimit.

Kiborgu është krijesë e botës së paslindjes dhe nuk ka kurrfarë lidhje me biseksualitetin, me simbiozën e paraedipit, me punën e patjetërsuar, e as me mënyrat e tjera të joshjes në plotësinë organike përmes përvetësimit përfundimtar të të gjitha fuqive të pjesëve në një njësim më të lartë. Në një kuptim të caktuar, kiborgut i

mungon rrëfimi i prejardhjes në kuptimin perëndimor; këtu kemi të bëjmë me ironinë "finale", duke ditur se kiborgu se kiborgu është telos i frikshëm me mbizotërimi në rritje të individacionit abstrakt në "Perëndim", pra një vetvetiu e plotë që e ka flakur më në fund çfarëdolloj varshmërie, pra një njeri në gjithësi. Rrëfimi për prejardhjen në kuptimin humanist të "Perëndimit" varet nga miti i njësisë fillestare, të plotësisë, shenjtërisë dhe të tmerrit; ai paraqitet me nënën që ka të meta, ndërsa obligimi i çdo detyre individuale të historisë është që të ndahet nga ajo. Këto mite të fuqishme binjake më së miri përshkruhen në psikanalizë dhe marksizëm. Hilari Kllajn thotë se marksizmi dhe psikanaliza, me konceptet e veta të punës, gjegjësisht individacionit dhe të shkollimit të gjinisë, nisen nga skenari i njësimi fillestar, nga i cili prodhohet dallimi i bëhet mobilizimi për dramën të rritjes së mbizotërim-it ndaj gruas/natyrës. Kiborgu e kapërcen hapin e njësimi fillestar të mishërimin me natyrën në kuptimin perëndimor, që parqet premtimin e vet të paligjshëm që mund të bien deri te subversioni i teknologjisë, asaj e cila arrin kuliminacioni në "Luftën e yjeve".

Kiborgët nuk e respektojnë zotin dhe nuk e mbamendin gjithësinë. Ata ruhen nga holizimi, edhe pse kanë nevojë për lidhje – duket se kanë një ndjenjë të natyrshme për politikën e frontit të bashkuar, por pa një parti prijëse. Problemi kryesor me kiborgët natyrisht ka të bëjë me atë që ata janë pasardhës të paligjshëm të militarizmit dhe të kapitalizmit patriarkal, të mos e përmendim socializmin shtetëror. Por, pasardhësit e paligjshëm shpesh i tradhetojnë rrënjë e tyre. Në fund të fundit, baballarët e tyre nuk janë edhe aq të rëndësishëm.

Në fund të këtij vështrimi do t'i kthehem edhe fantastikës shkencore për kiborgët, por tani do të dëshiroja t'i theksoj tri format kryesore të ndërprerjes së vijave të kufirit, që mundësojnë një analizë më të thuktë të fiksionit politik (apo analizë politikologjike). Nga fundi i shekullit njëzet në kulturën shkencore amerikane është prishur në themel kufiri mes njerëzores dhe shtazarakes. Janë ndotur edhe vendet e fundit të veçantisë njerëzore apo janë shndërruar në parqe argëtimi: gjuha, përdorimi i pajisjeve, sjellja në shoqëri, proceset mentale – asgjë më nuk e përcakton kufirin mes njeriut dhe shtazës në një mënyrë të mirëfilltë dhe bindëse. Shumë njerëz më nuk e ndiejnë të nevojshme që të ekziston një ndarje e tillë; për më tepër, shumë degë të



kulturës feministe avancojnë kënaqësinë e lidhjes së njeriut me genie të tjera të gjalla. Lëvizjet për të drejtat e shtazëve nuk janë forma të refuzimit irracional të veçantisë njerëzore, ato janë kuptim i qartë i lidhjes që e mbush të çarën mes natyrës dhe kulturës. Biologjia dhe teoria e evolucionit gjatë dy shekujve të fundit kanë prodhuar njëkohësisht organizma modernë dhe objekte të dijes, si dhe kanë tërhequr vijën e kufirit mes njerëzve dhe shtazëve, duke lënë një gjurmë të hollë, i cili ripërtërihet përmes luftërave ideologjike apo profesionale mes shkencave natyrore dhe të atyre shoqërore. Brenda kësaj kornize. Dhe me gjithë predikimet moderne të krishterimit rreth krijimit, duhet të luftohet sikurse të ishte fjala për një formë të keqpërdorimit të fëmijëve. Ideologjia biologjike-deterministike është vetëm njëri prej pozicioneve, prej të cilave mund të diskutohet në kulturën shkencore për domethënie e shtazarakësisë së njeriut. Për njerëzit që merren me politikë radikale, ekziston hapësirë e gjerë për vënien në dilemë të rëndësishme së vijës kufitare të prishur. Kiborgu në mit lajmërohet mu aty ku kufiri mes njeriut dhe shtazës kalohet. Ai jo vetëm që nuk e sinjalizon izolimin e njerëzve prej qenieve të tjera të gjalla, por tregon në çiftëzimin shqetësues apo këndshëm të fortë. Në një cikël të tillë të këmbimit martesor, bestialiteti fiton një status të ri.

Një dallim tjetër, që nuk është aq i madh, është dallimi

shtazarakes-njerëzores (organizmit) dhe makinës. Ndoshta mund të thuhet se makinat parakibernetike mund të kenë qenë të xhindosura; parafytyrimet e fantazmave gjithmonë kanë ndenjur pezull rreth tyre. Ky dualizëm ka strukturuar dialogun mes materializmit dhe idealizimit dhe është zgjidhur me një fryt të dialektikës, të quajtur varësisht prej shijes – fantazma apo historia. Por në thelb makinat nuk kanë qenë vetëlëvizëse, inteligjente (self-designing), autonome, dhe as që kanë mundur ta imitojnë në mënyrë vajtuese. Me fjalë të tjera, ato nuk kanë qenë njeri, autor i vetvetes, por vetëm thjesht një karikaturë mashkullore reproduktive. Vetë mendimi se ato paraqesin diçka tjetër, ka qenë paranoik. Tani më nuk jemi edhe aq të sigurt. Falë makinave të fundit të shekullit njëzet, dallimet me natyrale dhe artificiale, shpirtit dhe trupit, vetëzhvillueses dhe të së formësuarës nga jashtë, si dhe dallimet e shumta të tjera, që më parë kishin të bënin me njeriun dhe makinën, janë bërë thellësisht të pasigurta. Makinat tona i zbukuron një gjallëri shqetësuese, ndërsa ne jemi bërë tmerresisht të palëvizshëm.

Determinizmi teknologjik është vetëm njëri prej formave të hapësirave ideologjike që hapen përmes rikonceptualizimit të makinës dhe organizmit në formë të teksteve të koduara, përmes të cilave hyjmë në lojën e të shkruarit dhe të lexuarit të botës. "Tekstualizimin" e çdo gjëje në teorinë poststruktural-

iste dhe postmoderniste, mark-sistët dhe feministet socialiste e dënojnë për shkak të shpërfilljes utopiste të saj të marrëdhëniesve realisht të jetuara të mbizotërimit, ku sinergjitë uteniste, siç është miti për kiborgun, i prishin shumtë tërësi organike (p.sh. këngën, kulturën primitive, organizimin biologjik). Thënë shkurt, siguria e asaj që llogaritet natyrë – burim i reflektimit dhe i premtimit të virgjërisë – ka vdekur. Autorizimi transcendent i interpretimit ka humbur, e me të edhe ontologjia që e themelon epistemologjinë perëndimore. Mirëpo, alternativa nuk është cinizëm apo mosbesim, ose një lloj i ekzistencës abstrakte, ashtu si në determinizmin teknologjik “makina” që e shkatërron “njeriun”, apo si “teksti” që e shkatërron “veprimin e paramenduar politik”. Kush do të jenë kiborgët është një pyetje radikale dhe nga përgjigjja në të varet edhe ekzistenca. Shimpanzat dhe artefaktet e kanë një politikë; pse mos ta kemi edhe ne?

Degëzimi i tretë është nënloj i të dytit: vija e kufiri mes fizikës dhe jofizikës për ne është shumë joprecize. Librat e popullarizuar të fizikës lidhur me teorinë kuantike dhe me parimet e papërcaktueshmërisë janë një lloj i ekuivalentit shkencor fantastik të romancës arlekiniane dhe i shënojnë kthesat radikale në heteroseksualitetin e bardhë amerikan; asgjë nuk kuptojnë, por i kanë “qëlluar temës”. Në thelbin e tyre makinat moderne janë aparate mikroelektronike; ekzistojnë gjithkund dhe janë të padukshme, ndërsa makineria moderne është zot i sapoardhur arrogant, i cili me ironi e përkrah gjithëpranishmërinë dhe humorin e babait. Sipërfaqja për shkrim e përbën çipin e silikonit, i cili përvijohet me shkallë molekulare që pengohen vetëm nga zhurma e vogël e atomeve – ai burim i fundit i partiturës nukleare. Edhe pse letra, pushteti dhe teknologjia janë miq të vjetër në rrëfimet e Perëndimit mbi prejardhjen e civilizimit, miniaturizimi e ka ndërruar përshtypjen tonë ndaj mekanizmit. Miniaturizimi ka të bëjë me pushtetin; ajo e vockla nuk është aq e bukur, sa është para së gjithash e rrezikshme, siç është rasti me raketat kryqëzore. Krahasojmi televizorët e viteve të pesëdhjeta me videokamerat sa një pëllëmbë dore, që reklamohen sot. Makinat tona më të mira janë të ndërtuara nga drita e diellit; ato janë plotësisht të ndritshme dhe të pastra sepse nuk janë asgjë tjetër pos sinjaleve, valë elektromagnetike, një prerje e spektrit. Po ashtu, ato makina janë plotësisht portative dhe të lëvizshme – gjë që paraqet mund të madh njerëzor në Detroit dhe Singapor. Njerëzit nuk janë as për së afërmi aq fluid, sepse njëkohësisht janë material dhe të patejdukshëm, derisa kiborgët janë eter, kuin-tesencë.

Gjithëpranishmëria dhe padukshmëria e kiborgeve është arsyeja e vërtetë pse këto makina nga brezi diellor janë aq vdekjeprurëse. Ato janë njëjtë të padukshme edhe politikisht edhe materialisht, dhe kanë të bëjnë me vetëdijen apo me stimulimin e saj. Ato janë tregues notues që

transportohen me kombi nëpër Evropë, dhe në mënyrë më efikase do të i ndalë qëndisja e femrave të Grinemit, të cilat shumë mirë i lexojnë rrjetet kiborgiane të pushtetit, sesa çfarëdo pune militante të politikës më të vjetër mashkullore, bazës natyrore sociale së cilës i nevojiten vendet e punës në industrinë ushtarake. Në pikë të fundit, shkenca “më e fortë” ka të bëjë me fushën e konfuzionit më të madh rreth vijave kufitare, fushës së numrit të pastër, shpirtit të pastër, C3, kriptografisë dhe ruajtjes së fshehtësive të fuqishme. Makinat e reja janë aq të pastra dhe të ndritshme sepse edhe krijuesit e tyre janë adhuruesit e diellit, ata që e ndërmytësojnë revolucionin e ri shkencor të lidhur me ëndrrën e natës për shoqërinë pasindustriale. Sëmundjet që i ftojnë këto makina të pastra nuk paraqesin asgjë tjetër, pos përjetimit të stresit. Gishtërinjtë e shkathët e grave të Lindjes, adhurimi i vjetër i shtëpive të kukullave tek vajzat anglosaksone nga koha viktoriane, përqendrimi natyror i femrave në atë të vogël – krejt kjo merr dimensione krejtësisht të reja në këtë botë. Ndoshta do të shfaqet ndonjë |Lizë kiborgiane e cila do t'i marrë parasysh këto dimensione të reja. Që ironia të jetë më e madhe, ndoshta me strategjitë frytdhënëse të opozitës do të udhëheqin njësitë e femrave të panatyrshme – kiborgeve që prodhojnë çipe në Azi apo që bëjnë vallëzimin spiral në Santa Ritë.

Miti im rreth kiborgut ka të bëjë, pra me kufijtë e shkelur, lidhjet e pushtetshme dhe mundësitë e rrezikshme, të cilat do të mund t'i shqyrtonin njerëzit progresivë si pjesë e punës së domosdoshme politike. Një nga supozimet e mia është se shumica e socialistëve dhe feministëve amerikane i sheh dualizimet e shprehura të shpirtit dhe trupit, të shtazëve dhe makinave, të idealizmit dhe materializmit në praktikën shoqërore, të formulimeve simbolike dhe të artefakteve fizike të lidhura me „teknologjinë e lartë” dhe me kulturën shkencore. Prej Njeriut të një dimensionit deri te vdekja e natyrës, resurset analitike që janë zhvilluar nga njerëzit progresivë insistojnë në mbizotërimin e nevojshëm të teknikës dhe e ftojnë një trup të parafytyruar që mund të integrojë rezistencën tonë. Supozimi i dytë është se ekziston nevoja për bashkimin e njerëzve që përpiqen të përballen me fuqizimin e mbizotërimit në nivel botëror dhe se kjo nevojë kurrë nuk ka qenë më e madhe. Megjithatë një lëvizje nga pak perverse e perspektivës ndoshta do të na aftësojë më mirë rreth luftës për domethënien dhe rreth formave të tjera të pushtetit dhe të kënaqësive të ndërmytësuar me shoqëri.

130 - Ekonomia e punës së ardhme

„Revolucioni i ri industrial” krijon klasën e re punëtore të dimensioneve botërore. Lëvizshmëria e madhe e kapitalit dhe ndarja ndërkombëtare e punë që po krijohet janë të ndërlidhura me shfaqjen e kole-

tiviteteve të reja dhe me dobësimin e grupacioneve të njohura deri atëherë. Këto ngjarje nuk janë indiferente ndaj gjinisë dhe klasës. Meshkujt e bardhë në shoqëritë e zhvilluara industriale po ballafaqohen në një mënyrë të re me humbjen e përhershme të vendit të punës, derisa heqja e femrave nga listat e rrogës nuk shkon me dinamikë të njëjtë siç është ajo te meshkujt. Kjo nuk ndodh vetëm për shkak të asaj që femrat në vendet e botës së tretë janë fuqi e preferuar punëtore për kompanitë shumëkombëshe, të bazuara në shkencë dhe në sektorët e përpunimit të eksportit, në veçanti në elektronikë. Kjo pasqyrë është më sistematike dhe përfshinë riprodhimin, seksualitetin, kulturën, konsumin dhe prodhimin. Në luginën prototipe të silikonit, jetërat e shumë femrave janë të strukturuar rreth punësimit në vende të punës që varen nga elektronika; rrëfimet e tyre intime përfshijnë monogaminë seriale heteroseksuale, zgjidhjen e problemeve të kujdesit ndaj fëmijëve, largimin nga familja e gjerë apo nga shumica e formave të tjera të bashkësisë tradicionale, besueshmëritë e larta që ato do të mbesin të vetmuara, si dhe brishtësinë e skajshme ekonomike që vjen me plakjen. Dallimi etnik dhe racor i femrave në Luginën e Silikonit e strukturon mikroorganizmin e dallimeve kulturore, familjare, fetare, arsimore dhe gjuhësore që ndeshen mes vete.

Richard Gordon e ka quajtur këtë situatë të re si një „ekonomi të punës vendore”. Edhe pse ky term përfshin fenomenin e punës në shtëpi që ka të bëjë me montimin e pajisjeve elektronike, Gordoni e ka sajuar kryesisht për të shënuar rekonstruimin e punës e cila në vija të trasha i ka veçoritë që më parë i atribuoheshin kryesisht femrave. Është duke vazhduar procesi i rridefinimit të punës gjegjësisht si i femrave dhe i feminizuar, pavarësisht a e kryejnë meshkujt apo femrat. Të jesh i feminizuar do të thotë që të shndërrohesh në një qenie shumë të lëndueshme: i nënshtruar ne “çmontim” dhe në “montimin” e mëpastajmë, i shfrytëzuar si fuqi rezerve punëtore, i konsideruar më shumë si shërbëtor sesa si punëtor, i nënshtruar ndaj orareve të tilla kohore në vendpunim dhe jashtë tij, të cilët i përqeshen idesë për ditë të kufizuar të punës; që të jesh “etnografi e feminizuar” në të cilën objekti organik shkapërderdhet derisa vëmendja drejtohet në lojën e të shkruarit. Në nivelin e ideologjisë shohim se racizmi dhe kolonializmi përkthehen në gjuhën e zhvillimit dhe në atë të zhvillimit të pamjaftueshëm, të dinamikës dhe të modernizimit të kufizuar. Cilido mjet apo person mund të paramendohet në mënyrë të arsyeshme në kategoritë e çmontimit dhe të montimit të mëpastajmë; kurrfarë arkitekture “natyrore” nuk e kufizon dizajnin e sistemit. Lagjet financiare në të gjitha qytetet e botës, si dhe zonat e përpunimit të eksportit dhe të tregtisë së lirë e publikojnë këtë fakt elementar të “kapitalizmit të vonshëm”. Universi i gjithëm-

barshëm i objekteve të cilat mund të kuptohen nga aspekti shkencor duhet të formulohet si një tërësi e problemeve të inxhinieringut të komunikimit (për menaxher) apo të teorisë së tekstit (për ata që refuzojnë). Edhe e para edhe e dyta janë kiborg-semiologji.

Duhet të pritet që strategjitë e kontrollit të përqendrohen në kushtet dhe ndërveprimet kufitare, në intensitetin e rrjedhës përtej vijave kufitare – në vend që të përqendrohen në integritetin e objekteve natyrore. “Integriteti” apo “sinqeriteti” i personalitetit të Perëndimit lëshon pe para procedurave e vendimmarrjes dhe sistemeve të eksperteve. Për shembull, strategjitë e kontrollit ndaj aftësisë së femrave që të lindin qenie njerëzore do të jetë në gjuhët e kontrollit të popullatës dhe në maksimalizimin e arritjes së caktuar për vendimmarrësit e caktuar. Strategjitë e kontrollit të lindjeve do të formulohen në kategori, të shpenzimeve të kufizimeve dhe të nivelit të lirive. Qeniet njerëzore, ashtu sikurse secili komponent tjetër apo nënsistem, duhet të lokalizohen në një sistem të arkitekturës, ku moduset bazike të të punuarit e të cilit varen nga besueshmëria dhe statistika. Asnjë objekt, hapësire apo trup nuk është i shenjtë vetvetiu; secili komponent mund të futet në ndërveprim me cilindo komponent tjetër, nëse mund të ndërtohet standardi i duhur, kodi i duhur, për përpunimin e sinjaleve për një gjuhë të përbashkët. Këmbimi në këtë botë e tejkalon përkthimin universal që bëhet në tregjet kapitaliste, të cilat aq mirë i ka analizuar Marksi. Patologjia e privilegjuar që i godet të gjitha llojet e komponentëve në këtë gjithësi është stresi – thyerja e komunikacionit. Kiborgu nuk i nënshtrohet biopolitikës së Fukos; Kiborgu e simulon politikën që është një fushë shumë më e fuqishme operative.

Ky lloj i analizës së objekteve shkencore dhe kulturore që janë lajmëruar historikisht pas Luftës së Dytë Botërore na përgatit që të identifikojmë disa mangësi të rëndësishme të analizës feministike, e cila sillet si një dualizëm organik dhe hierarkik që e ka rregulluar diskursin në “Perëndim”, duke filluar prej Aristotelit e tutje, të cilat vlejën edhe sot. Ata janë të veçantë dhe, si do të thoshte Sofia Zoe, ata janë “te tretur-teknologjikisht”. Të gjitha dikotomitë në mes të shpirtit dhe trupit, shtazës dhe njeriut, organizimit dhe makinës, publikes dhe private, natyrës dhe kulturës, mashkullit dhe femrës, primitives dhe civilizueses janë ideologjikisht problematike. Gjendja reale e femrës është integrimi/shfrytëzimi në një sistem botëror të prodhimit/riprodhimit dhe komunikimeve, i cili mund të quhet “informatika e dominimit. Shtëpia, vendi i punës, tregu,

skena publike, vetë trupi – të gjitha këto mund të zgjidhen dhe të futen në ndërveprim në pothuajse një numër të pakufishëm të mënyrave polimorfe, me pasoja të mëdha për gruan dhe të tjerët. Nga ana tjetër, ato pasoja janë shumë të ndryshme për njerëzit, për shkak të kësaj shumë lëvizje ndërkombëtare të opozitës janë bërë vështirë të paramendueshme, por edhe të domosdoshme për mbijetesë. Një drejtim i rëndësishëm i rekonstruimit të politikës socialiste-feministe hapet përmes teorisë dhe praktikës, e cila është e drejtuar nga marrëdhëniet shoqërore mes shkencës dhe teknologjisë, duke përfshirë rolin e rëndësishëm të sistemeve mitologjike dhe të vlerave, që i strukturojnë parafytyrimet tona. Kiborgu është një lloj i personalitetit të çmontuar dhe prapë të montuar postmodern, kolektiv dhe personal. Ky është personaliteti që feministet duhet ta kodojnë.

Teknologjitë dhe bioteknologjitë e komunikimit janë mjete më të rëndësishme për riformësimin e trupave tonë. Këto mjete e mishërojnë dhe imponojnë marrëdhëniet e reja shoqërore të femrave në mbarë botën. Teknologjia dhe diskursi shkencor pjesërisht mund të kuptohen si formalizime, gjegjësisht, si momente të ngrira të ndërveprimeve shoqërore që i themelojnë, por gjithashtu duhet të shikohen si instrumente për imponimin e rëndësisë. Mes mjeteve dhe miteve, instrumentit dhe koncepteve, sistemeve historike të marrëdhëniesve shoqërore dhe anatomive historike të trupave të mundshëm, duke përfshirë objektet e dijes, ekziston vija lëshuese e kufirit. Me saktë, miti dhe mjetet e themelojnë njëra-tjetrën.

Për më tepër, shkencat mbi komunikimin dhe mbi biologjinë moderne themelohen me një veprim të vetëm – duke përkthyer botën në problem të kodimit, duke kërkuar gjuhën e përbashkët, në të cilën krijohet çdo refuzim ndaj kontrollit instrumental, dhe i tërë heterogjeniteti i nënshtrohet çmontimit dhe montimit të mëpastajmë, kontributit dhe këmbimit.

Në shkencat mbi komunikimin, përkthimi i botës në problemin e kodimit mund të ilustron me teoritë e sistemeve kibernetike (që kontrollohen me një mekanizëm kthyes), që zbatohen në teknologjinë e telefonave, dizajnin kompjuterik, në armatim apo në krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave. Në secilin prej këtyre rasteve, zgjedhja e çështjeve kyçe fillon me një teori të gjuhës dhe kontrollit; operacioni kyç është caktimi i intensitetit, drejtimit dhe të besueshmërisë të rrjedhës të një sasive të quajtur informatë. Bota është e ndarë me kufi të brendshëm, të cilët nuk lëshojnë në mënyrë të njëjtë informatat.

Swiss Cultural Programme Kosovo



Mariko J Mori

Vizionet sintetike pamore mes së djeshmes dhe së nesërme

ULRIKE LEHMANN

Si shumë artistë të sotëm, artistja multimediale Mariko Mori jeton në dy botë – në qytetin e saj të lindjes, Tokio, dhe në shtëpinë e saj të zgjedhur – Nju Jork. Performansat e saj dhe dizajni i modës, si dhe videot e fotografitë e pasqyrojnë kontrastin mes botës së re dhe asaj të vjetër, duke i sintetizuar kështu dy botë në një vizion hiperealist. Këto botë nuk ndërlihen vetëm me budizmin dhe shintoizmin, por edhe me teknologjinë më të fundit, me manipulimin me fotografi digjitale, me fantastikën shkencore, me popin tekno dhe neo, me aspektet kozmike dhe me reklama.

Në punimet e saj të mëhershme fotografike, Mori pozon si një kiborg femëror, e veshur në rroba të teknologjisë së lartë me ngjyrë të argjendit të shndritshme, e rrethuar me qytetarë të rëndomtë japonez apo edhe e vetme. Kjo shihet në punimet e saj vijuese: në metro, i cili për shkak të mënyrës së fotografimit, ka formë rrethore të UFO – ve /Objekteve të Pidentifikuara Fluturuese/ (Subway /metroja 1994); para një ndërtese të biznesit, ku ajo u ofron çaj afaristëve që kalojnë andej pari (Tea Ceremony III/Ceremonia e çajit III, 1995.); apo edhe në përzierjen e kukullave Barbi me gruan mekanike të Fric Llangut nga filmi "Metropolis", në arkadën panikisht argëtuese (Play with me/Luaj me mua, 1994).

Fotoinstalacioni tredimensional Birth of a Star/Lindja e yllit, i vitit 1995, paraqet kthesë në punën e saj. Mori fillon ta paraqesë vetveten para një prapavije të bardhë, derisa topat me ngjyra të hareshme rrinë pezull rreth saj në formë të yjeve. Ajo e fotografon vetveten me dëgjuese të mëdha, me fustan mini dhe me çorapë plastike, si një pop idol i krijuar nga kompjuteri, që është i frymëzuar njëkohësisht nga vitet e shtatëdhjeta dhe të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Dy kollare

plastike të verdha në formë të fluturës, të lidhura përmbi bërrylat e saj si krahë, e thërrasin figurën e engjëllit, në cilësinë e ndërmjetësuesit mes qiellit dhe tokës. Prej atëherë, formatet e saj të tejmadhura të fotografive dhe të videopunimeve i prodhon ekipi i përbërë prej 8 deri në 19 anëtarë, si dhe sponsoruesit e shumtë.

Miko no inori

Prodhimi i begatë kërkon kostumografë, juvelirë, stilistë, floktarë, grimerë, teknikë, mjeshtër të dritës dhe kameramanë, kompozitorë dhe mjeshtër të zërit, ekspertë për animacion kompjuterik, si dhe disenjatorë në mënyrë që të arrihet platforma e përkryer për fotografi. Mariko Mori është regjisore, dramaturge, këngëtare dhe aktore kryesore në fotografitë, videopunimet dhe në performansat e saj. Çdo deklaratë pamore apo sintetike e shumështruar paraqet një prezantim të përkryer. Artisja e integron në mënyrë absolute botën e re pamore, duke qëndruar pezull mes së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes, ëndrrës dhe realitetit, traditës dhe modernes, fesë, natyrës dhe teknologjisë, seriozitetit dhe përleshjes me kiborgrealizimin e saj. Kjo përzierje i bashkon kontrastet, kufijtë e të cilëve në fotografitë e saj oscillojnë me lehtësi fluide. Ajo manipulon, sintetizon dhe harmonizon, duke shpresuar në një botë më të mirë. Duke mos hyrë në largësi kritike, misioni i saj është të fotografojë shndritjen në nirvanë. Budistët besojnë në rilindje dhe në gjendjen e paqes qiellore. Vizionet pamore të Morit i shndërrojnë mundësitë e së nesërme në realitet të sotmes.

E veshur në rroba të shndritshme me ngjyrë të purpurt, me krahë të ngritur plastik engjëllorë, ajo qëndron në aeroportin e Japonisë, duke e mbajtur gjylen e kristaltë në duar. Nga sytë e saj burojnë rrezet e dritës, derisa e shikon gjylen e kristaltë, gjegjësisht



Mariko Mori, e lindur në vitin 1967 në Tokio, Japoni

derisa shikon të ardhmen brenda saj. Ky punim i bërë në vitin 1996 dhe i quajtur Miko no inori, duket se ka qenë programor për tërë veprën e saj, ku ajo përipiqet të bashkojë artin dhe filozofinë, si dhe vizionin fetar e shpirtëror të saj.

Kumano

Në fotografinë Kumano, të bërë dy vjet më vonë, Mori duket se ka gjetur autoportretin e saj të së ardhmes. Në anën e majtë të fotografisë ajo qëndron e përkulur para urës së kuqe, që ngjason me urat që mund të shihen në tempujt japonezë. Duke e mbajtur një detaj të lartë në kokë, të punuar

prej margaritarëve dhe materialeve të çmueshme, ajo është mishërim i Japonisë tradicionale. Në prapavijë paraqitet ujëvara. Në anën e djathtë të fotografisë ajo qëndron para një tempulli futuristik shumëkëndësh, Tempulli i ëndrrave (Dream Temple), formë kjo që përkujton në arkitekturën tradicionale të Japonisë. Figura e saj është pothuajse e tejudkshme, duke e krijuar kështu fantazmën e së ardhmes me forma hijezuese. E mbështjellë me mjegullinën e dritës shndritëse, ajo nuk paraqitet më në formën e saj trupore dhe është ende si jo e prekshme. Dy skena janë të ndërlidhura me prapavijen e njëjtë ku gendet pylli, si dhe shenjat të vjetra të shkruara lartë dhe të fotografuara në sipërfaqen e fotografisë.

Tempulli i ëndrrave

Në punimin e saj Tempulli i ëndrrave, nga viti 1999, Mori e ka çuar tempullin digjital nga vepra Kumano edhe një hap më tej, duke e transformuar punimin në një „Gesamtkunstwerk“ apo në punim total artistik. Ky projekt i saj më i shumështruar deri më tani, dhe e kombinon arkitekturën, grafikën kompjuterike, afektin 3D, sistemin vision-dome

dhe realitetin virtual, me qëllim të hulumtimit të natyrës së vetëdijes së njeriut. Me diametër prej 10 metrash dhe me lartësi prej 5 metrash, tempulli tetëkëndësh i ëndrrave është punuar nga qelqi i thjeshtë dhe ai dihiroik, sipërfaqet e tij të buta shndritëse dhe prizmatike ndryshohen varësisht nga drita. Ky punim është bërë në bazë të tempullit Jumendo që gjendet në Naro, i cili është punuar në shekullin e tetë, si shtëpi e statujës së Bodisatves në një atmosferë meditative. Në tempullin e Morit, natyrisht se hyjnitë mungojnë, dhe vendin e tyre e merr shikuesi që hyn në ndërtesën qendrore për të zbuluar vetveten në videoprojeksionin e plotpranishëm, ku fotografitë abstrakte të trupave qiellore shndërrohen në fotografi të bulëzimit dhe të rritjes. Për shkak të manipulimeve të përkryera të Morit me fotografi dhe prezantime, që na përkujtojnë inxhinieringun gjenetik dhe kombinimin e realitetit me utopinë futuristike, termi "Realizëm kiborgian", i zbuluar nga Dona Herovej – duket se i përshtatet veprës së Mariko Morit.

(Nga libri „Artistet në shekullin 20 dhe 21“, Taschen, 2001)



Më pëlqen të qëndroj
afër majës së malit.
Njeriu atje
nuk humbet.

Wislawa Szymborska

Swiss Cultural Programme Kosovo

DEZA
DDC
DSC
SDC
COSUDE



PROHELVETIA
Arts Council of Switzerland

Poezi

Sylvia Plath

Djegia e shtrigave

Në sheshin e pazarit stivojnë në turrë degë të thata.
Imishta e hijeve - është një fustan i varfër. Po e mbush
Trajtën time prej dylli, kurmin e kukullës.
Sëmundja merr fill këtu: për shtrigat jam nishan.
Djallin mund ta shpëtojë vetëm djalli.
Në muajin e gjetheve të kuqërremta unë ngjitem në
shtratin e zjarrtë.

Kollaj ta fajësosh errësirën: gojën e derës,
Barkun e qilarit. Ata ma fikën zjarrin tim bengalez.
Dama, e flatërt, si një brumbull i zi,
Po më mban në kafaz me papagajtë.
Çfarë sysh të mëdhenj kanë të vdekurit!
Jam mikeshë më fantazmën leshatore.
Rrotat prej tymi rrokullisen prej sqepit të kotruves.

Nëse vogëloshë jam, prej meje s'vjen e keqja.
Nëse përpëlitem, asgjë nuk thyej. Kështu thashë,
Duke ndenjor poshtë kapakut në vorbë,
Thërmickë dhe e palëvizshme, si një kokrrizë orizi.
Ata ndezin pipthat e llambës, unazë pas unaze.
Përplot jetë jemi, o miqtë e mi të vegjël. Rritemi.
Tepara kjo është e dhimbshme. Gjuhëzat e kuqe
Na mësojnë të vërtetën.

Xheraldina Vula

Muri duhet të lyhet

Është zverdhur muri anash
Bardhë mbeti vetëm katrori
Ku qëndroje i varur ti
Të hoqa ngadalë si të hiqja
Mallin e shtresuar me kohë
Muri duhet të lyhet
Unë do të goditem me mjeshër
Nuk do t'i pyes sa do t'më kushtojë
Ti zbardh muret dhe të heq katrorët e tjerë
që nuk rrinin të varur si ti

Xheraldina Vula

Harroj që jam grua

Ka kohë që të hutuar sillemi vërdallë
Nuk ka bar të njomë as vesë mbi të
Më vdes koha në trup si hënë
As të shushurin si pemë vjeshtës
As të harroj të jem e prekur
Ka kohë që më sillesh e sillem vërdallë
Nuk ka bar të njomë as vesë mbi të
Më vdes koha në trup e unë harroj që jam grua

Sibel Halimi

Cazë dua...!

Në të voglën gotë të notoj dua
Në skajet e saj të rrezitem...(!)
Liria si ombrellë të më shërbejë
Më lini qetësinë aty ta gjejë...
Të ma vidhni... jo kurrë s'dua...!

Vetes nuk i takoj

Për të parën herë e tepërt ndihem
sepse s'jam uni im
rrugët janë të gjata deri tek vetja
saqë ajo nuk ekziston fare
s'jam vetja e as që dua të jem
se e juaja duhet të mbetem
nënë
baba
vëlla
motër
burrë
kënaquni me pafuqinë time...

Mimoza Ahmeti

"Është çudi kur je femër"

Mua tani më vjen për të qarë
më duket sikur shkarkesa yjesh
më janë grumbulluar te sytë
Dot nuk duroj,
ndërsa çengelat e nervave nderas tërhiqen
kundrejt njëri-tjetrit

Kangur me foshnjën në xhep
duket figura ime së largu këtu në bregdet

Më vjen për të qarë. Jam bërë barrë

Me siguri molusqet e buta tani
lëvizin kapakët e fortë brenda ujit
dhe kandilat e kuq
kushedi ç'udhëtim të mahnitshëm
kanë marrë

Është çudi kur je femër...

E keni parë natyrën kur tmerrohet, fryn e shkatërrohet
kur si përbindësh shkriqeron gërmadhat e mohimit...
pastaj, kur pastaj, e lehtë dhe e trandur,
me sytë e mëdhenj plot hije
pret një vazhdim, një lindje fëmije
buzë detit ku i vjen për të qarë, për të qarë,
ngaqë se si është, është me barrë

Në ato orë të ditës kur molusqet e buta
hapin kapakët e fortë brenda ujit dhe kandilat e kuq
kushedi ç'udhëtim të mahnitshëm kanë marrë...

Nikki Giovanni

Mundësitë

nëse nuk mund të bëj
atë që dua të bëj,
atëherë puna ime është që të mos
bëj atë që nuk dua ta bëj,
nuk është e njëjta gjë
por është e vetmja gjë që mund
të bëj
nëse nuk mund të kem
çka dua... atëherë
puna ime është që të dua atë që kam
dhe të jem e kënaqur
se së paku ka ende çka mund të duhet aty
pasi që nuk mund të shkoj
atje ku duhet
të shkoj...atëherë më duhet... të shkoj
atje ku shenjat japin drejtimin
gjithnjë duke kuptuar se lëvizjet paralele
nuk janë të njëanshme
kur nuk mund ta shpreh
atë që vërtetë e ndiej
unë ushtroj që të ndiejë
atë që mund ta shpreh
dhe asnjëra prej këtyre nuk është e barabartë
e di
por, pikërisht për këtë gjë vetë njerëzimi
në mesin e të gjitha shtazëve
mëson të qajë.

Perktheu Xheraldina Vula



Disa njerëz bëhen
të famshëm,
të tjerët
e meritojnë atë.

Doris Lessing

Kryesisht
gjatë historisë,

Anonimi
ishite grua.

